



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 471 Akti

Nr. 564 Vendimi  
Tiranë, më 23.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Suela Zhegu</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datat 15.9.2022 dhe 23.9.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arian Përmeti**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arian Përmeti, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Arian Përmeti është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës

së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

**2.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

**3.** Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arian Përmeti, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionere Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi përmes postës elektronike se nuk është në dijeni të konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

**5.** Me vendimin nr. 2, datë 30.6.2022, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Arian Përmeti dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

**6.** Në datën 1.7.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 20.7.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Me kërkesën e datës 19.7.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., subjekti i rivlerësimit kërkoi zgjatje të afatit për paraqitjen e parashtrimeve për një afat 10-ditor, duke qenë se ishte ende në pritje të informacionit të kërkuar nga institucionet shtetërore.

**8.** Me vendimin nr. 3, datë 20.7.2022, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin e paraqitjes së prapësimeve nga subjekti deri në datën 5.9.2022.

**9.** Në datën 5.9.2022, subjekti i rivlerësimit dërgoi përmes postës zyrtare parashtrimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2022.

**10.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 4, datë 11.9.2022, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ me qëllim verifikimin e një informacioni të publikuar në media, ku ngriheshin pretendime mbi një dosje të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit. Po me vendimin nr. 4, iu kërkua subjektit të paraqiste shpjegime e dokumenta shkresore për sa pretendohet në këtë informacion, duke i vënë linkun në dispozicion, si dhe, kalimi i çështjes në seancë dëgjimore në datën 15.9.2022.

**11.** Në datën 15.9.2022 u zhvillua seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit në prezencë edhe të përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit V. G., me nr. licence \*\*\* dhe NIPT \*\*\*. Gjatë seancës, pasi dëgjoi subjektin i cili dha shpjegime e paraqiti dokumenta shkresore në lidhje me çështjen për të cilën ishte riçelur hetimi administrativ, trupi gjykues u tërhoq në dhomë

këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, ku analizoi parashtrimet dhe dokumentat shkresore, të cilat u administruan në përfundim të seancës. Pasi nga ana e Trupit Gjykoës u vlerësua që nuk ishte e domosdoshme kryerja e ndonjë vendimi tjetër hetimor, me vendimin nr. 5, datë 15.9.2022, ky trup vendosi mbylljen e hetimit administrativ të riçelur më 11.9.2022, pa i kaluar subjektit barrë prove. Në datën 23.9.2022 u shpall vendimi për konfirmimin e subjektit në detyrë.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**12.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**13.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**14.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**15.** Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **VLERËSIMI I PASURISË**

**16.** Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr.84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr.indeksi \*\*\* dhe ka dorëzuar deklaratat: DPDFD/2003, DPV/2004, DPDFD 2013 – 2017 dhe deklaratën *Vetting*.

**17.** ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Arian Përmeti ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka dokumentacion të plotë justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**18.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Arian Përmeti, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat

shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

**19.** Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

### **Pasuri të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit**

**20.** Në hyrje të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “(i) *Me vdekjen e mamasë sime M.P., në datën 13.2.2012 kam trashëguar 1/3 pjesë të saj për prona të ndodhura në Tiranë e Durrës. Vendimi nr. \*\*\*, datë 11.10.2012, i Gjykatës Tiranë.* (ii) *Me vdekjen e babait tim A. P., në datën 27.1.2016, kam trashëguar 1/2 pjesë të tij për prona të ndodhura në Tiranë e Durrës. Dëshmi trashëgimie ligjore nr. \*\*\*, datë 24.3.2016”.*

**20.1.** Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka paraqitur<sup>1</sup>: (i) vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për M. P., ku caktohen si trashëgimtarë ligjorë shtetasit A. P., Arian Përmeti dhe A. P. me 1/3 pjesë/secili; (ii) dëshmi trashëgimie ligjore nr.\*\*\*, datë 24.3.2016, ku caktohen trashëgimtarët ligjorë të A. P., të cilët janë A. P. dhe Arian Përmeti me 1/2 pjesë/secili.

**20.2.** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit rezultoi se këto fakte janë deklaruar në mënyrë të saktë nga subjekti, përkatësisht në DIPPFD në vitin 2013, ku është deklaruar çelja e trashëgimisë ligjore të nënës së subjektit M. P. dhe në DPV për vitin 2016, ku është deklaruar çelja e trashëgimisë ligjore të babait të subjektit A. P.

### **21. Pasuri të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të përfituara me trashëgimi nga nëna M.P., të ndodhura në Durrës**

**21.1.** *Apartament me sip. 119 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 100%.*

**21.2.** *Tarracë me sip. 18 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 100%.*

**21.3.** *Apartament me sip. 75 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 100%.*

**21.4.** *Dyqan me sip. 33.20 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/3.*

**21.5.** *Dyqan me sip. 66 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/3.*

**21.6.** *Dyqan me sip. 20.30 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/3.*

**21.7.** *Dyqan me sip. 95.33 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/3.*

---

<sup>1</sup>Shihni aktet në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

- 21.8.** *Dyqan me sip. 44.68 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/3.*
- 21.9.** *Dyqan me sip. 42 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, si dhe aneks i tij 3 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\* (100%). Trashëguar nga M. P.. Pjesa takuese: 50% dhe 100%.*
- 21.10.** *Dyqan me sip. 18 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/3.*
- 21.11.** *Dyqan me sip. 48 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/12.*
- 21.12.** *Dyqan me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 100%.*
- 21.13.** *Apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 100%.*
- 21.14.** *Apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 100%.*
- 21.15.** *Garazh me sip. 60 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.*
- 21.16.** *Apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 50%.*
- 21.17.** *Apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Zotëroj: 50 %.*
- 21.18.** *Apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr.\*\*\*. Trashëguar nga M. P. Zotëroj: 50 %.*
- 21.19.** *Apartament me sip. 51 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr.\*\*\*. Trashëguar nga M. P. Zotëroj: 50 %.*
- 21.20.** *Apartament me sip. 95 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr.\*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 50%.*
- 21.21.** *Dyqan me sip. 177 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 50%.*

Në lidhje me këto pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

#### **Hetimi i Komisionit mbi pasuritë (me numër rendor 21.1-21.21)**

**22.** Gjatë hetimit administrativ në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit dhe gjendjen juridike të pasurive të mësipërme, nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>2</sup>, rezultoi se:

**22.1.** Në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) datë 24.3.1994, përcaktohet se: “Me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.3.1994, i njuh të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të M. e H. K. (ku ndër të tjerë është edhe M. K. nëna e subjektit) – mbi një sipërfaqe prej 5.000 m<sup>2</sup> në lagjen ‘\*\*\*’, mbi të cilën janë ngritur 2 pallate, mbi sip. 5000 m<sup>2</sup>, 4000 m<sup>2</sup> janë të zëna nga ndërtime të pallateve shtetërore, kjo sipërfaqe kompensohet, ndërsa diferenca prej 1000 m<sup>2</sup> i kthehet ish pronarit – një godinë prej 9 dyqanesh e përbërë prej 12 apartamenteve, e ndodhur në lagjen nr.\*\*\* të Durrësit, rr. ‘\*\*\*’ – një ndërtesë e ndodhur në lagjen nr.\*\*\* të Durrësit, trualli i vet mbi të cilin janë ndërtuar 2 pallate nga shteti – mbi një sipërfaqe toke prej 428.8 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është ndërtuar një godinë me \*\*\* kate, me 1 dyqan e përbërë prej 5 apartamente, ndodhur në lagjen nr.\*\*\*, Durrës, rr. ‘\*\*\*’ – një shtëpi me

<sup>2</sup>Shihni aktet në aneksin nr. 4/2 – 4/23 dhe 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

\*\*\*kate, oborr dhe gjysmë pusi në lagjen ‘\*\*\*’, e cila është e ndërtuar mbi një sip. prej 350 m<sup>2</sup>”.

**22.2.** Në vendimin nr. \*\*\* prot., datë 18.4.1994, të KKKP-së, përcaktohet se me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.4.1994, i njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve të shtetasit M. K. (ndër të tjerë edhe M. K.) mbi një sipërfaqe prej 1830 m<sup>2</sup> në lagjen ‘\*\*\*’, Durrës, mbi të cilën janë ndërtuar nga shteti pallate \*\*\* kate, në katin përdhe të pallatit \*\*\* ndodhen magazinat e merkatos me sip. 237 m<sup>2</sup>. Në bazë të legjislacionit, pronarëve i lind e drejta e parablerjes së këtyre objekteve, diferenca prej 1000 m<sup>2</sup>, meqenëse është e zënë me objekte të ndryshme i kompensohet; me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.6.1995, të KKKP-së, korrigohet vendimi nr. \*\*\*, datë 1.4.1994, duke zbritur nga sipërfaqja prej 237 m<sup>2</sup> sipërfaqen 57 m<sup>2</sup>.

**22.3.** Në vendimin nr. \*\*\* prot., datë 27.9.1994, të KKKP-së përcaktohet se me vendimin nr.\*\*\*, datë 27.9.1994, i njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve të shtetasit M. K. (ndër të tjerë edhe M. K.) mbi një vend për banja në plazhin e Durrësit me sip. 500 m<sup>2</sup>.

**22.4.** Sipas aktit pjesëtim vullnetar nr. \*\*\*, datë 3.10.1994, trashëgimtarët e shtetasit H. K., të cilët janë shtetasit O. K., S. K., H. K., A. Z., L. H., A. Z. dhe trashëgimtarët e shtetasit M. K., të cilët janë A., M., Sh., E. dhe S. K. pjesëtojnë pasuritë e përbashkëta të tyre.

**22.5.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.1996, të KKKP-së vendoset që shtetasit M. dhe H. K. të njihen si ish pronarë të një trualli prej 3994 m<sup>2</sup> e ndodhur në lagjen nr. \*\*\*, Durrës, pronë e cila i kthehet. Nga ky truall shtetasit M. K. i kthehet sip. prej 1997 m<sup>2</sup> dhe shtetasit H. K. i plotësohet sasia prej 10.000 m<sup>2</sup>, gjithashtu kompensohen në letra me vlerë për një sipërfaqe prej 1010 m<sup>2</sup>.

**22.6.** Sipas kontratës së dhurimit nr. \*\*\*, datë 20.8.1997, pala dhuruese M. P. i dhuron shtetasit Arian Përmeti si palë pranuese e dhurimit apartamentin me sip. 75 m<sup>2</sup>, rruga ‘\*\*\*’, Durrës.

**22.7.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për shtetasen M. P., caktohen si trashëgimtarë ligjorë shtetasit A. P., Arian Përmeti dhe A. P. me 1/3 pjesë/secili.

**22.8.** Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 20.9.2013, midis shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., nga njëra anë si shoqëri ndërtuese dhe shtetasve Sh. K., E. K., S. K., A. P., A. P. dhe A. P. (P.) përcaktohen pjesët e secilit bashkëpronar për pallatin shumëkatësh të ndërtuar nga kjo shoqëri në Lagjen nr. \*\*\*, P., Durrës. Në pronësi të shtetasve Arian dhe A. P. si dhe A. P. do të kalojnë: pasuria nr. \*\*\* me sip. 95 m<sup>2</sup>, Lagjja Nr. \*\*\*, P., Durrës; pasuria nr. \*\*\*, me sip. 56 m<sup>2</sup>, Lagjja \*\*\*, P., Durrës; pasuria nr. \*\*\*, me sip. 52 m<sup>2</sup>, Lagjja Nr. \*\*\*, P., Durrës; pasuria nr. \*\*\*, me sip. 52 m<sup>2</sup>, Lagjja Nr. \*\*\*, P., Durrës; pasuria nr. \*\*\*, me sip. 51 m<sup>2</sup>, Lagjja Nr. \*\*\*, P., Durrës; pasuria nr. \*\*\*, me sip. 177.3 m<sup>2</sup>, Lagjja Nr. \*\*\*, P., Durrës.

**22.9.** ZVRPP-ja Durrës<sup>3</sup> ka konfirmuar të regjistruar në pronësi/bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti:

- apartamentin me sip. 119 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\* (bashkëlidhur kartelë pasurie, me shënimin “kontratë pjesëtimi”);
- njësi me sip. 18 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\* (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “kontratë pjesëtimi”);
- apartament me sip. 75 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie, kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 20.8.1997, me palë dhuruese M. P. dhe palë pranuese dhurimi Arian Përmeti për dhurim apartamenti me sip. 75 m<sup>2</sup>, rruga ‘\*\*\*’, Durrës);
- njësi me sip. 33.2 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\* (bashkëlidhur kartelë pasurie për njësi në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj., me shënim “kontratë pjesëtimi”);

<sup>3</sup>Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Durrës, bashkëngjitur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, të ZQRPP-së në aneksin 29, të dosjes së ILDKPKI-së.

- njësi me sip. 66 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënim “vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 29.10.2012”);
- njësi me sip. 20.3 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj. (bashkëlidhur kartelë pasurie në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj., me shënim “kontratë pjesëtimi”);
- njësi me sip. 95.33 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj. (bashkëlidhur kartelë pasurie për njësi në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj., me shënim “kontratë pjesëtimi”);
- njësi me sip. 44.68 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj. (bashkëlidhur kartelë pasurie për njësi në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj., me shënim “kontratë pjesëtimi”);
- njësi me sip. 39 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “kontratë pjesëtimi”);
- bodrum me sip. 3 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti, A. P. dhe A.P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 29.10.2012, dëshmia për M. P.”);
- njësi me sip. 18 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, ku shtetasi Arian Përmeti zotëron 3/9 pjesë (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “kontratë pjesëtimi”);
- njësi me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënim kontratë pjesëtimi);
- apartament me sip.40 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “kontratë pjesëtimi”);
- apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “kontratë pjesëtimi”);
- garazh me sip. 60 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti dhe 5 bashkëpronarëve të tjerë (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”);
- apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti dhe A.P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”);
- apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti dhe A. P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”);
- apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti dhe A. P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”);
- apartament me sip. 51 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti dhe A. P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”);
- apartament me sip. 95 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti dhe A. P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”);
- njësi me sip. 177.3 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve Arian Përmeti dhe A. P. (bashkëlidhur kartelë pasurie me shënimin “dëshmi trashëgimie”).

**22.10.** Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Durrës si më sipër, u konstatua se nuk ishte konfirmuar pasuria dyqan me sip. 48 m<sup>2</sup>. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të paraqesë dokument shkresor mbi gjendjen juridike të kësaj pasurie, dhe të drejtat e tij të pronësisë mbi këtë pasuri. Me parashtimet e tij për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigje datë 22.7.2022, të ASHK-së Durrës, në të cilën konfirmohet se pasuria nr. \*\*\*, me sip. 48 m<sup>2</sup> truall dhe 48 m<sup>2</sup> ndërtim është e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të familjes K., një nga të cilët është nëna e subjektivit.

**22.11.** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektivit rezulton se në DIPPF/2013, subjekti i ka deklaruar pasuritë e trashëguara nga nëna e tij.

**22.12.** Nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, rezulton se pasuritë me nr. rendor 21.1-21.21 janë përfituar nga subjekti i rivlerësimit si trashëgimtar ligjor i nënës së tij, znj. M. P.. Origjina e këtyre pasurive të paluajtshme të krijuara përpara vitit 2013, në të cilin subjekti është bërë subjekt deklarues, daton që në vitin 1994, kur nëna e tij ka përfituar tokë

si trashëgimtare ligjore e ish-pronareve, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

**23. Pasuri të deklaruar në deklaratën Vetting, të trashëguara nga babai A. P., të ndodhura në Tiranë.**

**23.1.** Apartament me sip. 124 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 100%.

**23.2.** Depo me sip. 2 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 100%.

**23.3.** Apartament me sip. 103 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 100%.

**23.4.** Apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 50%.

**23.5.** Apartament me sip. 70 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 50%.

**23.6.** Dyqan me sip. 64 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 100%.

**23.7.** Garazh me sip. 23 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga A. P. Pjesa takuese: 100%.

Në lidhje me këto pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**24.** Gjatë hetimit administrativ në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit dhe gjendjen juridike të pasurive 23.1-23.7, nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>4</sup>, rezultoi se:

**24.1.** Sipas shtesë kontratës nr. \*\*\*, datë 22.1.2001, me palë sipërmarrëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë porositëse/pronarë truallit A. P., I. P. dhe S. K., përcaktohen pjesët takuese të pronarëve të truallit për godinën e banimit shumëkatëshe të ndërtuar në truallin e familjes Përmeti në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, nga ku shtetasi A. P. do të marrë 6 apartamente me sip. totale 566 m<sup>2</sup>, një dyqan me sip. 64 m<sup>2</sup> dhe një garazh me sip. 67 m<sup>2</sup>.

**24.2.** Sipas kontratë shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 9.11.2010, me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasi Arian Përmeti, ku ky i fundit në shkëmbim të truallit, pronë e familjes Përmeti, merr, ndër të tjera, apartamentet me sip. 124 m<sup>2</sup>, 103 m<sup>2</sup>, 53 m<sup>2</sup>, 70 m<sup>2</sup>, 21 m<sup>2</sup> dhe 23 m<sup>2</sup>.

**24.3.** Sipas kontratë dhurimit datë 17.1.2015, me palë dhuruese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë pranuese e dhurimit Arian Përmeti, këtij të fundit i dhurohet ambienti me sip. 2 m<sup>2</sup> në pallatin \*\*\*-katësh të ndërtuar nga shoqëria në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

**24.4.** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 24.3.2016, pas vdekjes së shtetasit A.P. në datën 27.1.2016 janë përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të tij shtetasit A. P. – e bija dhe Arian Përmeti – i biri, të cilët trashëgojnë nga ½ pjesë/secili. Ky fakt është deklaruar nga subjekti në DPV/2016.

**24.5.** Me kontratë pjesëtimi vullnetar me nr. \*\*\*, datë 18.1.2016, janë pjesëtuar pasuritë e paluajtshme, në të cilat shtetasit Arian Përmeti, A. P. dhe A. P. (P.) si trashëgimtarë të znj.M.K., nëna e subjektit, janë bashkëpronarë, duke u dhënë miratimi edhe i bashkëpronarëve të tjerë A. K., Sh. K., S. K. dhe E. H. (K.), për çdo pasuri rast pas rasti ku ata janë bashkëpronarë. Sipas kësaj kontrate, të gjithë bashkëpronarët kanë qenë pronarë të truallit dhe

<sup>4</sup>Shihni aktet në aneksin nr. 4/24 – 4/30 dhe 28 në dosjen e ILDKPKI-së.



origjina e pasurive në bashkëpronësi që pjesëtohen është nga kontrata e shkëmbimit midis pronar truall dhe firmë ndërtimi.

**24.6.** ZVRPP-ja Tiranë<sup>5</sup> ka konfirmuar në pronësi të shtetasit Arian Përmeti pasuritë si vijojnë:

- apartament me sip. 124 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\* (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë shkëmbimi nr.\*\*\*, datë 9.11.2010, me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Arian Përmeti, i cili në shkëmbim të truallit pronë e familjes Përmeti merr, ndër të tjera, apartamentin me sip. 124 m<sup>2</sup>);
- njësi me sip. 2 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë dhurimi datë 17.1.2015, me palë dhuruese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë pranuese e dhurimit Arian Përmeti për dhurim ambienti me sip. 2 m<sup>2</sup>, në pallatin \*\*\*-katësh, të ndërtuar nga shoqëria në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë);
- apartament me sip. 103 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 9.11.2010, me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Arian Përmeti, i cili në shkëmbim të truallit, pronë e familjes Përmeti, merr, ndër të tjera, apartamentin me sip. 103 m<sup>2</sup>);
- apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë shkëmbimi, datë 9.11.2010 me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Arian Përmeti, i cili në shkëmbim të truallit pronë e familjes Përmeti, merr apartamentin me sip. 53 m<sup>2</sup>);
- apartament me sip. 70 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë shkëmbimi, datë 9.11.2010, me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe znj. M. P., i cili në shkëmbim të truallit pronë e familjes Përmeti merr apartamentin me sip. 70 m<sup>2</sup>. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur ky apartament në vitin 2018 ka kaluar në pronësi të shtetas A. P. me kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 25.5.2018);
- njësi me sip. 64 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 9.11.2010, me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Arian Përmeti, i cili në shkëmbim të truallit pronë e familjes Përmeti merr, ndër të tjera, dyqanin me sip. 21 m<sup>2</sup>);
- garazh me sip. 23 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit Arian Përmeti (bashkëlidhur kartelë pasurie; kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 9.11.2010, me palë shkëmbyese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Arian Përmeti, i cili në shkëmbim të truallit pronë e familjes Përmeti merr, ndër të tjera, garazhin me sip. 23 m<sup>2</sup>).

**24.7.** Në përfundim të hetimit administrativ rezulton se pasuritë me numër rendor 23.1-23.7 janë përfutuar nga subjekti i rivlerësimit si trashëgimtar ligjor i babait të tij A. P. Pasuria me numrin rendor 23.5, e llojit “apartament” rezulton se ka kaluar në pronësi të shtetas A. P. (motra) në vitin 2018, pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*.

## **25. Pasuri të tjera të deklaruara në deklaratën *Vetting* të trashëguara nga nëna M. P., të ndodhura në Tiranë dhe Durrës**

**25.1.** Ndërtesë me sip. 424 m<sup>2</sup>, me truall 1569 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria \*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 6/144.

**25.2.** Tokë truall me sip. 1000 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.

**25.3.** Tokë truall me sip. 282 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.

**25.4.** Tokë truall me sip. 417 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/12.

---

<sup>5</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë në aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

- 25.5.** Tokë truall me sip. 70 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.
- 25.6.** Tokë truall me sip. 108 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.
- 25.7.** Tokë truall me sip. 3000 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.
- 25.8.** Tokë truall me sip. 580 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.
- 25.9.** Tokë truall me sip. 435 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 1/6.
- 25.10.** Tokë truall me sip. 3100 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, dhënë për ndërtim, përfituar: 5 apartamente me sip 103 m<sup>2</sup>, 100 m<sup>2</sup>, 92 m<sup>2</sup>, 82 m<sup>2</sup>, 1 dyqan 70 m<sup>2</sup>, si dhe dy garazhe. Trashëguar nga M. P. Pjesa takuese: 50%.

ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë të dokumentacionit justifikues të pasurive me nr. 25.2 (tokë truall me sip. 1000 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/6. ), nr. 25.4 (tokë truall me sip. 417 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/12), nr. 25.5 (tokë truall me sip. 70 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/6), nr. 25.7 (tokë truall me sip. 3000 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/6) dhe nr. 25.10 (tokë truall me sip. 3100 m<sup>2</sup> dhënë për ndërtim, ku si rezultat janë përfituar 5 apartamente, 1 dyqan dhe 2 garazhe).

**26.** Gjatë hetimit administrativ u verifikua origjina, mënyra e krijimit dhe gjendja juridike të pasurive për të cilat nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>6</sup>, rezultoi se:

**26.1.** Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 28.1.1994, të KKKP-së, vendoset t'i kthehet ish-pronarëve, vëllezërve K., gjysma e godinës dykatëshe nr. 7, e ndodhur në rrugën “\*\*\*” (A. T.), duke kaluar nga pronësi shtetërore në pronësi të pronarëve.

**26.2.** Sipas Aneks Kontratës (shtojcë kontrate) të kontratës bazë të sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 30.6.2016, me palë sipërmarrëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë porositëse Arian Përmeti, A.P. dhe 10 bashkëpronarë të tjerë, Arian Përmeti dhe A. P. përfitojnë 5 apartamente me sip. 108 m<sup>2</sup>, 111 m<sup>2</sup>, 100 m<sup>2</sup>, 104 m<sup>2</sup>, 94 m<sup>2</sup>, një njësi me sip. 70 m<sup>2</sup>, si dhe dy vendparkime.

**26.3.** ASHK-ja<sup>7</sup>, pas verifikimeve të kryera, konfirmon që shtetasi Arian Përmeti dhe personat e lidhur nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

**26.4.** ZVRPP-ja Tiranë<sup>8</sup> konfirmoi truallin me sip. 1569 m<sup>2</sup>, nga e cila 424 m<sup>2</sup> ndërtesë në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti etj. (bashkëlidhur kartelë pasurie + praktika e origjinës së pronës).

**26.5.** Gjatë procesit të rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit për të paraqitur dokumentacionin justifikues mbi origjinën, mënyrën e krijimit, si dhe gjendjen aktuale juridike dhe faktike të pesë pasurive për të cilat mungonte dokumentacioni i plotë ligjor, konkretisht ato me nr. 25.2 (tokë truall 1000 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/6), nr. 25.4 (tokë truall 417 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/12), nr. 25.5 (tokë truall 70 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/6), nr. 25.7 (tokë truall 3000 m<sup>2</sup>, pjesa takuese 1/6), nr. 25.10 (tokë truall 3100 m<sup>2</sup> dhënë për ndërtim, subjekti dha sqarime dhe vuri në dispozicion<sup>9</sup> të Komisionit, si më poshtë:

- Së pari, në lidhje me pasurinë tokë truall me sip. 1000 m<sup>2</sup>, subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 10.3.1994, të KKKP-së, në pikën 1 të të cilit përcaktohet kthimi i një sipërfaqeje trualli prej 1000 m<sup>2</sup>, me sqarimin se një pjesë e kësaj sipërfaqeje është e zënë nga dy godina

<sup>6</sup>Shihni aktet në aneksin nr. 4/31 – 4/36 dhe 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>7</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2020, nga ASHK-ja, Drejtoria e Përgjithshme, Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në dosjen e Komisionit.

<sup>8</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë në aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>9</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022 dhe përgjigjet e datës 13.6.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2022, në dosjen e Komisionit.

(nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*), ndodhur në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”. Më tej, ka sqaruar se ky truall është i regjistruar në regjistrat pasurorë me dy numra pasurie, e para nr. \*\*\*, për të cilën nuk ka dijeni se si është regjistruar dhe nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e regjistruar si pronë shtet. Subjekti sqaron se për shkak të shumë bashkëpronarëve nuk ka pasur ndonjë interes nga ndonjë prej tyre për nxjerrjen e dokumentacionit. Edhe në parashtrimet e tij, subjekti ka vijuar të japë sqarime më të hollësishme në lidhje me këtë pasuri, duke informuar se pasuria nr. \*\*\* është truall nën dy godinat \*\*\* dhe \*\*\* (ndërtim me sip. 747 m<sup>2</sup>) dhe është në emër të familjes K. Ndërsa, pasuria nr. \*\*\* është truall bosh, që duke u bashkuar me truallin e parë plotëson sipërfaqen 1000 m<sup>2</sup> të pronës së kthyer me vendimin e cituar më sipër. Subjekti ka informuar se kjo pasuri është pronë e familjes K., por është e regjistruar si tokë shtet, madje ZVRPP-ja Durrës ka orientuar familjen K. për të aplikuar për korrigjim dhe për ta kaluar në emër të saj. Më tej ka informuar se mbi këtë pasuri ka pasur edhe disa ndërtime pa leje dhe janë zhvilluar disa procese gjyqësore.

Për të mbështetur pretendimet e tij në lidhje me gjendjen juridike subjekti ka paraqitur: (i) shkresën kthim përgjigje të ASHK-së Durrës të datës 22.7.2022 në të cilën konfirmohet që pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 747 m<sup>2</sup> truall dhe 747 m<sup>2</sup> ndërtim është në emër të trashëgimtarëve të familjes K.; (ii) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019, e ZVRPP-së Durrës në të cilën konfirmohet që pasuria nr. \*\*\* ka qenë afishuar në pronësi shtet dhe orientohet shtetasi S. P. K. për të vijuar me korrigjimin e pasurisë; (iii) vendimin nr. \*\*\*, datë 23.2.2005, të Gjykatës së Apelit Durrës + aktekspertimin teknik, në të cilin pasqyrohet fakti i ndërtimeve mbi sipërfaqen prej 1000 m<sup>2</sup>.

- Së dyti, në lidhje me pasurinë tokë truall me sip. 417 m<sup>2</sup>, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, subjekti ka paraqitur certifikatë pronësie për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, tokë truall me sip. 413 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të shtetasit Arian Përmeti me sqarimin (ka pasur një lapsus në sipërfaqen e kësaj pasurie, pasi ka qenë e shënuar 417 m<sup>2</sup>) se kjo është një tokë truall e lirë, e trashëguar nga gjyshi i tij, por vendimi përkatës i KKKP-së nuk disponohet. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion mbi gjendjen juridike faktike të kësaj pasurie. Në parashtrimet e tij, subjekti ka vijuar të japë sqarime më të hollësishme në lidhje me këtë pasuri, duke informuar se lapsusi në sipërfaqe është bërë nga punonjësit e ZVRPP-së, të cilët kanë regjistruar një herë 417 m<sup>2</sup>, pastaj në vijim 413 m<sup>2</sup>, por sipas vendimit të Komisionit të AKKP-së rezulton 417 m<sup>2</sup>.

Në lidhje me gjendjen juridike të kësaj pasurie, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën kthim përgjigje të datës 13.7.2022 të ASHK-së Durrës, në të cilën konfirmohet që pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit truall me sip. 413 m<sup>2</sup>, figuron në bashkëpronësi të trashëgimtarëve të familjes K.; (ii) vendimin nr. \*\*\*, datë 18.4.2008, të AKKP-së, në të cilin konfirmohet fakti i kthimit të një sipërfaqeje prej 417 m<sup>2</sup> trashëgimtarëve të familjes K.

- Së treti, në lidhje me pasurinë tokë truall me sip. 70 m<sup>2</sup>, subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2000, të KKP-së, origjina e sipërfaqes tokë truall 70 m<sup>2</sup> (sipërfaqja e saktë sipas subjektit 72 m<sup>2</sup>), me sqarimin se kjo pronë është tokë truall e lirë, e trashëguar nga gjyshi i tij. Subjekti deklaron se nuk e disponon dokumentacionin lidhur me këtë pasuri dhe se, përgjithësisht, me regjistrimin e pronave është marrë daja i tij A. K., i cili aktualisht është në gjendje jo të mirë shëndetësore. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion mbi gjendjen juridike dhe faktike të kësaj pasurie. Në parashtrimet e tij, në lidhje me gjendjen juridike të kësaj pasurie subjekti ka paraqitur: (i) shkresën kthim përgjigje të datës 22.7.2022 nga ASHK-ja Durrës, në të cilën konfirmohet se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit truall me sip. 72 m<sup>2</sup>, figuron në emër të z. A. K. etj.; (ii) vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2000, të KKP-së (paraqitur edhe gjatë procesit).

- Së katërti, në lidhje me pasurinë tokë truall 3000 m<sup>2</sup>, subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.1996, të KKKP-së, si origjina e pasurisë tokë truall me sip. 3000 m<sup>2</sup>, me sqarimin se është tokë truall e trashëguar nga gjyshi i tij, por e zënë me ndërtime informale. Subjekti

deklaron se nuk e disponon dokumentacionin e hipotekës lidhur me këtë pasuri, por në dijeninë e tij mendon që është e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të z. M. K. Më tej, subjekti ka sqaruar se referuar vendimit nr. \*\*\* të KKKP-së rezulton se nga një sipërfaqe prej 10.000 m<sup>2</sup> janë kthyer 6000 m<sup>2</sup> (të regjistruara si pasuritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*) dhe, në vijim, është bërë në mirëkuptim një ndarje e pasurisë për trashëgimtarët e shtetasit M. K. në ½ pjesë (3000 m<sup>2</sup>) që është pasuria nr. \*\*\*, ku nëna e tij ishte bashkëpronare me 1/3. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion mbi gjendjen juridike dhe faktike të tij.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka vijuar të japë sqarime më të hollësishme në lidhje me këtë pasuri, duke informuar se kjo pasuri sipas vendimit të KKP-së ka qenë 3000 m<sup>2</sup>, por një pjesë e kësaj pasurie ka pasur mbivendosje me pasurinë e shtetasit A. K. dhe një pjesë është kompensuar në vitin 2018. Në këto kushte, subjekti informon se sipërfaqja për pronarët A.K. etj., e ngelur në regjistrat e ZVRPP-së, është 2126 m<sup>2</sup>, ku dhe kjo sipërfaqe është e zënë me ndërtime pa leje nga shtetas të ndryshëm, për të cilën është bërë edhe një kompensim për familjen K. sipas një vendimi të AKKP-së të vitit 2018. Në lidhje me gjendjen juridike të kësaj pasurie dhe për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën kthim përgjigje të datës 22.7.2022 nga ASHK-ja Durrës, në të cilën konfirmohet se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 2126 m<sup>2</sup> truell figuron në emër të shtetasit A. K. etj.; (ii) skicën e pasurisë nr. \*\*\*.

- Së pesti, në lidhje me pasurinë tokë truell me sip. 3100 m<sup>2</sup>, subjekti ka paraqitur (i) vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2009, të KKKP-së, si origjina e sipërfaqes tokë truell me sip. 3100 m<sup>2</sup> (sip. e saktë sipas subjektit është 3177.2 m<sup>2</sup>), trashëguar nga gjyshi M. K., me sqarimin se mbi këtë sipërfaqe është bërë ndërtim, tek i cili si trashëgimtarë të znj. M. P. janë marrë 5 apartamente, 1 dyqan dhe dy garazhe; (ii) aneks kontratë nr. \*\*\*, datë 21.3.2018, të lidhur mes porositësve ndër të cilët edhe Arian Përmeti dhe shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*”, ku përcaktohen pjesët takuese për secilin prej bashkëpronarëve të truallit, ku A. P. dhe motra e tij kanë përfituar 5 apartamente, 1 dyqan dhe dy garazhe. Në dijeninë e subjektit, trualli me sip. 3177.2 m<sup>2</sup> duhet të jetë i regjistruar në emër të trashëgimtarëve K., pasi sipas tij ende nuk është bërë regjistrimi nga ana e ndërtuesit në hipotekë të pallateve të ndërtuara, ndërkohë deklaron se nuk disponon dokumentacion. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi gjendjen juridike dhe faktike të kësaj pasurie.

Në parashtrimet e tij subjekti ka vijuar të japë sqarime më të hollësishme në lidhje me këtë pasuri, duke informuar se kjo sipërfaqe i përket pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në emër të shtetasit A. K. etj. Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 23.6.2009, të KKKP-së sipërfaqja totale ka qenë 3177 m<sup>2</sup>, por në një pjesë të saj ka pasur mbivendosje me pasurinë nr. \*\*\*, në emër të shtetasit A. Q. (në një sipërfaqe rreth 800 m<sup>2</sup>). Më tej, subjekti ka informuar se mes familjes K. dhe familjes Q. është zhvilluar edhe një proces gjyqësor në lidhje me këtë pasuri dhe se në këtë pasuri janë ndërtuar pallatet nga shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*”, në të cilat ai ka marrë pjesën takuese sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2018.

Në lidhje me gjendjen juridike të kësaj pasurie dhe për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën kthim përgjigje të datës 22.7.2022, nga ASHK-ja Durrës, në të cilën konfirmohet se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 2313 m<sup>2</sup> truell figuron në emër të shtetasit A.K. etj. dhe se për këtë pasuri po zhvillohet proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë; (ii) vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, nr. \*\*\*, datë 15.3.2017 + aktekspertimi sipas të cilit është vendosur pranimi i padisë së familjes K. për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKKP-së së Prefekturës të Qarkut Durrës për kompensimin fizik të sip. 800 m<sup>2</sup> familjes Q.

Sqarimet e subjektit në lidhje me pesë pasuritë si më sipër përputhen me informacionin e dhënë nga ASHK-ja Durrës dhe me dokumentacionin e paraqitur.

**26.6.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se pasuritë me nr. rendor 25.1-25.10 janë të përfituara nga subjekti me trashëgimi nga nëna e subjektit M. P. Origjina e këtyre pasurive

të paluajtshme të krijuara përpara vitit 2013, vit në të cilin subjekti është bërë subjekt deklarues, daton që në vitin 1994, kur nëna e tij ka përfituar tokë si trashëgimtare ligjore e ish-pronarëve, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

**27.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Makinë ‘Audi \*\*\*’, \*\*\*, vlera 650.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**27.1.** Gjatë hetimit administrativ, DPSHTRR-ja<sup>10</sup> konfirmoi të regjistruar aktualisht në emër të shtetasit Arian Përmeti, automjetin me targë \*\*\*.

**27.2.** Në lidhje me mënyrën e krijimit dhe deklarimet e subjektit, nga dokumentet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>11</sup> rezulton se subjekti e ka blerë këtë automjet në vlerën 2.700 euro, nga shtetasi D. L., banues në Itali, në bazë të deklaratës verbale të shitjes së automjetit, datë 10.8.2008. Gjithashtu, në datën 28.9.2008, është kryer zhdoganimi i këtij automjeti në vlerën 309.221 lekë. Këtë automjet subjekti e ka deklaruar edhe në DPFD/2013, por pa deklaruar burimin.

**27.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie. Në parashtrimet e tij subjekti ka informuar se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë kursimet nga pagat dhe të ardhurat nga qiratë, të cilat deri në vitin 2008 kanë qenë të mjaftueshme.

Në procesin e vendimmarrjes, lidhur me këtë fakt, Komisioni vlerësoi se gjendet përpara një pasaktësie formale në deklarime, e pashoqëruar me mungesë financiare.

**27.4.** Analiza mbi mundësinë financiare të subjektit për të paguar në total shumën 641.814 lekë, është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi viti 2008 i takon periudhës para emërimit në detyrë. Sipas kësaj analize, treguar në tabelën vijuese, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të blerë automjetin në vlerën 2.700 euro dhe për të paguar shpenzimet e zhdoganimit.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 1994 – 2008</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>2 420 149</b>
Autoveturë tip “Mercedes-Benz ***”, ***, blerë më 15.5.1999	400 000
Autoveturë tip “Audi” ***, blerë verbalisht më 10.8.2008	332 593
Shpenzime doganore	309 221
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	<i>1 378 336</i>
<b>Të ardhurat</b>	<b>18 693 789</b>
Të ardhura nga paga subjekti 1994 – maj 2013	4 121 320
Taksë solidariteti subjekti	274 259
Nga vendimi gjyqësor subjekti	362 620
Të ardhura nga paga bashkëshortja nga data 4.10.2001 (data e martësës)	2 530 266
Taksë solidariteti bashkëshortja	28 625
Leje barrë lindje bashkëshortja	281 652
Pensioni babai	1 298 534
Pensioni nëna	1 031 351
Të ardhura nga interesa bankare	3 785
Te ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan	200 000
Të ardhura nga qiratë e prindërve	8 561 378
<b>Shpenzimet</b>	<b>6 528 378</b>
Shpenzime jetike sipas përbërjes familjare	5 935 281
Shpenzime mobilimi për apartamentin ku banon subjekti	350 000
Shpenzime mobilimi	150 000
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	93 097

<sup>10</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>11</sup>Shihni aktet në aneksin 4/37 në dosjen e ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

**27.5.** Kjo analizë i takon periudhës 1994, kur subjekti ka filluar punë në Drejtorinë e Policisë Tiranë dhe ka paraqitur të ardhura edhe deri në vitin kur është blerë automjeti. Subjekti është analizuar së bashku me familjen e tij, prindërit dhe pas martesës edhe bashkëshortja e tij. Në këtë analizë janë përfshirë: të ardhura të të gjithë pjesëtarëve të familjes; të ardhura nga qiratë e prindërve të subjektit; vlera e automjeteve të blera nga subjekti në vitin 1999 dhe automjeti që po analizohet, blerë në gusht të vitit 2008; likuiditetet e të gjithë familjarëve; shpenzimet e tyre të jetesës janë përlllogaritur si 66% e të ardhurave familjare deri në vitin 1999 dhe nga viti 2000 e në vijim bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe sipas përbërjes familjare<sup>12</sup>; shpenzimet e udhëtimeve dhe ato të mobilimit.

**27.6.** Pas parashtrimeve të subjektit dhe marrjes në konsideratë si të ardhura të ligjshme të disa prej qirave të përfituara nga nëna dhe babai i tij, sikurse është trajtuar në mënyrë të hollësishme në këtë vendim, mundësia për kursime për periudhën 1994-2008 u bë 13.036.548 lekë.

**28.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Bono thesari (në llogarinë nr. \*\*\*) në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, shuma 15.700.000 lekë, pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: kursime familjare, trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P. si dhe qira ambientesh*”. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

#### **Mbi mënyrën e krijimit të bonove të thesarit**

**28.1.** Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i dokumenteve bankare të administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>13</sup>, por edhe nga ato të administruara nga Komisioni, është konstatuar se depozita me vlerë 15.700.000 lekë e ka origjinën para fillimit të detyrës dhe, më pas, është zhvilluar gjatë saj, konkretisht si vijon:

- Para fillimit të detyrës: në datën 28.6.2012, subjekti ka investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë shumën 2.800.000 lekë, me afat 1-vjeçar, me maturim në datën 27.6.2013; në datën 30.1.2013 subjekti ka investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë shumën 3.200.000 lekë, me afat 1-vjeçar, me maturim në datën 30.1.2014, pra vlera e bonove të thesarit të investuara para fillimit të detyrës është në total në shumën 6.000.000 lekë.

- Viti 2013: në datën 20.6.2013, subjekti ka shtuar shumën 3.500.000 lekë dhe së bashku me shumën e maturuar prej 2.800.000 lekësh ka investuar në bono thesari te Banka e Shqipërisë shumën prej 6.300.000 lekësh në datën 27.6.2013, me afat 1-vjeçar, me maturim në datën 26.6.2014; në datën 11.7.2013, subjekti ka investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë shumën 2.500.000 lekë, me afat 6-mujor, me maturim më 9.1.2014; gjendja e bonove të thesarit të investuara në datën 31.12.2013 është 12.000.000 lekë, e përbërë nga shuma 6.300.000 + 3.200.000 + 2.500.000 lekë, sikurse më sipërpërshkruar.

- Viti 2014: me maturimin e shumave 3.200.000 lekë në datën 30.1.2014 dhe 2.500.000 lekë në datën 9.1.2014 është përfutur një total prej 5.700.000 lekësh, i cili është investuar në bono thesari në datën 30.1.2014, me afat 1-vjeçar, me maturim më 29.1.2015; me maturimin e shumës 6.300.000 lekë në datën 26.6.2013, ajo është riinvestuar në bono thesari me afat 1-vjeçar deri më 26.6.2014, me maturim në datën 25.6.2015; gjendja e bonove të thesarit të investuara në datën 31.12.2014 është 12.000.000 lekë, e përbërë nga shuma 6.300.000 + 5.700.000 lekë, sikurse më sipërpërshkruar.

<sup>12</sup>Përbërja familjare është: 3 persona (subjekti dhe 2 prindërit) deri më 4.10.2001, datë në të cilën shtohet edhe bashkëshortja; në datën 6.8.2002 përfshihet vajza e parë dhe në datën 7.2.2005 përfshihet edhe vajza e dytë.

<sup>13</sup>Shihni aktet në aneksin 4/38 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Viti 2015: pas maturimit të bonove të thesarit prej 5.700.000 lekësh në datën 29.1.2015, shuma 6.000.000 lekë riinvestohet në bono thesari nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 9.2.2015, me afat 5-vjeçar; pas maturimit të bonove të thesarit prej 6.300.000 lekësh nga Banka e Shqipërisë në datën 25.6.2015, shuma prej 6.500.000 lekësh riinvestohet në bono thesari nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 10.8.2015, me afat 5-vjeçar; gjendja e bonove të thesarit të investuara deri në datën 31.12.2015 është 12.500.000 lekë, e përbërë nga shuma 6.000.000 + 6.500.000 lekë, të riinvestuara gjatë këtij viti, sikurse më sipërpërkshkruar.

- Viti 2016: në datën 29.12.2016, subjekti ka depozituar *cash* shumën 2.500.000 lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank” me përshkrimin “të ardhura të kursyera në familje dhe personale”. Në datën 30.12.2016 është kryer një transfertë brenda “Intesa Sanpaolo Bank”, nga llogaria A. P.<sup>14</sup> në llogarinë Arian Përmeti, në shumën 500.000 lekë. Së bashku me interesat e përfituara nga investimet në bono thesari pranë kësaj banke, shuma prej 3.200.000 lekësh është investuar në bono thesari 10-vjeçare, në datën 9.1.2017, pra para plotësimit të deklaratës *Vetting*. Gjendja e bonove të thesarit të investuara deri në deklaratën *Vetting* është 15.700.000 lekë, duke përfshirë shumat e investuara gjatë vitit 2015 me shtesat e kryera gjatë vitit 2016 dhe deri në deklaratën *Vetting*.

**28.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me faktet e evidentuara nga lëvizjet e llogarive bankare.

### **Mbi burimin e krijimit të bonove të thesarit në shumën 15.700.000 lekë**

**28.3.** Si burim për krijimin e bonove të thesarit, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; si dhe (iii) qira ambientesh.

**28.4.** Nga verifikimet e lëvizjeve bankare të babait të subjektit është evidentuar se bonot e thesarit vijnë nga këto burime:

- shuma prej 2.800.000 lekësh – në datën 22.6.2012: babai i subjektit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”<sup>15</sup> shumën 2.800.500 lekë, me përshkrimin “A. A. P. derdh në llogari” dhe në të njëjtën datë kjo shumë është investuar në emër të subjektit në bono thesari te Banka e Shqipërisë;

- shuma prej 3.200.000 lekë – në datën 23.1.2013: babai i subjektit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” shumën 3.201.500 lekë, me përshkrimin “A. P., derdh nga kursimet” dhe në të njëjtën datë kjo shumë është investuar në emër të subjektit në bono thesari te Banka e Shqipërisë;

- shuma 3.500.000 lekë – në datën 19.6.2013: babai i subjektit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” shumën 3.500.000 lekë, me përshkrimin “A. P. të ardhura nga kursimet”, dhe në të njëjtën datë kjo shumë është investuar në emër të subjektit në bono thesari te Banka e Shqipërisë.

**28.5.** Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit vërehet se në DPDFD subjekti ka deklaruar se ka investuar në bono thesari shumën prej 9.500.000 lekësh me burim kursime familjare dhe lekë *cash* të trashëguara nga nëna M. P.

**28.6.** Pra, siç vërehet, ka mospërputhje midis: (i) shumave të krijuara deri në datën e emërimit në detyrë të subjektit (28.5.2013), të cilat rezultojnë të jenë 6.000.000 lekë; dhe (ii) shumave të deklaruara nga subjekti në DPDFD, të cilat janë 9.500.000 lekë.

<sup>14</sup>Kjo llogari është në emër të shtetasve A. dhe Arian Përmeti dhe veprimi është kryer nga subjekti pas vdekjes së babait (datë 27.1.2016).

<sup>15</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, të “Raiffeisen Bank”.

**28.7.** I pyetur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka sqaruar<sup>16</sup> se ka plotësuar DPDFD-në në datën 26.6.2013, duke deklaruar gjendjen e likuiditeteve në Bankën e Shqipërisë, në këtë datë. Të njëjtën përgjigje ka dhënë edhe i pyetur nga Komisioni, duke deklaruar se përveç shumës 6.000.000 lekë, të investuara në bono thesari para fillimit të detyrës, në datën 19.6.2013 (pra disa ditë para plotësimit të DPDFD-së), ai ka depozituar *cash* shumën prej 3.500.000 lekësh.

**28.8.** Nga sa më sipër, në total shuma 9.500.000 lekë, e investuar nga subjekti në bono thesari, vjen nga kursimet e babait të tij A. P. Kjo shumë është përfshirë si pasuri/likuiditet në analizën financiare të subjektit në këtë mënyrë: shuma 6.500.000 lekë para detyrës dhe shuma 3.500.000 lekë, gjatë detyrës, për periudhën 28 maj deri më 31.12.2013. Shuma 2.500.000 lekë është depozituar *cash* nga subjekti në datën 2.7.2013, në llogarinë e babait të tij në “Raiffeisen Bank”<sup>17</sup>, me përshkrimin “Arian Përmeti derdh nga kursimet” dhe në të njëjtën datë kjo shumë është investuar në emër të tij në bono thesari te Banka e Shqipërisë. I pyetur për burimin e kursimeve që kanë shërbyer për depozitimin e shumës në “Raiffeisen Bank”, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ajo vjen nga pakësimi i gjendjes *cash*, pakësim i cili është deklaruar prej tij në DPV/2013. Nga verifikimi i DPV/2013 ka rezultuar se subjekti e ka kryer deklarimin për pakësim të gjendjes *cash*. Sa i takon gjendjes *cash*, ajo është krijuar para fillimit të detyrës datë 28.5.2013 dhe është deklaruar nga subjekti në DPDFD; shuma 2.500.000 lekë – në datën 29.12.2016, subjekti ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 2.500.000 lekë<sup>18</sup>, me përshkrimin “të ardhura të kursyera në familje dhe personale”. Nga verifikimi i DPV/2016 ka rezultuar se subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, në shumën 2.500.000 lekë, e cila ka shërbyer për depozitimin në “Intesa Sanpaolo Bank”. Sa i takon gjendjes *cash*, ajo është krijuar gjatë viteve 2013 dhe 2014 dhe mundësia e subjektit për ta krijuar këtë shumë është analizuar në çështjen \*\*\*, në vijim; shuma 500.000 lekë – në datën 30.12.2016 është kryer një transfertë nga llogaria e babait të subjektit në “Raiffeisen Bank”<sup>19</sup> në llogarinë Arian Përmeti në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 500.500 lekë. Kështu, në datën 30.12.2016, në llogarinë e subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” është kredituar shuma 3.000.000 lekë, e cila, së bashku me një pjesë të interesave të përfituar nga investimet e mëparshme të subjektit, është investuar në bono thesari në datën 9.1.2017.

**28.9.** Në përfundim të hetimit administrativ, të gjitha shumat e mësipërme janë përfshirë si pasuri/likuiditet në analizën financiare të subjektit, duke u analizuar sipas periudhave të krijimit dhe burimeve të deklaruara nga subjekti.

**29.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Llogari bankare në lekë nr. \*\*\*, në ‘Intesa Sanpaolo Bank’.* Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; (iii) qira ambientesh. Shuma 589.000 lekë, pjesa takuese 100%”. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**29.1.** Gjatë hetimit administrativ, “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, ka konfirmuar se shtetasi Arian Përmeti ka llogari bankare me gjendje 589.006,44 lekë, në datën 30.1.2017, gjendja e së cilës është krijuar me akumulimin e interesave të përfituara nga subjekti, nga investimi në bono thesari.

**29.2.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të “Intesa Sanpaolo Bank”, të administruar nga Komisioni.

<sup>16</sup>Shihni sqarimet e dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së sipas PV të datës 13.7.2016, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

<sup>17</sup>Në DPDFD subjekti ka deklaruar se në vitin 2013 është shtuar në këtë llogari si firmë e autorizuar për kryerje veprimesh për shkak të moshës së poseduesit të llogarisë.

<sup>18</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>19</sup>Kjo llogari është në emër të shtetasve A. dhe Arian Përmeti dhe veprimi është kryer nga subjekti pas vdekjes së babait (datë 27.1.2016).



**30.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Llogari bankare në dollarë nr. \*\*\*, në “Intesa Sanpaolo Bank”*. *Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; (iii) qira ambientesh. Shuma 10.891 dollarë. Pjesa takuese: 100%*”. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**30.1.** Gjatë hetimit administrativ, DPPPP-ja<sup>20</sup> ka konfirmuar se në datën 23.1.2017, subjekti ka depozituar *cash* shumën 10.000 USD.

**30.2.** “Intesa Sanpaolo Bank” ka konfirmuar se shtetasit Arian dhe A. P. kanë llogari bankare në dollarë me gjendje 10.891 USD, në datën 31.1.2017. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie ka rezultuar se në datën 22.5.2015 znj. A. P. ka përfituar me transfertë shumën 752 USD si pagesë nga UNDP-ja; në datën 23.1.2017, subjekti ka depozituar shumën 10.000 USD me përshkrimin “*cash* depozitë, Arian Përmeti, kursime, qira nga bizneset”.

**30.3.** Nga deklaratimet e subjektit rezulton se në DPV/2017 subjekti e ka deklaruar shtimin e llogarisë bankare me shumën 10.000 USD, si rezultat i pakësimit të gjendjes *cash* me 10.000 USD; në DPV/2016, subjekti ka deklaruar krijim e gjendjes *cash* prej 10.000 USD, me burim nga të ardhurat vjetore etj.

**30.4.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të përcjellë nga “Intesa Sanpaolo Bank”, të administruar nga Komisioni.

**31.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Llogari bankare në dollarë nr. \*\*\*, në “Intesa Sanpaolo Bank”*. *Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; (iii) qira ambientesh. Shuma: 59.525 euro. Pjesa takuese: 100%*”. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**31.1.** Gjatë hetimit administrativ, DPPPP-ja<sup>21</sup> ka konfirmuar se në datën 23.1.2017 subjekti ka depozituar *cash* shumën 52.250 euro.

**31.2.** “Intesa Sanpaolo Bank” ka konfirmuar se shtetasi Arian Përmeti ka llogari bankare në dollarë me gjendje 59.525 euro, në datën 31.1.2017. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie ka rezultuar se: kjo llogari është çelur në datën 9.2.2015 dhe ka shërbyer për derdhjen e qirave mujore në shumën 340 euro nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., nga data e çeljes dhe deri në maj të vitit 2019. Shuma në total e krijuar nga qiratë, deri në deklaratën *Vetting* është 7.275 euro; në datën 23.1.2017, subjekti ka depozituar shumën 52.250 euro me përshkrimin “*cash* depozitë, Arian Përmeti, qira nga bizneset”.

**31.3.** Nga verifikimi i deklaratimeve vjetore të gjendjes *cash* ka rezultuar se në fund të vitit 2016 subjekti ka pasur shumën 104.000 euro<sup>22</sup>, e cila është krijuar dhe mbartur nga viti në vit, qysh nga periudha para fillimit të detyrës dhe e deklaruar në DPFD.

**31.4.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të përcjellë nga “Intesa Sanpaolo Bank”, të administruar nga Komisioni.

**32.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Llogari bankare në euro, nr. \*\*\*, në “Raiffeisen Bank”*. *Burimi i krijimit: kursime familjare. Shuma: 5.500 euro. Pjesa takuese: 100%*”. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**32.1.** Gjatë hetimit administrativ, “Raiffeisen Bank”<sup>23</sup> ka konfirmuar se shtetasi Arian Përmeti ka llogari bankare në euro me gjendje 5.550 euro, në datën 31.1.2017. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie ka rezultuar se ajo është çelur në datën 7.5.2008, pra para fillimit të

<sup>20</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2017, administruar në Aneksin 38 të dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>21</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2017, administruar në Aneksin 38 të dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>22</sup>Shihni trajtimin e gjendjes *cash* te pasuria nr. 47 e këtij relacioni.

<sup>23</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

detyrës së subjektit dhe, në të njëjtën datë, ai ka depozituar *cash* shumën 4.950 euro, me përshkrimin “Arian Përmeti derdh në llogari”.

**32.2.** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë llogari në DPFD, datën e çeljes së saj, shumën fillestare të depozituar dhe burimin *kursime familjare*.

**32.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të përcjellë nga “Intesa Sanpaolo Bank”, të administruar nga Komisioni.

**33.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Llogaria bankare në euro, nr. \*\*\*, në BKT, në emër të A. P., emër i dytë Arian Përmeti. Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) qira ambientesh. Shuma: 22.300 euro. Pjesa takuese: 100%*”. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**33.1.** Gjatë hetimit administrativ, BKT-ja<sup>24</sup> ka konfirmuar llogarinë dyemërore në euro të A.A.P. ose Arian A. Përmeti, e cila është çelur në datën 2.5.2008, pra para fillimit të detyrës së subjektit. Kjo llogari ka shërbyer për derdhjen e qirave mujore në shumën 550 euro, nga shoqëritë “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”, në bazë të kontratave të lidhura midis A. P. dhe secilës prej shoqërive. Pagesat e qirave janë kryer nga data e çeljes së llogarisë dhe kanë vazhduar deri më 24.12.2010. Çdo shumë e përfituar nga qiratë është investuar në depozita me afat, në të njëjtën bankë, nga babai i subjektit derisa në datën 28.5.2013 (datë e emërimit të subjektit) shuma e depozitave arrin në vlerën 21.737,96 euro. Këto depozita janë riinvestuar në mënyrë automatike deri sot. Gjendja e tyre në momentin e deklaratës *Vetting* është 22.222 euro.

**33.2.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të përcjellë nga BKT-ja, të administruar nga Komisioni.

**34.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Llogaria bankare në lekë, nr. \*\*\* në ‘Raiffeisen Bank’, në emër të A. P., emër i dytë Arian Përmeti. Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; (iii) qira ambientesh. Shuma: 103.736 lekë. Pjesa takuese: 100%*”. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**34.1.** Nga verifikimet e DPV-ve ka rezultuar se subjekti: (i) në DPFD e ka deklaruar këtë llogari me shumën 100.000 lekë<sup>25</sup>; (ii) në DPV/2015 ka deklaruar shtim të shumës 620.000 lekë në këtë llogari dhe burim *shumë e dhënë si kompensim nga AKKP-ja*.

**34.2.** “Raiffeisen Bank”<sup>26</sup> ka konfirmuar llogarinë në lekë në emër të shtetasit A. A. P., e cila është çelur në datën 24.5.2010, pra para fillimit të detyrës së subjektit. Në datën e çeljes së saj janë depozituar prej tij dy shuma në total 230.625 lekë. Në këtë llogari janë kryer veprime të ndryshme nga babai i subjektit. Gjendja e llogarisë më 31.12.2015 është 720.038 lekë ose e shtuar me 622.000 lekë, sikurse ka deklaruar subjekti në DPV/2015. Llogaria është mbyllur më 28.12.2018, nga subjekti.

**34.3.** Sa i takon burimit të këtij shtimi, ajo vjen nga depozitimi i shumës 1.200.000 lekë në datën 14.5.2015, me përshkrimin “kalim të pjesës dhënë nga Agjencia e Kompensimit të Pronave”. Gjendja e llogarisë në deklaratën *Vetting* është 103.736 lekë.

**34.4.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të përcjellë nga BKT-ja, të administruar nga Komisioni.

<sup>24</sup>Shihni shkresat nr. \*\*\* prot. dhe \*\*\* prot., të dyja të datën 8.11.2021, të BKT-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup>Shihni DPFD f. 4, pika 36, ku subjekti e deklaroi këtë llogari bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të babait A. P. Shtuar në vitin 2013 Arian Përmeti, autorizuar firmë e dytë për kryerje veprimesh (për arsye moshe të poseduesit).

<sup>26</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

**35.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash. Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; (iii) qira ambientesh. Shuma: 1.200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”.

**35.1.** Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimet e DPV-ve, ka rezultuar se subjekti ka kryer deklaratimet e treguara në tabelën vijuese në lidhje me gjendjet, shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash*.

<i>Vitet</i>	<i>Me fjalë</i>	<i>Shuma e deklaruar</i>	<i>Gjendja e përlogaritur e likuditeteve në fund të çdo viti</i>
DPFD	<i>Gjendje cash</i>	2.700.000 lekë 88.500 euro	2.700.000 lekë 88.500 euro
DPV/2013	<i>Pakësim i gjendjes cash, shtim bono thesari më 2.7.2013 në BSH + shtim gjendje cash</i>	-2.500.000 lekë +900.000 lekë + 1.500 euro	1.100.000 lekë 90.000 euro
DPV/2014	<i>Shtim gjendje cash</i>	+1.000.000 lekë +4.000 euro	2.100.000 lekë 94.000 euro
DPV/2015	<i>Shtim gjendje cash</i>	+10.000 euro	2.100.000 lekë 104.000 euro
DPV/2016	<i>Pakësim i gjendjes cash dhe shtim llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, shtim i gjendjes cash</i>	-2.500.000 lekë +1.700.000 lekë +10.000 USD	1.300.000 lekë 104.000 euro 10.000 USD
D. <i>Vetting</i> 30.1.2017	<i>Gjendje cash</i>		1.200.000 lekë

**35.2.** I pyetur pranë ILDKPKI-së se sa ka qenë gjendja e likuditeteve *cash* në datën 31.12.2014, në procesverbalin e datës 13.7.2016, subjekti ka deklaruar se ka 2.100.000 lekë dhe 91.640 euro, deklarim mjaft i përafërt me ato të DPV/2014.

**35.3.** Subjekti ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe të saktë shtesat dhe pakësimet e gjendjeve *cash*, nga viti në vit, dhe nga këto deklarime është përlogaritur gjendja e likuditeteve *cash*, në datën 31 dhjetor të çdo viti. Kjo saktësi në deklarim provohet edhe nga: (i) shumat e ruajtura dhe të akumuluar në banesë *cash* deri në datën 31.12.2016 janë depozituar nëpër banka, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, pak ditë para deklaratës *Vetting* dhe, konkretisht: në datën 23.1.2017 janë depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank” shuma 52.250 euro me përshkrimin “të ardhura nga qiratë e bizneseve” dhe shuma 10.000 USD në llogarinë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortes së tij me përshkrimin “kursime, qira nga bizneset”; në datën 20.1.2017 shuma 50.000 euro është depozituar në BKT nga bashkëshortja e subjektit. Pra, në total është pakësuar gjendja *cash* me 102.250 euro dhe 10.000 USD; (ii) deklarimi i gjendjes *cash* të mbetur në shumën 1.200.000 lekë.

**35.4.** Në parashtrimet e tij subjekti ka kundërshtuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2014, e cila sipas tij ka qenë në vlerën 2.100.000 lekë dhe 91.640 euro, duke sjellë në cilësinë e provës

deklarimet e tij për këtë çështje në korrik të vitit 2016 pranë ILDKPKI-së<sup>27</sup>. Subjekti sqaron se nga shuma totale prej 4.000 euro e kursyer për vitin 2014, vetëm 1.645 euro ishin *cash*, ndërsa 2.355 euro kanë qenë gjendje në BKT, të përfituara nga qiraja e derdhur e shoqërisë “\*\*\*”<sup>28</sup>, duke mos bërë kështu ndarjen e vlerave *cash* dhe ato në bankë.

**35.5.** Nga verifikimi i gjendjes së likuditeteve nëpër banka ka rezultuar se deklarimet e mësipërme të subjektit qëndrojnë, si për shtesën e llogarisë në BKT, ashtu edhe për burimin e kësaj shtese.

**35.6.** Pavarësisht se kjo mënyrë deklarimi e gjendjes *cash* ka ndodhur vetëm në DPV/2014, në kushtet kur: (i) subjekti e ka sqaruar në mënyrë të saktë situatën në procesverbalin e ILDKPKI-së në korrik të vitit 2016; (ii) si provë për gjendjen *cash* janë deklarimet e subjektit ndër vite dhe gjatë gjithë procesit, në përfundim Komisioni ka rishikuar gjendjen *cash* nga viti 2014 e në vijim, duke e konsideruar atë, në këtë mënyrë: për vitin 2014 – 2.100.000 lekë dhe 91.645 euro; për vitin 2015 – 2.100.000 lekë dhe 101.645 euro; për vitin 2016 – 1.300.000 lekë, 101.645 euro dhe 10.000 USD; në deklaratën *Vetting* – 1.200.000 lekë (mbetet e pandryshuar). Pas këtyre ndryshimeve, por edhe ndryshimeve të tjera të marra në konsideratë nga prapësimet e subjektit, rezultati i analizës financiare të vitit 2014 ka ndryshuar nga negativ në pozitiv, sikurse është treguar në tabelën përfundimtare në fund të kriterit të pasurisë.

### **Burimet për krijimin e pasurive të luajtshme të subjektit**

**36.** Meqenëse pasuritë e përshkruara në pikat 27 deri 35, kanë burime të njëjta, konkretisht: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit M. dhe A. P.; dhe (iii) qira ambientesh, ato janë analizuar si vijon:

#### **Analizë e burimit: kursime familjare**

**37.** Ky burim përbëhet nga: (i) shumat e krijuara nga të ardhurat (pagat, pagesa barrë lindje dhe shpërblime të tjera) e subjektit dhe bashkëshortes së tij nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting*; (ii) pensionet e prindërve të subjektit, të cilët kanë jetuar së bashku në një ekonomi të përbashkët deri sa ata kanë ndërruar jetë<sup>29</sup>; (iii) interesat e përfituara nga investimi i parave në bono thesari. Mundësia financiare e subjektit për t’i krijuar këto kursime është trajtuar në vijim.

Në parashtrimet e tij subjekti, duke pretenduar që ka nisur bashkëjetesën me bashkëshorten e tij që në shtator të vitit 1996, kërkon që në analizën financiare përpara detyrës të përfshihen edhe të ardhurat e bashkëshortes që nga kjo periudhë. Ai pretendon se kursimet e bashkëshortes për këtë periudhë janë në vlerën 250.135 lekë<sup>30</sup>, të cilat duhet të shtohen në analizën financiare të tij për periudhën para detyrës. Subjekti ka paraqitur një deklaratë me shkrim dore me datë 18.7.2022 të bashkëshortes së tij A. P., në të cilën konfirmohen deklarimet e tij, por, nuk ka paraqitur ndonjë dokument për t’i provuar të ardhurat e pretenduara, të cilat mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mund të merren në konsideratë nga Komisioni.

#### **Analizë e burimit: shuma të trashëguara nga prindërit M. dhe A. P.**

**38.** Sa i takon këtij burimi, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka trashëguar shumën 25.000.000 lekë nga prindërit e tij<sup>31</sup> dhe konkretisht, nga: (a) aktiviteti i vetëpunësimit të prindërve në Elbasan gjatë viteve 1992 – 1998; (b) shitja e apartamentit në Elbasan nga

<sup>27</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 5 në procesverbalin datë 13.7.2016, të ILDKPKI-së, përcjellë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2021.

<sup>28</sup>Shihni kontratën nr. \*\*\*\*, datë 1.7.2014, me palë Arian Përmeti dhe shoqëria profesionale “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila më 31.12.2014 ka një vlerë totale prej 2.355 euro.

<sup>29</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 2 të pyetësorit nr. 3, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022.

<sup>30</sup>Subjekti ka përlllogaritur pagën dhe taksën e solidaritetit për periudhën shtator 1996 – 4.10.2001 dhe shpenzime për një person si: të ardhura 669.593 lekë – shpenzime për 1 person 419.457 lekë = 250.135 lekë.

<sup>31</sup>Shihni faqen 12 të deklaratës *Vetting*.

privatizimi i ish-banesave shtetërore; (c) të ardhurat si rezultat i shitjeve të tokave të zëna nga informaliteti; (d) të ardhurat nga kompensimi i pronave për trashëgimlënësen M. P., si trashëgimtare e trashëgimlënësit M. K., dhënë nga AKKP-ja (rreth 4.000.000 lekë); (e) të ardhurat nga A. P., dëmshpërblim si i përndjekur politik (dosja e dëmshpërblimit në emër të trashëgimlënësit A. P. (5 këste rreth 800.000 lekë); (f) të ardhura nga qiratë, të cilat janë trajtuar në vijim, si burim më vete.

**39.** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu verifikime për secilin prej këtyre burimeve, duke i kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion për të provuar deklaratimet e tij në lidhje me këto burime të ardhurash, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka sqaruar dhe ka paraqitur sa vijon:

**39.1. Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i prindërve** – subjekti nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument, por ka sqaruar se pret përgjigje nga DRT-ja Elbasan. Në këto kushte, Komisioni i është drejtuar edhe vetë DRT-së Elbasan dhe, njëkohësisht, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të paraqesë informacion nga DRT-ja Elbasan. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni është informuar nga DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2022, se nuk ka rezultuar person fizik i regjistruar me emrat e prindërve të subjektit. Gjithashtu, as subjekti nuk ka paraqitur informacion dhe shpjegime në lidhje me këto të ardhura dhe, për këtë arsye, në analizën financiare nuk janë konsideruar si burim i ligjshëm.

**39.2. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan në pronësi të prindërve të tij**<sup>32</sup>, subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.10.1995, ku vlera e objektit është përcaktuar 200.000 lekë. Sipas informacionit të ASHK-së Elbasan<sup>33</sup> vërtetohet fakti që pas shitjes së pasurisë nga prindërit e subjektit, pasuria është regjistruar në emër të blerësit S. B., pra tatimi mbi të ardhurat e përfituara, referuar ligjit nr.8438/28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” konsiderohet i paguar<sup>34</sup>. Në këto kushte, shuma prej 200.000 lekësh është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të subjektit.

**39.3. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e tokave të zëna nga informaliteti**, subjekti ka deklaruar se shitja e tyre është bërë nga prindërit e tij, nga viti 1993 e në vijim dhe se ai nuk ka qenë aktiv në këto veprime dhe as nuk i disponon kontratat e shitjeve. Subjekti ka kërkuar informacion nga Ministria e Drejtësisë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, nuk ka dhënë informacion për kontrata para datës 1.3.2013, datë kur është krijuar regjistri noterial. Më tej, gjatë hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi zyrës së regjistrimit noterial, pranë Ministrisë së Drejtësisë, aktet noteriale që disponohen për prindërit, e cila në përgjigjen e saj<sup>35</sup> ka informuar se nga verifikimi në sistemin RNSH nuk rezultuan kontrata noteriale për kalim pasurish të luajtshme apo të paluajtshme.

**39.3.1.** Në mungesë të çfarëdolloji dokumenti, kontrate apo informacioni mbi blerësit e tokave të zëna nga informaliteti, mbetej e paqartë: (i) sa janë në total të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre pasurive; si dhe (ii) cila është koha e shitjes dhe e përfitimit të shumave të caktuara. Në këto kushte, në përfundim të hetimit administrativ, shumat e përfituara nga prindërit e subjektit kur ata jetonin dhe të trashëguara tek ai pas humbjes së nënës (në vitin 2012) dhe babait (në vitin 2016), nuk janë përfshirë si të ardhura në analizën financiare të subjektit.

<sup>32</sup>Shihni vërtetim pronësie në dokumentet e paraqitura me pyetësorin 2 shtesë.

<sup>33</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2022, bashkëngjitur përgjigjeve të subjektit të datës 13.6.2022.

<sup>34</sup>Shihni ligjin nr. 8438/28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar (ligji në fuqi).

<sup>35</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr.\*\*\* prot., datë 7.3.2022, nga Ministria e Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

**39.3.2.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vijojë të paraqesë akte që vërtetojnë të ardhura nga shitja e tokave të zëna nga informaliteti. Në parashtrimet e tij nuk rezultoi që subjekti të ketë dhënë sqarime të mëtejshme, çka nuk e ndryshoi këtë rezultat.

#### **39.4. Në lidhje me të ardhurat nga kompensimi i pronave, subjekti ka paraqitur:**

a) Vendimin nr. \*\*\*, datë 15.8.2011, të AKKP-së sipas të cilit trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar M. K. (5 trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, ndër të cilët edhe nëna e subjektit) dhe H. K. (6 trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë) do të kompensohen me vlerën 8.800.000 lekë. Në këtë vendim referohen dokumentet: (i) dëshmi trashëgimie nr. \*\*\*, datë 26.6.1992, për përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të shtetasve A. K., M. K. dhe P. K.; (ii) dëshmi trashëgimie nr. \*\*\*, datë 3.12.1992, për përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit F. dhe H. K., si dhe D. Z., dokumente këto të referuara në vendimin e AKKP-së.

**39.4.1.** Me qëllim përcaktimin e saktë të pjesëve përfituese të trashëgimtarëve ligjorë, konkretisht, nënës së subjektit, gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkua të paraqesë këto dy dëshmi trashëgimie. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka informuar se i është drejtuar me kërkesë ATP-së dhe është në pritje të përgjigjeve.

**39.4.2.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu rikërkua të paraqesë këto dy akte. Në parashtrimet e tij, duke informuar se në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.8.2011, të AKKP-së, ku referohet dëshmia e trashëgimisë nr. \*\*\*, është bërë një lapsus në muajin e saj, nga XI është shënuar VI, ka vënë në dispozicion të Komisionit dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.XI.1992 për përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të shtetasve A. K., M.K. dhe P. K. Në lidhje me dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 3.12.1992, për përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit F. dhe H. K., si dhe D. Z., subjekti ka informuar se ky dokument nuk i përket trashëgimtarëve të gjyshit të tij M. K., por i përket trashëgimtarëve të vëllait të tij, H. K. dhe, për këtë arsye, ai nuk e disponon.

**39.4.3.** Sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.11.1992, të paraqitur nga subjekti, sikurse referuar në të njëjtën mënyrë edhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2009, të AKKP-së Durrës<sup>36</sup>, “Për njohje të drejte të pronësisë, kthim ose kompensim”, trashëgimtarë të trashëgimlënësit M. K. janë: M. M. K. (P.) dhe A. M. K. që marrin secili nga 3/9 pjesë të pasurisë së M. K., kurse Sh. K., E. K., S. K. marrin secili nga 1/9 pjesë të pasurisë së trashëgimlënësit. Pra siç vërehet, trashëgimtarja M. K. (P.) ka përfituar 1/3 pjesë të pasurisë së babait të saj M. K., i cili zotëron 1/2 e shumës 8.800.000 lekë. Sipas kësaj përllogaritjeje nga shuma 4.400.000 lekë<sup>37</sup> (4.400.000 lekë iu takon trashëgimtarëve të shtetasit H. K.), rezultoi që nëna e subjektit të ketë përfituar 1/3 e 4.400.000 lekëve ose 1.466.666 lekëve.

**39.4.4.** Sa i takon mënyrës së kalimit të shumës së trashëguar, rezultoi se:

së pari, në lidhje me tagrat ligjorë të përfaqësimit të trashëgimtarëve ligjorë: në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.8.2011, të AKKP-së referohet se shtetasi A. Z. është përfaqësues me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 14.4.2011, prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 18.4.2011, prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 22.2.2001, të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar M. dhe H. K.; në vendimin nr. \*\*\*, datë 20.4.2015, të AKKP-së referohet se z. S. K. është përfaqësues i trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar M. K.;

së dyti, në lidhje me mënyrën e kalimit të shumës nga ekstrakti i llogarisë së shtetasit A. R. Z. (përfaqësues me prokurë<sup>38</sup> i trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar M. dhe H. K.) në “Intesa Sanpaolo Bank”, ka rezultuar se: në datën 26.8.2011 është transferuar në këtë llogari shuma 8.798.500 lekë, sipas vendimit të gjykatës; sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*,

<sup>36</sup>Shihni dokumentin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3.

<sup>37</sup>1/2 e shumës prej 8.800.000 lekësh.

<sup>38</sup>Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 15.8.2011, të AKKP-së.

datë 1.11.2021, shtetasi A. Z. ka deklaruar se e ka tërhequr këtë shumë duke e vënë në dispozicion për shpërndarje z. S. K.; sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 2.11.2021, shtetasi S. K. ka deklaruar se *i ka dhënë cash M. P. (hallës së tij) shumën 2.933.333 lekë.*

**39.4.5.** Në kushtet kur mbetej e paprovuar tërheqja e shumës rreth 8.800.000 lekë nga llogaria bankare e shtetasit A. Z., subjektit iu kërkua të vinte në dispozicion të Komisionit këtë veprim bankar, i cili paraqiti ekstraktin e llogarisë së z. A. Z., në të cilin<sup>39</sup> evidentohet se në datën 14.9.2011 ky shtetas ka tërhequr *cash* shumën 8.798.500 lekë, me përshkrimin “tërheqje e kthimit të kompensimit të pronave”.

**39.4.6.** I pyetur më tej gjatë hetimit administrativ se çfarë përfaqësonte shuma prej 2.900.000 lekësh, dhënë nënës së tij dhe koha kur i është dhënë kjo shumë, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti deklaroi se kjo shumë përfaqëson 2/3 e gjysmës së shumës së dhënë nga Komisioni i Kompensimit të Pronave, e cila është pjesa takuese e nënës së tij M. P. dhe vëllait të saj P.K., trashëgimtarët e të cilëve nuk kanë përfituar nga ky kompensim financiar. Sa i takon kohën kur kjo shumë i është dhënë nënës së subjektit, ky i fundit ka deklaruar se veprimi është kryer *cash* dhe pas datës 14.9.2011 (pra pas tërheqjes nga banka prej z. A. Z.).

**39.4.7.** Në përfundim të hetimit administrativ, pretendimet e subjektit për përfitimin nga ana e nënës së tij në masën 2/3 dhe jo 1/3, mbeten në nivel deklarativ. Për më tepër që nuk disponohet asnjë dokument ku trashëgimtarët e vëllait të saj P. P. të kenë shprehur vullnetin për dhurimin e pjesës së tyre takuese. Në këto kushte, në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij, për vitin 2011 (para fillimit të detyrës), është përfshirë vetëm shuma 1.466.417 lekë, e cila është pjesa takuese e nënës së subjektit, sipas dëshmisë së trashëgimisë.

**39.4.8.** Në parashtrimet e tij, pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti i kërkoi Komisionit përfshirjen në analizën financiare për vitin 2011 të shumës me vlerë 1.466.417 lekë, e cila plotëson shumën totale prej 2.932.834 lekësh, që nëna e tij ka marrë realisht, pasi ai vazhdon të pretendojë se nënës së tij M. K., përveç pjesës së saj prej 1.466.417 lekësh, i ka kaluar edhe pjesa e P. K. në vlerën 1.466.417 lekë. Kjo, sipas tij, ka ndodhur për arsye se gjatë ndarjes së pasurive në bashkëpronësi dhe, konkretisht, në pasuritë apartamente të ndodhura në godinat nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*” dhe godinat nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* në rrugën “\*\*\*\*” (\*\*\*), trashëgimtarët e P. K. kanë pasur sipërfaqe më shumë se pjesa takuese, ku në pamundësi të ndryshimit të strukturave murale të këtyre ambienteve, është rregulluar duke mos marrë pjesën takuese në këtë kompensim.

Po kështu, një tjetër fakt që mbështet këtë pretendim, sipas subjektit është edhe deklarata *Vetting*, ku në rubrikën e përshkrimit të të ardhurave janë cituar si të ardhura nga kompensimi i pronave për trashëgimlënësen M. P. rreth 400.000 lekë, të cilat janë të marra deri më 30.1.2017, që janë 2.932.834 lekë (1.466.417 lekë pjesa takuese e M. P. + 1.466.417 lekë pjesa që u takonte trashëgimtarëve të P. K.). Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka paraqitur: (i) deklaratën noteriale të datës 22.7.2022 të trashëgimtarëve aktualë të P. K., që janë E. H. (K.) dhe S. K., pasi Sh. K. ka ndërruar jetë në vitin 2019, në të cilën ata konfirmojnë deklaratimet e subjektit; (ii) vendimin e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 8.4.2019, sipas të cilit trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënëses Sh. K. janë shtetasit E.H. (K.) dhe S. K.

**39.4.9.** Në procesin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje, Komisioni vlerësoi se pretendimet e subjektit për kalimin e pjesës takuese të P. K. në shumën 1.466.417 lekë nënës së tij M. P. nuk provohen me dokumente, ndërkohë që bazuar edhe në qëndrimin e Kolegjit, deklarata noteriale e kryer pas rezultateve të hetimit administrativ ka vlerë të kufizuar për sa i përket provueshmërisë së faktit që kërkon të provojë subjekti<sup>40</sup>. Kështu që pretendimi i

<sup>39</sup>Shihni faqe 1, të dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 4, në dosjen e Komisionit.

<sup>40</sup>Shihni vendimin nr. 31, datë 12.10.2021, të Kolegjit, paragrafi 29.5: “Në vlerësim të kësaj situate, Kolegji, në mungesë të deklaratimeve të kësaj marrëdhënieje në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas detyrimit të udhëzimit

subjektit mbetet në nivel deklarativ dhe nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë të kohës, si marrëveshje apo çdolloj akti mes palëve, që të dëshmojë shkëmbimin e pasurive të pretenduara kundrejt pjesës takuese të kompensimit. E po kështu, mbetet deklarativ dhe i pabazuar në ndonjë provë pretendimi që arsyeya e kalimit të kësaj shume nënës së subjektit ka qenë marrja e sipërfaqeve më të mëdha nga ndarja e pasurive në bashkëpronësi prej trashëgimtarëve të P. K.

b) Vendimin nr. \*\*\*, datë 30.4.2015, i AKKP-së, sipas të cilit trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar M. K. do të kompensohen me vlerën 3.579.600 lekë, ndër të cilët edhe nëna e subjektit, M. K., si një nga trashëgimtarët e radhës së parë.

**39.4.10.** Në dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.11.1992, të referuar në vendimin nr.\*\*\*, datë 23.6.2009, të AKKP-së Durrës, trashëgimtarë të trashëgimlënësit M. K. janë M. M. K. (P.) dhe A. M. K. që marrin secili nga 3/9 pjesë të pasurisë së M. K., kurse Sh. K., E. K., S. K. marrin secili nga 1/9 pjesë të pasurisë së trashëgimlënësit. Siç vërehet, trashëgimtarja M. M. K. (P.) ka përfitur nga 1/3 pjesë të pasurisë së M. K., pra 1/3 e shumës prej 3.579.600 lekësh, që sipas një përlllogaritjeje aritmetike, ajo ka përfitur rreth 1.200.000 lekë, përafërsisht aq sa deklarohet se i është dhënë nga shtetasi S. K., si më poshtë.

**39.4.11.** Sa i takon mënyrës së kalimit të shumës së trashëguar, u evidentua se nga ekstrakti i llogarisë së S. P. K. në “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se në datën 11.5.2015 është transferuar shuma 3.578.100 lekë me përshkrimin “kompensim financiar”, sipas vendimit të mësipërm të gjykatës. Nga ky ekstrakt rezulton se në datën 14.5.2015 shuma prej 1.200.000 lekësh është transferuar në llogarinë e A. P. në të njëjtën bankë me përshkrimin “kalim i pjesës dhënë nga AKP”. Ky veprim është deklaruar nga shtetasi S. K. edhe në deklaratën noteriale të tij nr. \*\*\*, datë 2.11.2021. Shuma 1.200.000 lekë është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të subjektit për vitin 2015<sup>41</sup>.

**39.5. Në lidhje me shumat e marra nga dëmshtëpërblimi si i përndjekur politik i familjarëve të tij,** subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2021, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas së cilës i përndjekuri politik A. P., gjyshi i subjektit, ka përfitur shumën 140.937,50 lekë në vitin 2020 dhe babai i tij A. P., shumën 410.000 lekë, në 2 këste, përkatësisht në vitet 2010 dhe 2013.

**40.** Shuma prej 205.000 lekësh<sup>42</sup> është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij, përkatësisht për secilin nga vitet 2010 dhe 2013.

#### **Analizë e burimit: të ardhura nga dhënie me qira ambientesh**

**41.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar:

**41.1. Të ardhura që ai vetë ka përfitur nga qiradhënia e pasurive të tij, si vijon:**

- qira dyqani me nr. pasurie \*\*\* (T. e R.) për periudhën 1.7.2014 – janar 2017, (Arian Përmeti dhe \*\*\* sipas kontratës së qirasë nr. \*\*\*, datë 1.7.2014) në vlerën 10.660 euro;

---

nr. {\*\*\*}, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së dhe në deklaratën periodike të vitit 2009, dhe as në ndonjë dokument ligjor të kohës kur ajo ka lindur apo afër saj, sheh të arsyeshme të risjellë në vëmendje se në vijim të jurisprudencës së Kolegjit, në vendime të marra edhe përpara vendimit objekt ankimi të Komisionit 89, deklarata noteriale e kryer gjatë rivlerësimit pas rezultateve të hetimit administrativ ka vlerë të kufizuar për sa i përket provueshmërisë së faktit që kërkon të provojë, duke qenë se është konsideruar si një përpjekje e subjektit, e diktuar nga nevoja për të justifikuar me burime të ligjshme një situatë negative financiare, të konstatuar nga hetimi. Deklaratat noteriale të përpiluara për këtë qëllim konsiderohen si me një vlerë provuese të ulët, sa kohë që ato nuk mbështeten nga të dhëna të tjera që rezultojnë nga dokumentacioni ligjor i krijuar në mënyrë autonome e jashtë ndikimit të procesit të rivlerësimit”.

<sup>41</sup>I pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetjes nr. 2 të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se ka jetuar gjatë gjithë kohës me prindërit e tij.

<sup>42</sup>Meqenëse nuk është deklaruar shuma ekzakte e paguar në vitin 2010 dhe në vitin 2013, totali është ndarë në mënyrë të barabartë midis viteve 2010 dhe 2013.



- qira dyqani për vitin 2016, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, kontrata nr. \*\*\* rep., datë 24.8.2015, në emër të trashëgimlënësit A. P.-\*\*\* (kontratë vazhduese e lidhur me subjektin në vitin 1995) në vlerën 360.000 lekë;
- qira dyqani për vitin 2016, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., kontratë nr. \*\*\*, datë 14.3.2012, në vlerën 408.000 lekë;
- qira dyqani për vitin 2016, pasuria nr. \*\*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, lidhur në emër të shtetasit Arian Përmeti kontratë nr. \*\*\*, datë 18.6.2016, në vlerën 190.400 lekë;
- qira apartamenti për vitin 2016 me nr. pasurie \*\*\* (T. e R.) kontrata në emër të trashëgimlënësit A. P.-F. R. nr. \*\*\*, datë 20.10.2015 (kontratë vazhduese) në vlerën 3.000 euro.

**41.2. Të ardhura të trashëguara nga prindërit e tij në vlerën 25.000.000 lekë, sipas kontratave dhe shumave të përfituara prej prindërve të tij, si vijon:**

- qira dyqani pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, me qiramarrës \*\*\*, dhënë me qira në vazhdimësi nga viti 1995. Shuma totale nga ky objekt deri në vitin 2015 është rreth 7.200.000 lekë;
- qira dyqani pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, dhënë me qira në vazhdimësi nga viti 1993 subjekteve të ndryshëm. Shuma totale nga ky objekt deri në vitin 2015 është rreth 8.000.000 lekë;
- qira dyqani pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, dhënë me qira në vazhdimësi nga viti. Shuma totale e mbledhur nga qiraja për këtë objekt deri në vitin 2015 është rreth 3.000.000 lekë;
- qira dyqani pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës, dhënë me qira në vazhdimësi nga viti. Shuma totale e mbledhur nga qiraja për këtë objekt deri në vitin 2015 është rreth 3.000.000 lekë;
- dy dyqane në Durrës dhe një në Tiranë, dhënë me qira në vazhdimësi nga viti 1995 nga M.P. Shuma totale në vite, për pjesën e M. P. është rreth 50.000 euro.

### **Detyrimi për pagesën e tatimit në burim mbi të ardhurat nga qiraja**

**42.** I pyetur nga Komisioni, subjekti ka sqaruar<sup>43</sup> se, meqenëse një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave të tij vijnë nga qiratë e përfituara, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë për sqarimin e disa situatave në lidhje me pagesat e tatimit në burim mbi qiratë. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, kjo drejtori i është përgjigjur tre pyetjeve të subjektit, lidhur me pagesën e tatimit mbi qiratë, si në vijim:

**42.1.** Në lidhje me detyrimin për të paguar tatimin mbi qiranë kur qiramarrësi është person fizik ose juridik, DPT-ja Tiranë është përgjigjur se: (i) për vitet 1994 – 1998 në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale” përcaktohet se *çdo individ/ndërmarrje që përfiton shërbime ... edhe nga marrëveshje për shërbime individuale, mban tatimin për të ardhurat personale dhe e derdh atë në buxhetin e shtetit*; (ii) për periudhën 1998 e në vazhdim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar”, në rastin e qiramarrjes së një pasurie të paluajtshme nga një tatimpagues që ushtron veprimtari ekonomike dhe qiradhënës individ, detyrimi për llogaritjen, mbajtjen dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale nga qiradhënia është e tatimpaguesit që ushtron veprimtari ekonomike.

- Në lidhje me pyetjen e subjektit se çfarë ndodh me detyrimet tatimore (përfshirë edhe tatimin mbi qiranë) në rast se një subjekt tregtar që ka marrë një ambient me qira e mbyll aktivitetin në QKR, DPT-ja Tiranë është përgjigjur se bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcaktohet se QKR-ja nuk mund të kryejë çregjistrimin e subjektit në rast se rezultojnë detyrime tatimore të papaguara, deklarata tatimore të padorëzuara dhe në rast se nuk janë paraqitur pasqyrat financiare deri në momentin e mbylljes së aktivitetit.

<sup>43</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 8 të pyetësorit nr. 3.

- Në lidhje me pyetjen e subjektit se kur qiraja paguhet në bankë, a është paguar tatimi mbi qiranë nga ana e personit fizik ose juridik, DPT-ja Tiranë është përgjigjur se *të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike janë të detyruar të mbajnë në burim tatimin për pagesën e kryer të qirasë*, por nuk i është përgjigjur në mënyrë direkte pyetjes së subjektit.

**42.2.** Sipas subjektit, në të njëjtën linjë me përgjigjen e mësipërme, në lidhje me legjitimitetin e të ardhurave nga qiratë dhe me përgjegjësinë për pagesën e tatimit të të ardhurave nga qiratë, si dhe me përgjegjësinë për pagesën e tatimit në burim mbi to, Kolegji, në vendimin nr. 14, datë 15.6.2021, ka mbajtur qëndrimin si vijon: *“Kur qiramarrësi ushtron veprimtari ekonomike dhe qiradhënësi është individ, detyrimi për llogaritjen dhe mbajtjen dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale nga qiradhënia është e tatimpaguesit që ushtron veprimtari ekonomike, edhe sikur në kontratë të jetë parashikuar ndryshe – të ardhurat nga qiratë konsiderohen të ligjshme në rast se në kontratë është përcaktuar vlera e qirasë dhe ajo e tatimit dhe kur është provuar që qiradhënësi ka përfituar vlerën neto të qirasë”<sup>44</sup>.*

**42.3.** Në përgjigjet e datës 13.6.2022<sup>45</sup>, subjekti ka bashkëlidhur shkresën kthim përgjigje nr.\*\*\* prot., datë 1.3.2022, të DPT-së<sup>46</sup>, e cila jep të njëjtën përgjigje, por më të zgjeruar se shkresa e sipërcituar, mbi detyrimin e pagimit të tatimit.

**42.4.** Referuar përmbajtjes së të dyja shkresave të DPT-së, si dhe kuptimit dhe interpretimit të ligjit mbi tatimin lidhur me të ardhurat, në rastet kur është vërtetuar se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar në mënyrë kumulative kushtet: (i) ka lidhur kontratë me subjekte tregtare; (ii) ka provuar qartësisht se ai ka marrë vlerën *neto* të qirasë, të ardhurat e përfituara nga qiraja, prej tij dhe prindërve të tij, janë konsideruar të ligjshme duke u marrë në konsideratë në analizën financiare.

### **Të ardhurat e përfituara nga qiratë**

**43.** Nga verifikimi i të gjitha deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, deklaratimet periodike, sqarimet pranë ILDKPKI-së, përgjigjet e pyetësorit standard, pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, si dhe shtesat e secilit prej pyetësorëve, subjekti ka pretenduar të ardhura nga qiratë të përfituara nga prindërit e tij dhe pas vdekjes së tyre<sup>47</sup>, si dhe nga ai vetë, duke vënë në dispozicion 27 kontrata qirash.

**44.** Për shkak të numrit relativisht të lartë të kontratave me qëllim evidentimin e saktë të çdo të ardhure të përfituar, me pyetësorin nr. 4, subjektit iu dërguan në formën e një tablele të gjitha kontratat e vëna në dispozicion prej tij dhe të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ<sup>48</sup>, duke i kërkuar konkretisht që për çdo kontratë të krijojë një set dokumentesh që të përmbajë së bashku me kontratën edhe çdo amendim të saj edhe certifikatën e pronësisë së objektit të përshkruar në kontratën e qirasë, lëvizje të llogarisë/ve bankare, ku të evidentohet pagesa e qirasë, si dhe dokumente shkresorë që vërtetojnë pagesën e tatimit në burim për qiratë e përfituara.

**45.** Pas administrimit të dokumentacionit të mësipërm, Komisioni ka analizuar të ardhurat që vijnë nga: (i) qiratë e provuara me kontratat përkatëse; (ii) qiratë e evidentuara gjatë verifikimit të llogarive bankare të subjektit, babait të tij, dhe çdo bashkëpronari tjetër i cili ka menaxhuar marrëdhënien me qiramarrësit; (iii) qiratë e pretenduara në bazë të çdo dokumenti tjetër të paraqitur nga subjekti.

<sup>44</sup>Shihni paragrafin 71 të këtij vendimi të Kolegjit.

<sup>45</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes 6, të pyetësorit nr. 5, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*, datë 13.6.2022.

<sup>46</sup>Shkresa ndodhet në f. 48-51 të dokumenteve bashkëlidhur me përgjigjet e subjektit të datës 13.6.2022.

<sup>47</sup>Nëna në shkurt të vitit 2012, ndërsa babai në janar të vitit 2016.

<sup>48</sup>Shihni dosjen e ILDKPKI-së, dokumentet e vëna në dispozicion prej subjektit në pyetësorin standard dhe 4 pyetësorët + 4 pyetësorët shtesë për secilin nga pyetësorët 2, 3 dhe 4, të dërguara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

46. Kontratat janë analizuar e renditur duke u grupuar sipas objektit të tyre, pra sipas pasurive, si vijon:

**Për pasurinë “\*\*\*”, truall me sipërfaqe totale 1.569 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë me sip. 424 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, janë lidhur kontratat si vijojnë:**

**46.1. Kontratë qiraje për objektin “\*\*\*”,** midis I. M. K. dhe përfaqësuesve të qiradhënësve A. Z., Arian Përmeti dhe I. K. Çmimi i qirasë është caktuar me VKM-në nr. \*\*\*, datë 7.2.1994 dhe sipas procesverbalit datë 1.2.1995 të Komisionit, qiraja mujore është 92.000 lekë. Kjo kontratë fillon në datën 1.1.1996 dhe vazhdon deri në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që do të dalin për dorëzimin e ndërtesave që shërbejnë për nevoja publike. Kontratë qiraje me të njëjtat palë, nga data 1.1.1998 për një afat 1-vjeçar, ku përcaktohet se shtetasit Arian Përmeti i takon pjesa prej 23.000 lekësh/muaj.

**46.1.1.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 shtesë<sup>49</sup>, subjekti ka paraqitur shkresën akt dorëzimi, nr. \*\*\*, datë 20.7.2000, të I. M. K., ku ky i fundit, në datën 20.7.2000, i dorëzon pronarëve të ligjshëm, familjeve K. dhe K., ndërtesën dhe territorin. Kjo vërteton se deri në këtë datë ky institut ka paguar qiranë në vijimësi, duke nisur nga shkurti i vitit 1994 kur janë njohur ish-pronarët e kësaj pasurie.

**46.1.2.** Subjekti ka paraqitur edhe disa mandatpagesa që i takojnë periudhave shkurt 1995, dhjetor 1997 dhe prill 1998, ku tregohen pagesa të kryera te subjekti nga Th. Sh. për llogari të I. M. K., si dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, nga DRT-ja Tiranë, e cila informon se ky institut është regjistruar në sistemin tatimor në vitin 2005 dhe, për rrjedhojë, nuk disponohen pagesa për tatimin në burim të kryera prej këtij instituti.

**46.1.3.** I pyetur përse ai ka përfituar shumën 23.000 lekë/muaj ose 1/3 e qirasë, ndërkohë që objekti i lëshuar me qira ka 14 bashkëpronarë, midis të cilëve edhe nëna e tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se nënës së tij i takon 1/3 pjesë nga ¼ që i takonte babait të saj, duke paraqitur edhe vërtetimin nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 2.11.2000, sipas të cilit nëna e tij zotëron 12/144 pjesë ose 1/12 pjesë.

**46.1.4.** Për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë, në pyetësin nr. 4, subjekti ka paraqitur: kërkesë drejtuar Drejtorisë së M. K., ku subjekti ka kërkuar informacion mbi pagesën e tatimit në burim për periudhën 1.1.1994 – 20.7.2000; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2021, nga Drejtoria e M. K., e cila informon se ky institucion nuk ka dokumenti për pagesën e tatimit mbi qiranë, por institucioni nuk rezulton të ketë detyrime të prapambetura ndaj organeve tatimore, përfshirë këtu edhe detyrimet tatim mbi qiranë.

**46.1.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e të gjitha dokumenteve dhe shpjegimeve të subjektit, duke mbajtur në konsideratë që: (i) I. M. K. ka qenë në të njëjtën ndërtesë edhe para viteve 1990; (ii) ka pasur status buxhetor, të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.2.1994<sup>50</sup> deri në datën 20.7.2000 janë konsideruar si të ardhura të ligjshme. Nga këto të ardhura, pjesa e nënës së subjektit është 1/12 e shumës 92.000 lekë/muaj ose 7.667 lekë/muaj. Nga marrëdhënia me I. M. K. për periudhën 1.2.1994 – 20.7.2000, nëna e subjektit ka përfituar shumën 595.444 lekë, e cila është përfshirë në analizën financiare të prindërve të subjektit, si e ardhur e ligjshme.

**46.2. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 14.10.2003<sup>51</sup>,** lidhur mes 14 pronarëve qiradhënës, midis të cilëve nëna e subjektit M. P. dhe me qiramarrës I. R. (R., e përfaqësuar nga bashkëshorti i saj L. R., me objekt qiraje pronë e ndodhur në rrugën “\*\*\*”, nr. \*\*\*, ish-rruga “\*\*\*”, e përbërë nga një shtëpi dykatëshe, me sip. ndërtimore 450 m<sup>2</sup> dhe sip. oborri 1600 m<sup>2</sup>. Çmimi i qirasë

<sup>49</sup>Shihni pyetësin 3 shtesë, f. 21-30, në dosjen e Komisionit.

<sup>50</sup>Shihni pyetësin nr. 3 shtesë, f. 21, në të cilin ndodhet shkresa akt dorëzimi nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2000, sipas së cilës prona është njohur dhe kthyer pronarëve me vendimin datë 28.1.1994.

<sup>51</sup>Shihni pyetësin 3 shtesë, f. 31, në dosjen e Komisionit.

është caktuar 4.500 euro/muaj dhe afati i kontratës është nga data 15.10.2003 deri më 15.10.2008. Nuk parashikohet pagesa e tatimit në burim.

**46.2.1.** Subjekti ka bashkëlidhur kësaj kontrate shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2021, nga DRT-ja Berat, sipas së cilës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka paguar tatim mbi qiranë në emër të qiradhënësit A. Z., duke vendosur bashkëlidhur pagesat e mëposhtme.

Vitet	Tatimi i paguar <sup>52</sup>	Qiraja e përftuar (lekë)	Qiraja neto e përlllogaritur
2 004	87 110	871 100	783 990
2 005	148 461	1 484 610	1 336 149
2 006	122 205	1 222 050	1 099 845
2 007	135 504	1 355 040	1 219 536
2 008	97 307	973 070	875 763
<b>Total</b>	<b>590 587</b>	<b>5 905 870</b>	<b>5 315 283</b>

**46.2.2.** Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion një ekstrakt me lëvizjet e llogarisë bankare për shtetasin A. Z., tek “Intesa Sanpaolo Bank”, në të cilin evidentohen: (i) depozitime mujore të shumës 900 euro nga shtetasi D. L. (administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.) me përshkrimin pagesë qiraje ose qira, për periudhën tetori 2007 - shtator 2008 dhe konkretisht për vitin 2007 janë paguar  $900 \times 3 = 2.700$  euro dhe për vitin 2008 janë paguar  $900 \times 9 = 8.100$  euro; (ii) tërheqja e shumave të depozituara prej tij.

**46.2.3.** Nga të dyja dokumentet e mësipërme është provuar që pronarët kanë përfituar nga qiraja shumë 900 euro/muaj, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore. Nga kjo shumë, nëna e subjektit ka përfituar 375 euro/muaj, ose 1/12 pjesë të shumës totale prej 4.500 euro, sikurse vërtetohet nga dokumenti hipotekor i vitit 2000 për këtë pasuri dhe sikurse është deklaruar edhe nga shtetasi z. A. Z.<sup>53</sup>.

**46.2.4.** Duke qenë se nga dokumentet e paraqitura nga subjekti, si palë qiramarrëse prezantohet znj. I. R. (R.), ndërsa në dokumentet që tregojnë pagesën e tatimit mbi qiranë, si e tillë prezantohet shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi lidhjen midis znj. I. R. (R.) dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti sqaroi se ai nuk ka informacion mbi marrëdhënien që kanë pasur subjektet e mësipërme dhe se qiradhënësit kanë mbajtur marrëdhënie me qiramarrësin “\*\*\*\*” sh.p.k., duke sjellë në vëmendje disa dokumente, të cilat i ka paraqitur më parë<sup>54</sup> si: (i) I. R. ka pasur prokurë nga L.R.; (ii) nga një faturë e OSHE-së në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe leja për ushtrim aktiviteti profesional të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nr. \*\*\* datë 20.2.2007; (iii) kërkesë e datës 29.8.2008 ndaj administratorit D. L.<sup>55</sup>, sipas së cilës pronarët nga familjet K. dhe K. kërkojnë mbarimin e afatit të kontratës në datën 15.10.2008; (iv) rezulton se kjo shoqëri ka ushtruar aktivitetin në pronën \*\*\*. Subjekti ka paraqitur si dokument të ri një listëpagesë të vitit 2004, në të cilën listohen punonjësit e kësaj shoqërie, të cilët mbajnë mbiemrat L. dhe R., çka, sipas subjektit, tregon se ata kanë qenë bashkë në këtë sipërmarrje.

**46.2.5.** Subjekti ka deklaruar se fillimi i pagesës nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka filluar në qershor të vitit 2004, bazuar në kushtet e kontratës së qirasë datë 14.10.2003. Nga leximi i kontratës evidentohet se në nenin “Mënyra e pagesës” është parashikuar se nga pala qiramarrëse do të kryhen investime në shumë 36.000 euro, të cilat do të mbahen nga: (i)

<sup>52</sup>Sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 përcaktohet se: “Tatimi mbi të ardhurat personale për gjithë llojet e të ardhurave personale është 10%”.

<sup>53</sup>Shihni deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.11.2021, në dokumentet e sjella në përgjigje të pyetësorit nr. 3 shtesë, me nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022, f. 36, ku z. Z. deklaroi se ai merrte nga qiraja 900 euro/muaj për pjesën e bashkëpronarëve që ai përfaqëson dhe i jepte M. P. shumë 375 euro/muaj.

<sup>54</sup>Shihni dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 3-shtesë, f. 39-42, dorëzuar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022.

<sup>55</sup>Shihni ekstraktin e regjistrimit tregtar të subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k. në QKB.

shuma e qirasë për 3 muajt, 15.10.2003 – 15.1.2004 ose 13.500 euro; (ii) diferenca prej 22.500 euro do të mbahet nga qiramarrësi, nga 2.000 euro/muaj nga qiraja mujore prej 4.500 euro, duke filluar nga data 15.1.2004.

**46.2.6.** Nga analiza e të gjitha dokumenteve të administruara dhe shpjegimet e subjektit, qiratë e përfituara janë konsideruar në analizën financiare të subjektit, sipas viteve përkatëse, në ato shuma për të cilat është provuar pagesa e tatimit në burim<sup>56</sup>, duke aplikuar 1/12 pjesë takuese të nënës së subjektit, sikurse pasqyruar në tabelën vijuese.

Vitet	2004	2 005	2 006	2 007	2 008	Total
Qiraja <i>neto</i> (lekë)	65 333	111 346	91 654	101 628	72 980	<b>442 940</b>

**46.2.7.** Në parashtrimet e tij, pas njohjes me këtë rezultat hetimi, subjekti ka informuar se prona “\*\*\*\*” është blerë në vitet 1942 – 1943 nga familja K. dhe familja K. Sipas tij, në vitin 1990 trashëgimtarët e këtyre familjeve nuk kishin asnjë lidhje dhe nuk njiheshin me njëri-tjetrin, përveç kësaj prone, kështu që në momentin e dhënies së kësaj prone me qira, bashkëpronarët, të cilët ishin një numër i konsiderueshëm përzgjidhnin përfaqësuesit e tyre për marrjen e shumës së qirave takuese pranë subjektit qiramarrës. Gjatë kësaj periudhe, pra para 20 viteve, ai sqaron se nuk ka qenë pronar i drejtpërdrejtë te kjo pasuri, por ka qenë nëna e tij, e cila kishte autorizuar z. A. Z. për tërheqjen e shumës së saj (sipas deklaratave noteriale të këtij shtetasi të depozituara nga subjekti gjatë procesit), të cilën ia ka sjellë në dorë asaj nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

Sipas tij, përgjigjja e DRT-së Berat, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.11.21, është pas deklaratave të z. A. Z., që do të thotë se nuk është pasur dijeni që pagesat e tatimeve janë bërë në emër të tij, prandaj edhe kërkesa pranë DRT-së Berat është bërë për subjektin “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe individin A. Z.

Sa i takon bashkëpronarëve të tjerë, që kanë tërhequr qiratë pranë subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k. lidhur me këtë kontratë, subjekti deklaron se nuk ka dijeni kush kanë qenë dhe nëse i kanë paguar apo u janë paguar tatimet dhe ku u janë paguar. Ndërsa për pjesën takuese të nënës së tij janë paguar tatimet gjatë gjithë periudhës në vlerën takuese prej 232.124 lekësh, e cila mbulohet nga vera e tatimit e paguar për këtë qiramarrje prej 590.587 lekësh. Ai ka paraqitur në një tabelë tatimin e paguar sipas viteve për periudhën 2004 – 2008, qiranë e përfutur dhe qiranë *neto* të përlogaritur.

**46.2.8.** Në konkluzion të parashtrimeve të tij në lidhje me këtë kontratë, subjekti i ka kërkuar Komisionit që të konsiderohet si e ardhur e ligjshme pjesa e takuese e qirasë së nënës së tij, prej 1/12 ose 375 euro/muaj<sup>57</sup>, e përlogaritur për vitet kur është marrë qiraja, e cila bën një total *neto* prej 1.878.303 lekësh.

**46.2.9.** Nga analiza e dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti: (i) është bashkëpronar me 4/144 pjesë takuese në këtë pasuri si trashëgimtar i nënës së tij M. P. dhe është e provuar marrëdhënia e qirasë për objektin në bashkëpronësi “\*\*\*\*”; (ii) sipas vlerës totale të kontratës së qirasë prej 4.500 euro/muaj, shuma 900 euro/muaj i takon 2.5 personave, ndër të cilët mund të jetë edhe nëna e subjektit ashtu sikurse deklaron ai; (iii) kjo shumë është evidentuar të jetë derdhur në llogarinë bankare të shtetasis A. Z. për 11 muaj, shtator 2007 - tetor 2008; (iv) ka pagesa tatimesh të konfirmuara nga DRT-ja Berat prej shtetasis A. Z. për vitet 2004 – 2008, ndërkohë që çdo bashkëpronar ka të drejtë t’i paguajë veçmas tatimet për vlerat e përfutuara prej tij; (v) janë evidentuar tri prokura të posaçme<sup>58</sup> të viteve 2001 dhe

<sup>56</sup>Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2021, nga DRT-ja Berat, cituar më sipër.

<sup>57</sup>Subjekti është bazuar në vlerën e qirasë prej 4.500 euro/muaj, sipas kontratës me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.,  $4.500 \times 1/12 = 375$  euro/muaj.

<sup>58</sup>Në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.8.2011, të AKKP-së gjejmë të cituara disa prokura të dhëna shtetasi A. Z. për të përfaqësuar trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar M. dhe H. K. në Durrës dhe konkretisht: prokurë e

2011, të cilat tregojnë vullnetin e të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të shtetasve H. dhe M. K., midis të cilëve edhe nëna e subjektit.

**46.2.10.** Në konsideratë të sa më sipër, Komisioni ka kryer përlllogaritjet e mëposhtme duke përdorur metodën e analogjisë dhe duke marrë të mirëqenë që shtetasi A. Z.ka përfituar shumë 900 euro/muaj, nga të cilat 300 euro/muaj *neto*<sup>59</sup> është e shtetasës M. P. (K.). Bazuar te tatimet e paguara nga shtetasi A. Z. për nënën e subjektit, situata paraqitet si në vijim.

A. Z. (sipas tatimeve të paguara)					Nëna e subjektit	
Vitet	Qiraja e përftuar	Tatimi i paguar	Qiraja <i>neto</i>	Koha/muaj nga A. Z.	Përfituar qira <i>neto</i> (euro)	Përfituar qira <i>neto</i> (lekë)
2 004	6 873	687	6 186	7	1 500 <sup>60</sup>	190 110
2 005	12 115	1 212	10 904	12	3 600	441 144
2 006	9 879	988	8 891	10	3 000	371 109
2 007	11 207	1 121	10 086	11	3 300	399 003
2 008	7 899	790	7 109	8	2 400	295 638
<b>Total</b>	<b>47 974</b>	<b>4 797</b>	<b>43 176</b>	<b>48</b>	<b>13 800</b>	<b>1 697 004</b>

**46.3. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 30.3.2009**, e lidhur mes 14 qiradhënësve, ndër të cilët, nëna e subjektit M. K. dhe qiramarrës shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., nga data 15.10.2008 deri më 15.10.2018, vlera e qirasë 6.000 euro/muaj është *neto*, me objekt dhënie me qira truall, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*” Tiranë, me sip. 1569 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesa 424 m<sup>2</sup>. Pagesa e tatimit është parashikuar të kryhet nga qiramarrësi.

**46.3.1.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur disa dokumente në lidhje me qiratë e përfituara nga kjo kontratë dhe, konkretisht:

- ekstrakt historik të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., nga i cili rezulton se në datën 13.10.2008 është shtuar si adresë e ushtrimit të aktivitetit rruga “\*\*\*”, Tiranë, pra objekti “\*\*\*”. Kjo adresë është hequr në datën 1.4.2015;

- shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2021, nga DRT-ja Lezhë<sup>61</sup>, e cila nuk i ka kthyer përgjigje subjektit sa i takon kërkesës së tij për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat nga qiraja, bazuar në ligjin e konfidencialitetit, por ka sqaruar se detyrimet tatimore që paguhën nga subjektet tatimore bëhen në total dhe jo të detajuara sipas kontratave;

- lëvizjen e llogarisë bankare të shtetasit A. Z. në “Intesa Sanpaolo Bank”, në të cilën janë evidentuar transfertat bankare nga llogaria e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., duke filluar nga nëntori i vitit 2008 deri në qershor të vitit 2012. Vlera mujore e kredituar është 6.000 euro.

**46.3.2.** Vlera totale e kredituar në “Intesa Sanpaolo Bank”, e përfituar nga qiraja për periudhën nëntor 2008 – qershor 2012, është në total 231.000 euro, nga e cila 1/12 është pjesa takuese e nënës së subjektit, sikurse treguar në tabelën vijuese.

Vitet	15.10.2008	2009	2010	2011	Qershor 2012	Total
Qiraja e plotë <i>neto</i> (euro)	15 000	54 000	60 000	66 000	36 000	231 000
<b>Pjesa e nënës së subjektit (euro)</b>	<b>1 250</b>	<b>4 500</b>	<b>5 000</b>	<b>5 500</b>	<b>3 000</b>	<b>19 250</b>

posaçme nr. \*\*\*, datë 22.2.2001; prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 14.4.2011; prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 18.4.2011.

<sup>59</sup>Në kushtet kur subjekti nuk deklaroi sa persona përfaqëson A. Z., atëherë shuma 900 euro sipas kontratës përfaqëson 2.5 persona, gjë që realisht nuk mund të qëndrojë, atëherë logjikisht ai përfaqëson 3 persona (900:3=300 euro/muaj secili).

<sup>60</sup>Sipas kushteve të kontratës, të trajtuara në paragrafin më sipër, nënës së subjektit i takon të marrë nga janar-nëntor shumë 200 euro dhe në dhjetor 300 euro. Meqenëse tatimi është paguar për 7 muaj atëherë nëna e subjektit ka përfituar 200 euro *neto* për 6 muaj dhe 300 euro për muajin dhjetor.

<sup>61</sup>3-shtesë, f. 37, në dosjen e Komisionit.

**46.3.3.** Me shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, dërguar nga DRT-ja Lezhë, pas kërkesës së Komisionit për pagesën e tatimit në burim nga qiratë, informohet se *subjekti “\*\*\*” sh.p.k. me NIPT \*\*\**, nuk është i ngarkuar me përgjegjësi tatimore tatim në burim (për pagesë tatimi mbi qiranë).

**46.3.4.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) në kontratë janë parashikuar edhe vlera *neto* e qirasë edhe vlera e tatimit në burim për t;u paguar; si dhe (ii) është provuar nëpërmjet *statement*-it të “Intesa Sanpaolo Bank” që nëna e subjektit ka përfituar vlerën *neto* të qirasë, pagesa e tatimit në burim nuk është nën përgjegjësinë e qiradhënësve. Në konkluzion, të ardhurat nga qiraja, të përfituara nga kjo kontratë nga nëna e subjektit, për periudhën 15.10.2008 – qershor 2012, në total në vlerën 19.250 euro, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit. Ndërsa, sa i takon periudhës korrik 2012 – 1.4.2015, datë kur adresa “\*\*\*” është hequr si adresë e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., vlera e qirave nuk është përfshirë në analizën financiare, pasi nuk është provuar marrja e tyre me dokumentacion (*statement* bankar ose mandatpagesë).

**46.3.5.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente.

### **Qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i Komisionit**

**46.3.6.** Në parashtrimet tij, pas njohjes me këtë rezultat hetimi, sikurse gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se qiraja për këtë objekt, përgjithësisht, arkëtohej në llogaritë bankare të z. A. Z., por në rastet kur ai nuk ndodhej në Shqipëri, ai supozon (pasi nuk ka dijeni) se qiraja duhet të jetë arkëtuar apo dhënë personave të tjerë qiradhënës në llogaritë e tyre bankare apo fizikisht. Ndërkohë që ai disponon vetëm dy llogari bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, ku janë kryer derdhjet për këtë qiradhënie. Sipas tij, nuk ka mundësi reale që një subjekt të mbajë një objekt me qira të konsiderueshme (6.000 euro/muaj) në qendër të Tiranës, pa paguar qiranë për një periudhë disavjeçare. Më tej ai ka informuar se subjekti “\*\*\*” sh.p.k. ka regjistruar në QKR aktivitetin që zhvillonte në këtë pronë në datën 13.10.2008 dhe e ka mbyllur këtë aktivitet në këtë adresë në QKR në datën 1.4.2015. Sipas tij, përveç qirave të përfshira në analizën financiare për periudhën nëntor 2008 – qershor 2012, rezulton se ka edhe pagesa të tjera qiradhënie nëpërmjet bankës për këtë kontratë, ku në përshkrimin e bërë në pagesën e datës 28.3.2013 citohet “*likuidim qiraje për \*\*\**”. Ndërkohë që informon se pagesat për qiramarrjen për këtë kontratë janë kryer nga znj. V. T. A., e cila është motra e administratoreve dhe bashkëpronarëve të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

Ai, gjithashtu, sjell në vëmendje të Komisionit shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, nga DPT-ja Tiranë, në të cilën sqarohet se është qiramarrësi që kryen veprimtari ekonomike ai që paguan tatimin mbi qiranë. Një tjetër argument, sipas tij, është se në ligjin nr. 9220, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se QKB-ja nuk mund të kryejë çregjistrim të subjektit, në qoftë se në situatën e tatimpaguesit rezultojnë detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara. Pra në kuptim të këtij ligji, në rastin konkret, subjekti “\*\*\*” sh.p.k. ka paguar gjithë detyrimet tatimore.

Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur: (i) dy *statemente* bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” të z. A. Z., me nr. llogarie \*\*\* dhe \*\*\*, nga të cilat janë evidentuar depozitime të shumës 6.000 euro si vijon: (i) për vitin 2012 për 3 muaj; për vitin 2013 për 7 muaj; për vitin 2014 1 muaj; (ii) korrespondencën e tij me gjendjen civile, e cila në përgjigje me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.7.22, informon se certifikatat janë personale dhe mund të tërhiqen vetëm nga organet kompetente.

Në konkluzion të parashtrimeve të tij, në lidhje me këtë kontratë subjekti i kërkon Komisionit, që referuar legjislationit tatimor por edhe vendimeve nr. 14/2021 dhe nr. 15/2021 të Kolegjit,

të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e plota të përfituara nga kjo kontratë edhe për periudhën korrik 2012 – mars 2015, nga të cilat pjesa takuese e nënës së tij M. P. është në vlerën 500 euro/muaj ose në total për të gjithë periudhën 16.500 euro/2.306.460 lekë.

**46.3.7.** Në vlerësimin e tij, trupi gjykues i është referuar jurisprudencës së Kolegjit mbi pagesën e detyrimeve tatimore, si vijon: Në vendimin nr. 14/2021, Kolegji arsyeton se: “... pavarësisht se në dy kontratat e lidhura me subjektet ‘{\*\*\*}’ sh.p.k. dhe ‘{\*\*\*}’ sh.p.k., në përmbajtje të tyre përcaktohet rregulli i përgjithshëm që qiradhënësi i nënshtrohet detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurën e përfitur nga qiraja, e cila me të drejtë, referuar parashikimit të nenit 8 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale përbën një burim të tatueshëm të ardhurash, ky parashikim nuk mund të interpretohet se detyrimin për të kryer pagesën e tatimit në buxhetin e shtetit, në masën e përcaktuar nga ligji mbi vlerën bruto të qirasë e ka qiradhënësi, për sa kohë, referuar kuadrit të sipërcituar ligjor, ky përbën një detyrim ligjor të dy shoqërive qiramarrëse në rastin objekt gjykimi, të cilat ligji i ka përcaktuar si agentë të mbajtjes së tatimit në burim dhe u ka ngarkuar detyrimin ligjor për të llogaritur në mënyrë të saktë masën e detyrimit tatimor dhe mbajtjen e këtij detyrimi në burim, si dhe pagimin e tij në buxhetin e shtetit në afatin e përcaktuar me ligj”. Në vendimin nr. 15/2021, Kolegji arsyeton se: “Kolegji vlerëson se përcaktimi i nenit 4 të kontratës së shërbimit, sipas të cilit ofruesi i shërbimit përgjigjet për pagimin e taksave e detyrimeve, duhet lexuar sipas pretendimit të subjektit se këto pagesa zbriten/përballohen nga pagesa që fondacioni duhet të kryejë për llogari të personit të lidhur, por jo se detyrimisht është ajo drejtpërdrejt e detyruar të kryejë pagesat në organet tatimore për këtë qëllim. Sipas parashikimit të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, detyrimi për mbajtjen në burim të detyrimit tatimor në rastet e personave juridikë të cilët përfshihen në shërbime konsulente, i takon vetë personit juridik. Referuar këtij përcaktimi dhe informacionit që vjen nga shkresa e DRT-së Tiranë për pagimin prej fondacionit të tatimit për një vlerë pothuaj të njëjtë me atë që duhej të paguhej për pagën e bashkëshortes së subjektit për këtë vit, Kolegji arrin në konkluzionin se janë kryer pagesat e detyrimeve tatimore për këtë të ardhur, duke plotësuar në këtë mënyrë kriteret kushtetuese dhe ligjore për të ardhurën e ligjshme në vlerën 554.067 lekë”.

**46.3.8.** Nga analiza e sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura janë vërtetuar: (i) bashkëpronësia e subjektit në pasurinë objekt qiraje dhe marrëdhënia e qirasë; (ii) pagesa qiraje në llogarinë bankare të shtetasit A. Z. për disa muaj gjatë viteve 2012 – 2014; (iii) vlera e qirasë së paguar është ajo e përcaktuar në kontratë për objektin “\*\*\*\*” me përjashtim të vitit 2014; (iv) depozituesja është motra e qiramarrësit, gjë që provon se po paguhet qiraja e këtij objekti, pasi nga verifikimi në sistemin e gjendjes civile, shtetasit V. T. A., T. T. U. dhe A. T. U. kanë atësi dhe mëmësi të njëjtë, që dëshmon për faktin se janë motra e vëllezër me njëri-tjetrin; (v) nga QKR-ja ka rezultuar se deri më 1.4.2015 adresa e aktivitetit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. është objekti “\*\*\*\*”; (vi) detyrimi për pagesën e tatimit është i qiramarrësit si shoqëri tregtare. Për këto arsye, shuma në total prej 5.333 euro, e cila ka kaluar në bankë nga korriku i vitit 2012 deri në vitin 2014 (vetëm 1 muaj nga viti 2014) është përfshirë në analizën financiare të subjektit, sikurse treguar në tabelën vijuese.

Vitet	Nga korriku 2012	2013	2014	Total
Qiraja <i>neto</i> (euro)	18 000	42 000	4 000	<b>66 000</b>
Pjesa takuese e nënës së subjektit euro	1 500	3 500	333	<b>5 333</b>
Pjesa takuese e nënës së subjektit lekë	209 580	490 735	46 703	<b>747 018</b>

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*) , Tiranë, janë lidhur kontratat si vijojnë:**

**46.4. Kontratë qiraje e thjeshtë, pa akt noterial, datë 6.12.2005<sup>62</sup>** për ambient me sip. 106 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe

<sup>62</sup>Shihni dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 3-shtesë, f.140-143.



qiramarrësit z. K. P., administrator i BKT-së, me afat 10.12.2004 – 18.12.2006, vlera 650 euro/muaj. Pagesa e tatimit nuk specifikohet në kontratë.

**46.4.1.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë i takon pasurisë nr. \*\*\*, z.k. \*\*\* dhe adresa e deklaruar është rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*) , Tiranë. Pra, siç vërehet ka një mospërputhje në adresën e pasurisë sipas kontratës, me atë të deklaruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësin nr. 4.

**46.4.2.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi mospërputhjen e pronës/adresave të deklaruara në kontratë dhe në pyetësin nr. 4.

**46.4.3.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se për të gjitha pasuritë e ndodhura në pallatin me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, i ndërtuar rreth viteve 2000, adresa aktuale është rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\* (pallati “\*\*\*\*”). Prona mbi të cilën është ndërtuar pallati, në vitet ‘90, ndodhej në kryqëzimin e rrugës “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”. Kësaj të fundit i është ndryshuar emri dhe është quajtur “\*\*\*\*”. Në vitet ‘90, orientimi për pronën ka qenë rruga “\*\*\*\*”, por sipas tij ndërtimi i një godine para pronës së tyre në anën e rrugës “\*\*\*\*” ka ndryshuar emërtimin e pronës (aktualisht pallati “\*\*\*\*”), pasi nuk është më në kufi me rrugën “\*\*\*\*”, por është emërtuar fillimisht me adresën rruga “\*\*\*\*”, e më vonë ndryshuar emri i kësaj rruge në rrugën “\*\*\*\*”. Në konkluzion të parashtrimeve të tij, subjekti pretendon se bëhet fjalë për të njëjtin pallat, i cili në kontratat e bëra në vazhdimësi për pasuritë e ndodhura në pallatin “\*\*\*\*”, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Tiranë, herë është përdorur si adresë rruga “\*\*\*\*”, herë rruga “\*\*\*\*” dhe së fundi rruga “\*\*\*\*”.

**46.4.4.** Me qëllim vlerësimit e këtij pretendimi, nga verifikimi në *Google Maps*, konstatohet fakti se rruga “\*\*\*\*” kryqëzohet me rrugën “\*\*\*\*” dhe se pallati “\*\*\*\*” ndodhet në kryqëzimin e këtyre rrugëve. Në këto kushte vlerësohet se sqarimet e subjektit janë bindëse dhe se nuk ka dyshime apo *indicie* për verifikime të mëtejshme .

**46.4.5.** Bazuar në këtë kontratë (paraqitur më sipër në pikën 46.4), babai i subjektit ka përfituar për periudhën 10.12.2004 – 18.12.2006, në total shumën 15.600 euro, sikurse është përlllogaritur edhe nga subjekti në pyetësin nr. 4 dhe tatimi në burim që do të duhej të ishte paguar është 10% ose 1.560 euro.

Vitet	2004	2 005	2 006	<b>Total</b>
Qiraja <i>neto</i> (euro)	650	7 800	7 150	<b>15 600</b>

**46.4.6.** Në lidhje me pagesën e tatimit në burim subjekti ka cituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2022<sup>63</sup>, nga DPT-ja, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, sipas së cilës kjo drejtori nuk jep informacion për BKT-në, për shkak të konfidencialitetit të të dhënave. Nisur nga ky informacion mbetet e paqartë përse pagesat e qirasë të një institucioni bankar nuk janë kryer në llogari të babait të subjektit në BKT ose në çdo bankë tjetër.

**46.4.7.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur subjekti: (i) nuk ka provuar pagesë të tatimit në burim nga qiraja; (ii) në kontratë nuk është parashikuar vlera *neto* e qirasë dhe vlera e tatimit në burim për t’u paguar; si dhe (iii) nuk është e qartë nëse babai i subjektit ka përfituar vlerën *neto* të qirasë, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kjo kontratë nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.4.8.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime e të paraqesë dokumentacion lidhur me këtë rezultat hetimi.

**46.4.9.** Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se është në pamundësi për të provuar me dokumentacion mënyrën e arkëtimit të kësaj qiraje, si dhe pagesën e tatimit në burim, për shkak se kontrata është lidhur nga babai i tij përpara 18 viteve, i cili ka ndërruar jetë. Sipas

<sup>63</sup>Shihni f. 14 të pyetësin nr. 4.

tij, detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim i takon shoqërisë tregtare, në rastin konkret, bankës. Gjithashtu, subjekti sjell në vëmendje përgjigjen e DPT-së, sipas së cilës rezultoi se banka nuk është debitorë pranë këtij institucioni për mospagim tatimesh. Në konkluzion të parashtrimeve të tij, në lidhje me këtë kontratë subjekti kërkon përfshirjen e shumës së përfituar nga kjo kontratë në vlerën 15.600 USD, në analizën financiare para fillimit të detyrës të ndarë sipas viteve 2004, 2005 dhe 2006.

**46.4.10.** Nga analiza e parashtrimeve, konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur prova të reja në lidhje me këtë kontratë qiraje jonoteriale, të thjeshtë. Në këto kushte përderisa: (i) pasuria është apartament dhe destinacioni i saj ka qenë për të banuar administratori i bankës, i cili është një individ, pra apartamenti nuk është përdorur për aktivitet tregtar; (ii) përgjegjësia për pagesën e tatimit në burim bie mbi subjektin derisa në kontratë nuk është parashikuar ndryshe; (iii) nuk është provuar pagesa e tatimit në burim, këto të ardhura nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme.

**46.5. Kontratë mes shtetasit A. P. dhe K. të K. S. nga prilli i vitit 2007 deri në tetor të vitit 2007,** me çmim 600 euro/muaj. Subjekti nuk ka paraqitur kontratë për të vërtetuar marrëdhënien e qirasë, por ka deklaruar se pagesa bëhej me çek në “Raiffeisen Bank”.

**46.5.1.** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 shtesë, subjekti ka paraqitur 6 mandatpagesa, sipas të cilave ka rezultuar se babai i tij A. P. ka tërhequr nga “Raiffeisen Bank” shumën 4.200 euro, për qiranë e 7 muajve të vitit 2007. Këto mandate janë verifikuar edhe nga “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2022, drejtuar subjektit. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi qiranë.

**46.5.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur, megjithëse, nuk është provuar pagesa e tatimit në burim, por është provuar marrja e qirave me bankë dhe qiramarrësi është organizatë/jo individ, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kjo marrëdhënie, të konsideruara në vlerë *neto* prej 4.200 euro, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitin 2007.

**46.6. Kontratë qiraje nr. \*\*\* , datë 20.5.2008<sup>64</sup>,** për objektin apartament me sip. 111m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, nga data 15.4.2008 deri më 31.7.2009, vlera 550 euro/muaj është *neto*, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit E. M. Pagesa kryhet nëpërmjet BKT-së. Pagesa e tatimit është parashikuar të kryhet nga qiramarrësi, përveç vlerës së kontratës prej 550 euro/muaj.

**46.6.1.** Në pyetësorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë i takon pasurisë me adresë rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), Tiranë, ndërsa në kontratë është deklaruar adresa rruga “\*\*\*\*”, Tiranë. Pra, siç vërehet, ka një mospërputhje në adresën e pasurisë sipas kontratës, me atë të deklaruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

**46.6.2.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime dhe paraqesë dokumentacion lidhur me mospërputhjen e adresës së pasurisë, për të cilat subjekti, në parashtrimet e tij, ka dhënë sqarimet si më sipër, që u vlerësuan bindëse nga Komisioni.

**46.6.3.** Sipas lëvizjes së llogarisë së babait të subjektit A. P. në BKT, është evidentuar se shuma totale e përfituar nga qiraja për periudhën prill 2008 - korrik 2009, është 8.250 euro.

**46.6.4.** Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, subjekti ka cituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2022, nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj<sup>65</sup> sipas së cilës, kjo drejtori informon se nuk mund të japë informacion për pagesën e tatimit në burim nga E. M.

**46.6.5.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2022, drejtuar Komisionit nga DTM-ja, janë përcjellë të dhëna për pagesa me përshkrimin “tatim në burim”, nga shoqëria “\*\*\*\*”, për vitet 2008 – 2012. Sipas kësaj shkrese pagesat e tatimit në burim janë në total dhe jo sipas pagesës

<sup>64</sup>Shihni f. 5-9, pyetësori nr. 2-shtesë, paraqitur nga subjekti në datën 15.11.2021.

<sup>65</sup>Shihni f. 14 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 4.

së individëve qiradhënës. Nga përmbajtja e shkresës, si dhe nga shumat në total të tatimit në burim mbi qiratë, nuk mund të evidentohet nëse aty përfshihet edhe tatimi mbi qiranë për pasurinë e dhënë me qira nga babai i subjektit.

**46.6.6.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) në kontratë është parashikuar vlera *neto* e qirasë; (ii) është provuar nëpërmjet *statementit* të BKT-së që babai i subjektit ka përfituar vlerën *neto* të qirasë, sikurse përcaktuar në kontratë, pagesa e tatimit në burim nuk është nën përgjegjësinë e qiradhënësit. Në këto kushte, të ardhurat nga qiraja, të kaluara në llogarinë bankare të babait të subjektit, gjithsej në shumën 8.250 euro (për vitin 2008 shuma 4.400 euro dhe për vitin 2009 shuma 3.850 euro), janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.7. Marëdhënia e qirasë e evidentuar nga lëvizjet e llogarisë A. ose Arian Përmeti në BKT, ku janë evidentuar kreditime për periudhën nëntor 2009 - maj 2010, në shumën 550 euro/muaj nga shoqëria “\*\*\*\*”.** Vlera totale e kredituar në këtë llogari, për periudhën nëntor 2009 – maj 2010, është 4.950 euro.

**46.7.1.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se nuk e disponon këtë kontratë dhe nuk e di kohëzgjatjen reale të saj, por bazohet te lëvizja e llogarisë në emër të A. dhe Arian Përmeti në BKT.

**46.7.2.** Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, subjekti ka cituar se ka kërkuar informacion nga DRT-ja Tiranë, për të cilën nuk ka marrë përgjigje. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, drejtuar Komisionit nga DRT-ja Lezhë, është marrë informacion se subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k. me NIPT \*\*\* është regjistruar në datën 11.8.2014 dhe ka kaluar në status pasiv në datën 6.5.2016. Ky subjekt ka qenë i regjistruar për përgjegjësi tatimore tatim në burim për periudhën që ka qenë në status aktiv, por është mosdeklarues i kësaj përgjegjësie. Nga kjo shkresë evidentohet se bëhet fjalë për subjektin “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe jo “\*\*\*\*” sh. a., për të cilën Komisioni kishte kërkuar informacion.

**46.7.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur, megjithëse, nuk është provuar pagesa e tatimit në burim, por personi juridik ka kaluar në llogari bankare vlerën e qirasë, ajo është konsideruar si e ardhur e ligjshme *neto* dhe është përfshirë në analizën financiare të subjektit në vlerën 1.650 euro për vitin 2009 dhe 3.300 euro në vitin 2010.

**46.8. Kontrate qiraje datë 27.8.2010<sup>66</sup>** për objektin apartament me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, Tiranë, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit S. F. J., me afat 27.8.2010 - 27.8.2011, vlera e qirasë 500 euro/muaj. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim. Bashkëngjitur kontratës gjendet mandatpagesa e datës 21.01.2019 nga “Raiffeisen Bank”, që i takon periudhës tatimore dhjetor 2018, lidhur me pagimin e tatimit në burim në shumën 49.500 lekë nga shtetasi Arian Përmeti, një periudhë kohore pas asaj të rivlerësimit.

**46.8.1.** Pas kërkesës së subjektit për informacion, drejtuar DRT-së Tiranë, për pagesën e tatimit në burim mbi qiranë nga shtetasi i huaj S. F. J. për periudhën 27.8.2010 – 27.12.2015, kjo drejtori është përgjigjur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2021 se *për periudhën e kërkuar nuk u gjetën të dhëna për pagesë tatimi në burim mbi qiranë nga subjektet S. F. J., I.C. J., fondacioni “\*\*\*\*”.*

**46.8.2.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur disa dokumente<sup>67</sup>, sipas të cilave ka rezultuar se: (i) qiramarrësi, së bashku me bashkëshorten e tij, kanë jetuar dhe punuar në Shqipëri në periudhën 2010 – dhjetor 2015; (ii) ata kanë banuar në adresën rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, Tiranë; (iii) nuk është paguar tatimi në burim mbi qiranë nga ana e tyre.

<sup>66</sup>Shihni dokumentacionin përcjellë me pyetësorin standard, f. 84-90.

<sup>67</sup>Shihni dokumente në f. 203-2017, në pyetësorin nr. 3-shtesë, të paraqitura nga subjekti të protokolluara nga Komisioni me nr. \*\*\*, datë 28.2.2022.

**46.8.3.** Në pyetëtorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga qiraja deri në dhjetor të vitit 2015, por nuk ka paraqitur kontratë tjetër të vlefshme pas datës 27.8.2011. Gjithashtu, subjekti deklaroi se kjo kontratë i takon pasurisë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” (\*\*\*), Tiranë, ndërsa në kontratë është deklaruar adresa rruga “\*\*\*\*”, Tiranë.

**46.8.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi: (i) marrëdhënien e qirasë nga gushti i vitit 2011 deri në dhjetor të vitit 2015; (ii) mospërputhjen e adresës së pronës së dhënë me qira të shënuar në kontratë dhe të asaj të deklaruar në pyetëtorin nr. 4.

**46.8.5.** Në parashtrimet e tij<sup>68</sup>, në lidhje me vazhdimësinë e kësaj kontrate qiraje, subjekti sjell në vëmendje se në pikën 4 të saj citohet se *me dakordësinë e palëve kontrata ripërsëritet*, ndërkohë që, përgjithësisht, në fillim lidhej një kontratë dore që shërbente për momentin fillestar të kontraktimit të palëve, pasi shtetasit e huaj e kishin domosdoshmëri për nxjerrjen e lejes së qëndrimit. Ai, gjithashtu, sjell në vëmendje dokumentacionin e depozituar më parë prej tij, në të cilin pasqyrohet qartësisht qëndrimi i këtij shtetasi në ambientin e marrë me qira nga shtetasi A. P., konkretisht: adresat e leje qëndrimeve dhe një kallëzim penal të bërë nga ky shtetas në datën 12.2.2014, për një vjedhje të ndodhur në banesën ku ai jetonte, me adresë rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, apartamenti \*\*\*, ku ndërmjet të tjerave sqaron se ka 3 vjet e gjysmë me qira në këtë ambient.

**46.8.6.** Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur dokumentet: (i) kontratë qiraje datë 27.8.2013, lidhur ndërmjet qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit S. F. J., me afat 2-vjeçar, përcjellë me përgjigjen nr. \*\*\*, datë 13.7.2022, të DPPSH-së; (ii) shkresë të shtetasit S. F. J. drejtuar shtetasit A. P. në datën 15.10.2015, ku ai e informon se do të largohet nga banesa në datën 12.11.2015; (iii) aktekspertimi grafik shkrimi datë 11.7.2022, përmes së cilës është vërtetuar dhe provuar që shkresa është bërë nga ky shtetas.

**46.8.7.** Sa i takon mospërputhjes së adresës subjekti ka dhënë sqarimet e paraqitura si në pikat më sipër.

**46.8.8.** Nga analiza e këtyre dokumenteve konstatohet se: (i) nga përmbajtja e shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, nga DPPSH-ja vërtetohet se shtetasi i huaj S. F. J. dhe bashkëshortja e tij figuron të kenë deklaruar për banim adresën rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, kati \*\*\*, Tiranë, në periudhën 2011 – 2014; (ii) nga përmbajtja e procesverbalit për kallëzimin e veprës penale të datës 12.2.2014 është deklaruar si adresë rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\* dhe se ai ka deklaruar se jeton atje prej 3.5 vitesh; (iii) nga përmbajtja e kontratës së qirasë të datës 27.8.2013, rezulton se afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë dyvjeçar duke u nisur nga data 27.8.2013, vlera e qirasë 500 euro/muaj. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim; (iv) qiramarrësi S. J. ka informuar për largimin e tij nga banesa në datën 12.11.2015. Pra, siç vërehet, pavarësisht se nuk provohet me dokumente marrëdhënia e qirasë, ka të dhëna për vazhdimësinë e saj deri në vitin 2015.

**46.8.9.** Në datën 11.2.2022, subjekti ka kryer një pagesë në shumën 583.680 lekë nëpërmjet një transferte nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank” me përshkrimin “Arian Përmeti, pagesë tatim i mbajtur në burim mbi qiranë e S. F. J., A. P., Janar 2022”.

Vitet	2 010	2 011	2 012	2 013	2 014	2 015	<b>Total</b>
Qiraja (euro)	2 000	6 000	6 000	6 000	6 000	6 000	<b>32 000</b>
Tatimi për t’u paguar <sup>69</sup>	200	600	600	600	600	900	<b>3 500</b>

Nisur nga sa më sipër, duket se shuma e tatimit mbi të ardhurat e paguar në datën 11.2.2022 i përkasin qirasë së përfituar nga babai i subjektit për periudhën shtator 2010 – dhjetor 2015.

<sup>68</sup>Për këtë marrëdhënie shihni f. 90-109 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.

<sup>69</sup>Deri në vitin 2015 tatimi në burim është 10% mbi qiranë e përfituar dhe në vitin 2015 ai bëhet 15%.

**46.8.10.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur pagesa e tatimit në burim është kryer në shkurt të vitit 2022, pra gjatë procesit të rivlerësimit, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me subjektin S. F. J. në shumën 32.000 euro, nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.8.11.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime e paraqesë dokumente, lidhur me këtë fakt.

**46.8.12.** Në parashtrimet e tij, në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, subjekti ka deklaruar se duke qenë se kontrata nuk ishte lidhur prej tij, por prej babait të tij, ai vetë nuk ka qenë i informuar për pagesën e detyrimeve tatimore. Me marrjen dijeni nga organet tatimore se pagesa e tatimit në burim nuk ishte kryer as nga z. S. J. (njoftuar me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 19.11.2021, nga DRT-ja Tiranë) as bashkëshortja e tij dhe as nga fondacioni, e ka kryer vetë këtë pagesë në shumën 583.680 lekë.

Sipas subjektit, rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit duhet të kenë qenë si pasojë e pakujdesisë apo paqartësisë së babait të tij dhe jo ndonjë qëllim tjetër. Komisioni, sipas tij, duhet të mbajë parasysh volumin e madh të kontratave të qerasë dhe sjelljen e babait të tij si bashkëpronar në kontrata të tjera, ku pagesa e detyrimeve tatimore për një periudhë të gjatë kohore është kryer vullnetarisht nga përfaqësues të bashkëpronarëve edhe në vitet e largëta, duke nisur që nga viti 1995, çka tregon për përgjegjshmërinë e familjarëve të tij.

**46.8.13.** Lidhur me pagesën me vonesë të detyrimeve tatimore, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit jurisprudencën e Kolegjit dhe qëndrimet e mbajtura nga Komisioni si vijojnë:

- Në vendimin nr. 15, datë 18.6.2021, Kolegji orienton: *“Për sa i përket një qëndrimi orientues, në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t’u arritur. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepre penale”.*

- Në vendimin nr. 56, datë 1.8.2018, Komisioni arsyeton se: *“Nga provat e depozituara nga subjekti në seancën dëgjimore, rezulton se për shumën e përfitur nga z. F. H. është paguar tatimi mbi të ardhurat personale në datën 30.7.2018, z. F. H., në cilësinë e individit, kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat personale në kuptim të pikës ‘dh’ të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar. Neni 13/9 i po këtij ligji përcakton se për mosplotësim në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore. Neni 113 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, përcakton se të gjithë tatimpaguesit, përveç tatimpaguesit të tatimit mbi fitimin, që nuk dorëzojnë në afatin e përcaktuar sipas ligjit përkatës deklaratën tatimore, për të cilën detyrohen sipas ligjit të deklarohen, dënohen me 5.000 lekë gjobë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat. Pra, ligji tatimor nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë, për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor. 20 Në vlerësimin e kësaj prove, Komisioni ka mbajtur parasysh se dispozitat e legjislacionit financiar nuk pengojnë pagimin e tatimit, përtej afatit të*

*parashikuar, si dhe faktin që subjekt i detyrimit tatimor ka qenë babai i subjektit dhe jo vetë subjekti. Nëpërmjet pagimit të tatimit është përmbushur detyrimi ndaj buxhetit të shtetit duke u ligjëruar kështu burimi i këtyre të ardhurave në favor të subjektit”.*

- Në vendimin nr. 212, datë 22.11.2019, të Komisionit arsyetohet se: “Nga të gjitha sa më sipër, në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni, çmoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat nga qiratë për periudhën 2013–2015, në shumën prej 366.733 lekësh (tatimi për të cilat është paguar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit), referuar fakteve si vijojnë: (i) të ardhurat nga qiraja janë deklaruar saktësisht nga subjekti që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 e në vijim, deklarime të cilat përputhen me deklaratën ‘Vetting’; (ii) marrëdhënia juridike e qirasë vërtetohet me një kontratë noteriale të lidhur që në vitin 2013, me dy subjekte qiramarrëse, të cilët kanë qenë dhe janë persona fizikë të regjistruar në organet tatimore: A. S. me NIPT \*\*\* dhe A. D. me NIPT \*\*\*; (iii) sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, dhe në referencë të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke qenë se qiramarrësi është person fizik, mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor. iv) ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, në nenin 114, parashikon pagimin e detyrimit tatimor jashtë afatit të caktuar me ligj, duke përcaktuar sanksionet përkatëse, ndërkohë që neni D i Aneksit të Kushtetutës, nuk e lidh pagimin e detyrimeve tatimore me ndonjë afat kohor të përcaktuar”.

**46.8.14.** Në konkluzion të parashtrimeve të tij, subjekti i kërkon Komisionit përfshirjen e shumës së përfituar nga kjo kontratë qiradhënieje të ndarë sipas viteve, nga viti 2010 deri në vitin 2015.

**46.8.15.** Bazuar në orientimet e dhëna nga Kolegji në vendimin e mësipërm, për rastin konkret nga ana e Komisionit vlerësohet se: (i) subjekti ka provuar marrëdhënien e qirasë mes babait të tij dhe shtetasit S. J. si individ dhe jo si fondacion për një periudhë 1-vjeçare dhe, më tej, ka *indicie* për vazhdimësinë deri në vitin 2015; (ii) detyrimi për pagesën e detyrimit tatimor i takon qiradhënësit, pra babait të subjektit, pagesë e cila nuk është kryer prej tij, por është kryer prej subjektit gjatë procesit të rivlerësimit; (iii) në dy vendimet e referuara më sipër të Komisionit, është e vërtetë që janë konsideruar të ligjshme të ardhurat nga qiratë, pagesa e detyrimit tatimor, për të cilat është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, por në të dyja rastet ky detyrim ka qenë i qiramarrësve.

**46.8.16.** Komisioni, duke mbajtur në konsideratë faktet si vijojnë: (i) ekzistencën e 2 kontratave për periudhat 27.8.2010 – 27.8.2011, e rinovueshme, dhe 27.8.2013 – 27.8.2015 (ii) kontratat janë jonoteriale, por të lidhura midis babait të subjektit + S. J. + Agjencisë \*\*\*; (iii) të dhëna të mjaftueshme që provojnë se çifti J. ka banuar në këtë adresë/apartament; (iv) ka shkresë dore nga S. J. datë 15.10.2015 që kërkon largimin nga banesa në datën 12.11.2015 dhe aktekspertimi për firmën e S. J.; (v) nuk është provuar marrja e qirasë, pasi nuk ka kalime në bankë ose pagesë me çek; (vi) babai i subjektit ka pasur detyrim të paguajë tatimin në burim, pasi kontrata është lidhur me individ; (vii) subjekti është vënë në dijeni që nuk janë paguar tatimet në datën 19.11.2021 dhe i ka paguar ato në janar të vitit 2022, ka vlerësuar se qiratë e përfituara nga kjo kontratë nuk merren në konsideratë në fund të procesit të rivlerësimit.

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*) , Tiranë, janë lidhur kontratat si vijojnë:**

**46.9. Marëdhënia e qirasë evidentuar nga lëvizjet e llogarisë në “Fibank”<sup>70</sup>, ku janë evidentuar kreditime në llogarinë e babait të subjektit për periudhën mars 2008 - shkurt 2009.** Vlera mujore e kredituar është 550 euro e konvertuar në lekë. Nga kjo llogari bankare

<sup>70</sup>Shihni dokumentet në f. 171-176, të paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3 shtesë.

evidentohet se qiramarrësi është “Fibank” dhe se qiraja e paguar i takon periudhës 1.3.2008 - 18.1.2009.

**46.9.1.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka paraqitur: certifikatën e pronësisë për pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, Tiranë, lëshuar në datën 10.12.2015 me pronare motrën e subjektit, znj. A. P.<sup>71</sup>, dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2022, nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj<sup>72</sup> sipas së cilës, kjo drejtori informon se nuk mund të japë informacion për pagesën e tatimit në burim nga “Fibank”.

**46.9.2.** Vlera totale që ka kaluar në llogarinë e shtetasit A. P. në “Fibank” është 720.910 lekë, nga të cilat 666.241 lekë gjatë vitit 2008 dhe 54.669 lekë për vitin 2009.

**46.9.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) nuk ka kontratë në të cilën të jetë përcaktuar vlera *neto* e qirasë dhe tatimi në burim mbi të; (ii) nuk është provuar pagesa e tatimit në burim, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kjo pasuri nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.9.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime e paraqesë dokumente në lidhje me këtë rezultat.

**46.9.5.** Në parashtimet e tij, subjekti pretendon se megjithëse nuk është provuar pagesa e tatimit në burim, personi juridik e ka kaluar në llogarinë bankare vlerën e qirasë dhe kjo duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme *neto* dhe duhet të përfshihet në analizën financiare sipas viteve përkatëse. Në këto kushte, subjekti deklaroi se mosgjethja e kontratës së qirasë në kushtet kur pagesa është kryer me bankë, detyrimin tatimor e ka pasur institucioni financiar “Fibank” dhe tatimpaguesit me shumë aktivitete, si rasti i kësaj banke, detyrimet tatimore i paguajnë në total dhe jo të specifikuara dhe, për këtë arsye, nuk mund të interpretohet në disfavorin e tij.

**46.9.6.** Edhe në këtë rast, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit jurisprudencën e Kolegjit dhe të vetë Komisionit, si vijojnë:

- Në vendimin nr. 14/2021, të Kolegjit arsyetohet se: “... pavarësisht se në dy kontratat e lidhura me subjektet ‘{\*\*\*}’ sh.p.k. dhe ‘{\*\*\*}’ sh.p.k., në përmbajtje të tyre përcaktohet rregulli i përgjithshëm që qiradhënësi i nënshtrohet detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurën e përfituar nga qiraja, e cila me të drejtë, referuar parashikimit të nenit 8 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale përbën një burim të tatueshëm të ardhurash, ky parashikim nuk mund të interpretohet se detyrimin për të kryer pagesën e tatimit në buxhetin e shtetit, në masën e përcaktuar nga ligji mbi vlerën bruto të qirasë, e ka qiradhënësi, për sa kohë, referuar kuadrin të sipërcituar ligjor, ky përbën një detyrim ligjor të dy shoqërive qiramarrëse në rastin objekt gjykimi, të cilat ligji i ka përcaktuar si agjentë të mbajtjes së tatimit në burim dhe u ka ngarkuar detyrimin ligjor për të llogaritur në mënyrë të saktë masën e detyrimit tatimor dhe mbajtjen e këtij detyrimi në burim, si dhe pagimin e tij në buxhetin e shtetit në afatin e përcaktuar me ligj. 71. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, konstatoi se pagesat e qirave nga shoqëria ‘{\*\*\*}’ sh.p.k. për periudhën prill 2011 – prill 2013, janë derdhur në vlera që u korrespondojnë secila pagesave mujore ekuivalente me vlerën *neto* të çmimit të qirasë, përveç një pagese të derdhur në tetor të vitit 2011 (me përshkrimin “shtator 2011”), e cila përkon me vlerën bruto të qirasë. Ky fakt dëshmon që shoqëria qiramarrëse e ka njohur dhe e ka zbatuar detyrimin e saj ligjor për llogaritjen dhe mbajtjen në burim të tatimit mbi vlerën bruto të qirasë, pavarësisht faktit të parashikimit jo të qartë në kontratën e qirasë mbi procedurën që duhet ndjekur për përcaktimin e masës së tatimit dhe pagesës së saj sipas kërkesave ligjore në fuqi. Ky konkluzion i trupit gjykues vjen në harmoni të plotë me parashikimet e Kodit Civil mbi faqet 26 nga 47 interpretimin e kontratave 20. Të mosprovuarit e pagesës së tatimit të mbajtur nga

<sup>71</sup>Shihni dokumentet në f. 15, të paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

<sup>72</sup>Shihni dokumentet në f. 14, të paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

*kjo shoqëri tregtare në llogarinë e buxhetit të shtetit, referuar korrespondencës me organin tatimor, sipas shkresës së cituar edhe në vendimin e Komisionit, në vlerësimin e trupit gjykues nuk sjell asnjë efekt në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit me burim qiranë, për sa kohë e ardhura prej kësaj të fundit, e përfituar nga qiramarrësi, është zvogëluar me vlerën e detyrimit tatimor që përcakton ligji dhe për sa kohë pagimi i kësaj shume në buxhetin e shtetit nuk është detyrim i tij. Për më tepër që legjislacioni tatimor parashikon sanksione administrative për agjentët e mbajtjes së tatimit në rastet e llogaritjes dhe mbajtjes së tatimit, por mospagimit në llogarinë e buxhetit të shtetit”.*

- Në vendimin nr. 212, datë 22.11.2019, të Komisionit arsyetohet se: “Nga të gjitha sa më sipër, në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni, çmoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat nga qiratë për periudhën 2013 – 2015, në shumën 366.733 lekë, (tatimi për të cilat është paguar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit), referuar fakteve si vijojnë: (i) të ardhurat nga qiraja janë deklaruar saktësisht nga subjekti që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 e në vijim, deklarime të cilat përputhen me deklaratën ‘Vetting’; (ii) marrëdhënia juridike e qirasë vërtetohet me një kontratë noteriale të lidhur që në vitin 2013, me dy subjekte qiramarrëse, të cilët kanë qenë dhe janë persona fizikë të regjistruar në organet tatimore: A.S. me NIPT \*\*\* dhe A. D. me NIPT \*\*\*; (iii) sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, dhe në referencë të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke qenë se qiramarrësi është person fizik, mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor”.

- Në vendimin e tij nr. 309, datë 16.10.2020, Komisioni, ka konsideruar të ardhurën nga qiraja edhe pse nuk është provuar pagesa e detyrimeve tatimore me arsyetimin se detyrimi ka qenë i subjektit tregtar.

**46.9.7.** Nga analiza e parashtrimeve të subjektit rezulton se nuk është provuar marrëdhënia e qirasë nëpërmjet një kontrate, por sidoqoftë është provuar marrja e shumave të qirasë në “Fibank” me përshkrimin “pagesa për qiranë e muajit, i apartamentit të A.”. Nga përshkrimi i këtyre veprimeve, qiramarrësi nuk duket të jetë “Fibank”, por një individ. Nga këto veprime nuk mund të evidentohet kush është depozituesi ose transferuesi i shumave për të hedhur dritë mbi faktin nëse marrëdhënia ka qenë midis shtetasit A. P. dhe “Fibank” apo A. P. dhe një individ. Në këto kushte, meqenëse nuk ka një kontratë qiraje dhe, për rrjedhojë, nuk mund të dihet se i kujt është detyrimi për pagimin e detyrimeve tatimore dhe qiramarrësi është individ, sipas ligjit ky detyrim i bie qiradhënësit. Në konkluzion, vlerësohet se subjekti nuk ka provuar pagesën e tatimit mbi këto të ardhura dhe, për rrjedhojë, ato nuk janë konsideruar nga Komisioni si e ardhur e ligjshme.

**46.10. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 2.4.2009<sup>73</sup>** midis shtetasit A. P. dhe shoqërisë “\*\*\*\*”, e cila merr me qira apartamentin me sip. 110 m<sup>2</sup> për një punonjës in e saj. Kontrata ka afat nga data 6.4.2009 deri më 6.4.2010 dhe vlera e qirasë është përcaktuar 500 euro/muaj. Në kontratë nuk parashikohet pagesa e tatimit në burim.

Kjo kontratë është ndryshuar në vijim me aktet: shtesë kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 20.5.2009, e cila amendon kontratën e qirasë së datës 2.4.2009, duke shtuar në objektin e saj përveç apartamentit edhe një garazh. Palët në kontratë janë të njëjta, ndërsa vlera e qirasë është ndryshuar në 550 euro/muaj. Në kontratë është përcaktuar edhe tatimi mbi të ardhurat e qirasë 61 euro/muaj dhe pagesa e tij është parashikuar të kryhet sipas legjislacionit në fuqi. Pagesa e qirasë kryhet nëpërmjet “Raiffeisen Bank”; shtesë kontrate nr. \*\*\* rep., datë 16.4.2010 me të njëjtin objekt, palë dhe çmim, për shtyrje afati deri më 6.4.2011; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.12.2011, e cila lë në fuqi kontratën e mëparshme duke e rinovuar atë nga data 6.4.2011 deri më 30.6.2012.

<sup>73</sup>Dokumentet e cituara në pikat 10, 10.2 dhe 10.3 janë paraqitur me pyetësorin 3 shtesë, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022 (shihni f.183-199).



**46.10.1.** Për të provuar pagesat e qirasë, subjekti ka paraqitur një ekstrakt nga lëvizja e llogarisë së babait të tij në “Raiffeisen Bank”, ku evidentohen pagesat e qirasë nga prilli i vitit 2009 deri në korrik të vitit 2012. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi vlerën e qirasë për asnjë nga kontratat dhe rinovimet e tyre.

**46.10.2.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se këto kontrata i takojnë pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe adresa e deklaruar është rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), Tiranë.

**46.10.3.** Shuma e derdhur në “Raiffeisen Bank”, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., për qiratë për periudhën prill 2009 – korrik 2012 është në total 22.400 euro, sikurse treguar në tabelën më poshtë.

**46.10.4.** Referuar kontratave të përshkruara në pikën 46.10. dhe shumës mujore të kredituar në bankë, duket se ajo përfaqëson shumën *neto* të qirasë, të përfituar nga babai i subjektit.

Vitet	2 009	2 010	2 011	2 012	<b>Total</b>
Qiraja e kredituar në BKT (euro)	5 350	6 600	6 600	3 850	<b>22 400</b>

**46.10.5.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2022, drejtuar Komisionit nga DTM-ja (Drejtorja e Tatimpaguesve të Mëdhenj), janë përcjellë të dhëna për pagesa të tatimit në burim nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., nga të cilat evidentohet zëri *Qira objekte të tjera* dhe shuma të paguara si vijon: për vitin 2008 është paguar tatim mbi qiranë në shumën 1.347.011 lekë; për vitin 2011 është paguar tatim mbi qiranë në shumën 1.637.902 lekë; për vitin 2013 është paguar tatim mbi qiranë në shumën 1.176.935 lekë.

Sipas kësaj shkrese sqarohet se pagesat e tatimit në burim janë në total dhe jo sipas pagesës së individëve qiradhënës. Nga përmbajtja e shkresës, si dhe nga shumat e tatimit mbi qiratë të cituara në këtë shkresë, nuk mund të kuptohet nëse aty përfshihet edhe tatimi mbi qiranë për pasurinë e dhënë me qira nga babai i subjektit.

**46.10.6.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) në kontratën e qirasë është përcaktuar vlera *neto* e qirasë dhe vlera e tatimit në burim mbi të; (ii) është provuar pagesa e qirasë në bankë në vlerën *neto* të saj, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontratat me shoqërinë “\*\*\*\*” sh. a., janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), Tiranë, janë lidhur kontratat si vijojnë:**

**46.11. Kontratë qiraje e thjeshtë, pa akt noterial, datë 28.1.2004<sup>74</sup>,** për apartament 2+1, ndodhur në pallatin “\*\*\*\*”, Tiranë, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit “\*\*\*\*” sh.p.k., me afat 2-vjeçar (1.2.2004 – 1.2.2006), vlera 350 euro/muaj. Pagesa e tatimit nuk parashikohet në kontratë.

**46.11.1.** Bashkëlidhur kontratës, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, nga DRT-ja Tiranë<sup>75</sup>, e cila ka informuar subjektin se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ka bërë pagesa për tatimin në burim mbi qiranë, për periudhën 15.2.2004 – 15.2.2006. Bazuar në këtë kontratë, babai i subjektit ka përfituar për periudhën 2-vjeçare shumën 8.400 euro dhe tatimi në burim që do të duhej të ishte paguar është 10% ose 840 euro.

**46.11.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) nga kontrata e qirasë është e paqartë nëse ajo përcakton vlerën *bruto* ose *neto* të saj; (ii) nuk është provuar që babai i subjektit ka marrë vlerën *neto* të saj; (iii) nuk është provuar pagesa e tatimit në burim, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kjo kontratë nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

<sup>74</sup>Shihni dokumentin në f. 136-139 të pyetësit 3-shtesë, të paraqitur nga subjekti dhe të protokolluara nga Komisioni me nr. \*\*\*, datë 28.2.2022.

<sup>75</sup>Shihni dokumentin në f.136, të pyetësit 3-shtesë.

**46.11.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe paraqesë dokumente në lidhje me këtë rezultat.

**46.11.4.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se pavarësisht se në kontratën e qirasë nuk parashikohet se si do të paguhet detyrimet tatimore, ky fakt përcaktohet qartësisht në legjislacionin tatimor dhe asnjë parashikim kontraktual nuk mund të jetë i vlefshëm kur është në kundërshtim me ligjin. Pra, është e qartë dhe e bazuar në ligjin nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe në ligjin nr. 9920, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, se detyrimin për mbajtjen dhe derdhjen e tatimit në burim e ka qiramarrësi kur është person juridik. Nga ana tjetër, sipas tij, është e vështirë të gjesh pas kalimit të afro 18 viteve pranë tatimeve pagesën ose jo të detyrimeve tatimore nga një shoqëri tregtare. Në konkluzion, subjekti i kërkon Komisionit që shuma prej 941.332 lekësh të përlllogaritet në analizën financiare të të ardhurave për vitet 2004 – 2006, pasi është e ardhur e përfituar *neto* dhe detyrimin tatimor sipas legjislacionit në fuqi e ka pasur qiramarrësi, personi juridik “\*\*\*\*” sh.p.k.

**46.11.5.** Nga analiza e parashtrimeve konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur prova të reja dhe se nuk evidentohet qartësisht se cilës pasuri (as numër pasurie, as sipërfaqe) të ndodhur në pallatin “\*\*\*\*” i përket kjo kontratë. Megjithatë, një *indicie* përbën fakti që pasuritë e subjektit ndodhen në pallatin “\*\*\*\*”. Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë se marrëdhënia e qirasë ka qenë me një shoqëri tregtare dhe, si e tillë, nuk ka qenë detyrim ligjor i babait të subjektit për të paguar detyrimet tatimore, Komisioni ka përlllogaritur vlerën *neto* të qirasë duke zbritur 10% të tatimit në burim dhe i ka përfshirë shumat e qirasë *neto* në analizën financiare të subjektit për periudhën shkurt 2004 – shkurt 2006.

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), Tiranë, janë lidhur kontratat si vijojnë:**

**46.12. Kontratë qiraje e thjeshtë, pa akt noterial, datë 1.7.2004<sup>76</sup>** për apartamentin me qira në rrugën “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati \*\*\*, Tiranë, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit F. K. C. F., me afat 2-vjeçar, 1.7.2004 – 1.7.2006, me të drejtë rinovimi, vlera 350 euro/muaj. Pagesa e tatimit në burim është përcaktuar 39 euro dhe do të paguhet nga qiramarrësi. Kjo kontratë është rinovuar në datën 7.6.2006 deri më 31.12.2006.

**46.12.1.** Bashkëlidhur kontratës, subjekti ka paraqitur mandatpagesa nga “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank”, nga të cilat ka rezultuar se shuma prej 350 euro është kredituar çdo muaj në llogarinë e babait të tij A. P., nga korriku i vitit 2004 deri në gusht të vitit 2006<sup>77</sup>. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi vlerën e qirasë.

**46.12.2.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë i takon pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe adresa e deklaruar është rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), Tiranë, ndërsa në kontratë rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, Tiranë.

**46.12.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, sikurse referuar edhe më sipër në këtë vendim, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi mospërputhjen e pronës së dhënë me qira/adresave të deklaruarat prej tij. Sqarimet e dhëna lidhur me këtë çështje u çmuan bindëse, sikurse trajtuar më sipër në këtë vendim.

**46.12.4.** Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, subjekti ka cituar një kërkesë të bërë prej tij (pa datë) ndaj DRT-së Durrës, por nuk ka paraqitur një përgjigje nga kjo drejtori. Bazuar në mandatpagesat e bankave, shuma e përfituar nga qiraja për periudhën 1.7.2004 – 31.8.2006 është në total në shumën 9.100 euro dhe jo 10.500 euro, sikurse parashikohet në kontratë (deri më 31.12.2006) dhe tatimi në burim që do të duhej të ishte paguar është 10% ose 910 euro, sikurse treguar në tabelën vijuese.

<sup>76</sup>Shihni dokumentet në f. 146-170, të pyetësin 3 shtesë.

<sup>77</sup>Shihni dokumentet në f. 150-167, të pyetësin 3 shtesë.

Vitet	2 004	2 005	2 006	<b>Total</b>
Qiraja e kredituar në BKT (euro)	2 100	4 200	2 800	<b>9 100</b>

**46.12.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) në kontratën e qirasë është përcaktuar vlera *neto* e qirasë dhe vlera e tatimit në burim mbi të; (ii) është provuar pagesa e qirasë në “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank” në vlerën *neto*, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kjo kontratë për periudhën korrik 2004 – 31.8.2006 janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.13. Kontratë qiraje datë 4.9.2014 për objektin apartament me sip. 50m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”** T. e R., k.\*\*\* te God. \*\*\*, lidhur mes qiradhënësit A. P., përfaqësuar nga Agjencia \*\*\* dhe shtetasit R. F., me afat 4.9.2014 - 30.8.2015, vlera e qirasë 250 euro/muaj. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim.

**46.13.1.** Kjo kontratë është amenduar duke u hartuar një kontratë e re në datën 1.11.2014 me palë, objekt dhe çmim të njëjtë për periudhën 1.11.2014 - 1.11.2015. Në këtë amendim është parashikuar se vlera e tatimit për t’u paguar prej 25 euro/muaj do të kryhet nga qiramarrësi.

**46.13.2.** Marrëdhënia e mësipërme është rinovuar me kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 20.10.2015, me të njëjtat palë dhe kushte për periudhën 20.10.2015 – 20.10.2017, vlera e qirasë ka mbetur e pandryshuar në 250 euro/muaj dhe vlera e tatimit për t’u paguar prej 44.12 euro/muaj është parashikuar për t’u paguar nga qiramarrësi.

**46.13.3.** Të ardhurat nga qiraja të përfituara në bazë të këtyre kontratave janë pasqyruar në tabelën vijuese.

Vitet	2014	2015	2016	Total
Qiraja <i>neto</i> në euro	1 000	3 000	3 000	<b>7 000</b>

**46.13.4.** Në pyetësin nr. 3 shtesë, subjekti ka sqaruar se pagesa e qirasë te babai dhe pastaj tek ai vetë është kryer me mandatpagesë nga A. \*\*\* (përfaqësuesi i qiramarrësit), si dhe ka paraqitur mandatpagesa për periudhën e qirasë shtator 2014 – dhjetor 2016<sup>78</sup>.

**46.13.5.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se tatimi në burim është paguar nga qiramarrësi dhe ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2022, nga DRT-ja Tiranë, sipas së cilës PF “R. F.”, me NIPT \*\*\* ka kryer pagesat për tatimin mbi qiranë për periudhën 4.9.2014 – 31.12.2016.

**46.13.6.** Në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me PF “R. F.” janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, sipas viteve përkatëse.

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, njësi, me adresë rruga “\*\*\*\*” (“\*\*\*\*”), Tiranë, janë lidhur kontratat, si vijojnë:**

**46.14. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 26.8.2011,** për objektin dyqan me sip. 64 m<sup>2</sup>, në akset \*\*\*-\*\*\* dhe \*\*\*-\*\*\* (nuk përshkruhet as adresë dhe as numër pasurie), të lidhur midis shtetasit A. P. si palë qiradhënëse dhe shtetasit T. Ç. si palë qiramarrëse, me afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 1.10.2011 deri më 1.10.2016, vlera e qirasë 40.000 lekë/muaj. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim. Bashkëngjitur kontratës edhe ekstrakti historik i PF “T. Ç.”<sup>79</sup>. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi vlerën e qirasë.

<sup>78</sup>Shihni pyetësin nr. 3 shtesë, f. 219-268.

<sup>79</sup>Shihni f. 67-72 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 3 shtesë.

**46.14.1.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se: (i) kjo kontratë i takon pasurisë nr. \*\*\*, e cila ndodhet në adresën rr. “\*\*\*\*” (“\*\*\*\*”), Tiranë; (ii) kjo kontratë është ndërprerë përpara afatit dhe kohëzgjatja e saj është nga data 1.10.2011 deri më 1.2.2013 ose 16 muaj; (iii) tatimi në burim duhet të jetë paguar nga personi fizik dhe se është në pritje të shkresës së dërguar nga DRT-ja Tiranë.

**46.14.2.** Vlera totale e përfituar nga kjo qira është 640.000 lekë dhe tatimi në burim që do duhej të ishte paguar është 10% ose 64.000 lekë.

Vitet	2 011	2 012	2 013	Total
Qiraja në lekë	120 000	480 000	40 000	<b>640 000</b>
Tatimi për t’u paguar	12 000	48 000	4 000	<b>64 000</b>

**46.14.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur nuk është provuar: (i) pagesa e tatimit në burim; (ii) vlera e qirasë *neto*; (iii) nuk është provuar marrja e qirasë, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me PF “T. Ç.”, nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.14.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente në lidhje me këtë rezultat.

**46.14.5.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se pavarësisht se në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet se si do të paguhet detyrimet tatimore, ky fakt është i parashikuar qartësisht në legjislacionin tatimor. Gjithashtu, çregjistrimi i aktivitetit presupozon sipas ligjit shlyerjen e gjithë detyrimeve tatimore të saj. Nga ana tjetër, sipas tij, është e vështirë të gjesh pas kalimit të afatit 10-vjeçar pagesën ose jo të detyrimeve tatimore nga një shoqëri tregtare apo person fizik. Sipas tij, PF “T. Ç.” në momentin e fillimit të aktivitetit ka regjistruar pranë QKB-së adresën e kësaj pasurie për zhvillimin e aktivitetit dhe njëkohësisht në momentin e mbylljes së aktivitetit ka çregjistruar pranë QKB-së adresën e kësaj pasurie si vend për zhvillimin e aktivitetit. Në konkluzion të parashtrimeve të tij, në kushtet kur kjo kontratë është lidhur me një subjekt tregtar tatimpagues, subjekti i kërkon Komisionit që të ardhurat e përfituara nga kontrata me PF “T. Ç.”, në vlerën *neto* të saj prej 640.000 lekësh.

**46.14.6.** Nga verifikimet e mëtejshme të kryera lidhur me këtë çështje, pavarësisht se në kontratën e qirasë nuk evidentohet qartë pasuria e dhënë me qira (pra as numri i pasurisë dhe as adresa), por vetëm sipërfaqja, nga dokumentet e pronësisë rezulton që subjekti ka në pronësi një pasuri të llojit “njësi”, me sip. 64 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”. Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së rezulton e regjistruar në vitin 2011 PF “T. Ç.”, me NIPT \*\*\*, që ushtron aktivitet “bar-kafe” në adresën: rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, k. \*\*\*. PF “T. Ç.” është me status “aktiv” në QKB, nuk rezulton e çregjistruar. Ndërkohë, po referuar këtij ekstrakti, në vitin 2014 ka pasur një kërkesë nga DRT-ja Tiranë, ku është kërkuar të mos lejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore.

**46.14.7.** Në vlerësimin përfundimtar të çështjes nga ana e Komisionit vlerësohet se pavarësisht se nuk evidentohet qartësisht prona objekt marrëdhënie qiraje, ka *indicie* që PF “T. Ç.” ka ushtruar aktivitet “bar-bufe” në pasurinë e llojit “njësi”, me sip. 64 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*, 100% në pronësi të subjektit, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”.

Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë faktin se marrëdhënia e qirasë ka qenë me një person fizik dhe, si e tillë, nuk ka qenë detyrim ligjor i babait të subjektit për të paguar detyrimet tatimore dhe për këtë arsye Komisioni ka përllogaritur vlerën *neto* të qirasë, duke zbritur nga vlera 40.000 lekë 10% të tatimit në burim dhe shumat e qirasë *neto* janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për periudhën tetor 2011 deri fund të janarit 2013.

**46.15. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., datë 24.1.2013<sup>80</sup>**, për objektin dyqan me sip. 64 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, T. e R., lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit E. M., me afat nga 1.2.2013 deri më 1.2.2018. Vlera e qirasë: 40.000 lekë/muaj. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim.

**46.15.1.** Bashkëlidhur kësaj kontrate, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigje për pagesat e tatimit në burim mbi qiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, të DRT-së Tiranë<sup>81</sup>, e cila ka informuar subjektin se PF “E. M.” nuk ka bërë pagesa për tatimin në burim mbi qiranë, për periudhën janar 2013 – janar 2014.

**46.15.2.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë është ndërprerë përpara afatit dhe kohëzgjatja e saj është nga data 1.2.2013 deri më 4.9.2013 ose 7 muaj.

**46.15.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur nuk është provuar: (i) pagesa e tatimit në burim; (ii) nëse vlera e qirasë është *neto* apo *bruto*, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me PF “E. M.”, në vlerën totale 280.000 lekë, nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.15.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime të mëtejshme dhe të paraqesë dokumente në lidhje me këtë rezultat.

**46.15.5.** Në parashtrimet e tij, subjekti i kërkoi Komisionit që në kushtet kur kjo kontratë është lidhur me një subjekt tregtar tatimpagues, pavarësisht mospagesës së tatimit në burim në kohë nga ky subjekt, i cili është evidentuar nga organet tatimore dhe është gjobitur dhe bazuar në legjislacionin tatimor dhe jurisprudencën e Kolegjit, të ardhurat e përfituara nga kontrata me PF “E. M.”, në vlerën *neto* 280.000 lekë, të përfshihen në analizën financiare të të ardhurave për vitin 2013.

**46.15.6.** Nga verifikimet e mëtejshme të kryera lidhur me këtë çështje, pavarësisht se në kontratën e qirasë nuk evidentohet qartë pasuria e dhënë me qira (pra as numri i pasurisë dhe as adresa), por vetëm sipërfaqja, nga dokumentet e pronësisë rezulton që subjekti ka në pronësi një pasuri të llojit “njësi”, me sip. 64 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”. Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së rezulton i regjistruar në vitin 2013 PF “E. M.”, me NIPT \*\*\*, për aktivitet “bar-kafe”, në adresën: rruga “\*\*\*\*”, përballë F. J., P. i R., kati 2, PF “E. M.” rezulton me status aktual “i çregjistruar” që në vitin 2015.

**46.15.7.** Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerëson se pavarësisht se nuk evidentohet qartësisht prona objekt marrëdhënie qiraje, ka *indicie* që PF “E. M.” ka ushtruar aktivitet “bar-bufë” në pasurinë e llojit “njësi”, me sip. 64 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, 100% në pronësi të subjektit, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”.

Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë faktin se marrëdhënia e qirasë ka qenë me një person fizik, nuk ka qenë detyrim ligjor i babait të subjektit për të paguar detyrimet tatimore dhe për këtë arsye Komisioni ka përlllogaritur vlerën *neto* të qirasë, duke zbritur nga vlera 40.000 lekë 10% të tatimit në burim dhe shumat e qirasë *neto* janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për periudhën shkurt deri në fund të gushtit të vitit 2013.

**46.16. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., datë 4.9.2013, për objektin dyqan me sip. 64m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\*\*” T. e R.,** për periudhën 1.10.2013 – 1.10.2015. Vlera e qirasë 40.000 lekë/muaj, lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit E. P. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim.

<sup>80</sup>Shihni dokumentin në f. 101-103, të paraqitur nga subjekti me pyetësin 3 shtesë dhe të protokolluara nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022.

<sup>81</sup>Shihni dokumentin në f. 110, të paraqitur nga subjekti me pyetësin 3 shtesë.

**46.16.1.** Në pyetësin nr. 3 shtesë, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigje për pagesat e tatimit në burim mbi qiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, e DRT-së Tiranë<sup>82</sup>, e cila ka informuar subjektin se PF “E. P.” nuk ka bërë pagesa për tatimin në burim mbi qiranë për periudhën tetor 2013 – tetor 2015.

**46.16.2.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë është ndërprerë përpara afatit dhe kohëzgjatja e saj është nga data 1.10.2013 deri më 1.7.2014 ose 9 muaj.

**46.16.3.** Vlera totale e përfituar nga kjo qira është 360.000 lekë, nga të cilat 120.000 lekë për vitin 2013 dhe 240.000 lekë për vitin 2014 dhe tatimi në burim që do duhej të ishte paguar është 10% ose 36.000 lekë.

**46.16.4.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur nuk është provuar: (i) pagesa e tatimit në burim; (ii) nëse vlera e qirasë është *neto*, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me PF “E. P.”, në vlerën totale 360.000 lekë, nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.16.5.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime dhe paraqesë dokumente në lidhje me këtë rezultat.

**46.16.6.** Në parashtrimet e tij, subjekti i kërkon Komisionit që në kushtet kur kjo kontratë është lidhur me një subjekt tregtar tatimpagues, pavarësisht mospagesës së tatimit në burim në kohë nga ky subjekt, i cili është evidentuar nga organet tatimore dhe është gjobitur dhe bazuar në legjislacionin tatimor dhe jurisprudencën e Kolegjit, të ardhurat e përfituara nga kontrata me PF “E. P.”, në vlerën *neto* 360.000 lekë, të përfshihen në analizën financiare të të ardhurave për vitin 2014.

**46.16.7.** Nga verifikimet e mëtejshme të kryera lidhur me këtë çështje, pavarësisht se në kontratën e qirasë nuk evidentohet qartë pasuria e dhënë me qira (pra as numri i pasurisë dhe as adresa), por vetëm sipërfaqja, nga dokumentet e pronësisë rezulton që subjekti ka në pronësi një pasuri të llojit “njësi”, me sip. 64 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”. Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së rezulton i regjistruar në tetor të vitit 2010 PF “E. P.”, me NIPT \*\*\*, për aktivitet “bar-kafe”, me status aktiv, me vend të ushtrimit të aktivitetit: rruga “\*\*\*\*”, pallati përballë F. J., kati \*\*\*.

**46.16.8.** Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerëson se pavarësisht se nuk evidentohet qartësisht prona objekt marrëdhënie qiraje, ka *indicie* që PF “E. P.” ka ushtruar aktivitet “bar-bufe” në pasurinë e llojit “njësi”, me sip. 64 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, 100% në pronësi të subjektit, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”.

Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë faktin se marrëdhënia e qirasë ka qenë me një person fizik dhe, si e tillë, nuk ka qenë detyrim ligjor i babait të subjektit për të paguar detyrimet tatimore për këtë arsye Komisioni ka përllogaritur vlerën *neto* të qirasë, duke zbritur nga vlera 40.000 lekë 10% të tatimit në burim dhe shumat e qirasë *neto* janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për periudhën tetor 2013 deri fund të qershorit 2014.

**46.17. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 1.7.2014<sup>83</sup>**, për objektin dyqan me sip. 64 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, T. e R., e lidhur mes qiradhënësit Arian Përmeti dhe qiramarrësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2.7.2014 – 2.7.2017. Vlera e qirasë 400 euro/muaj, e cila do të kalojë nëpërmjet BKT-së. Në kontratë është parashikuar që detyrimet në shtet do të paguhen sipas ligjit.

**46.17.1.** Në përgjigje të pyetësit nr. 3 shtesë, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2021<sup>84</sup>, nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, sipas së cilës subjekti duhet t’i

<sup>82</sup>Shihni dokumentin në f. 110, të paraqitur nga subjekti dhe të protokolluara nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022.

<sup>83</sup>Shihni dokumentet bashkëlidhur pyetësit standard.

<sup>84</sup>Shihni f. 112 të pyetësit nr. 3 shtesë.

drejtohet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për të marrë informacion me zëra të detajuar që tregojnë pagesat e tatimit në burim për një ambient specifik të marrë me qira.

**46.17.2.** Në pyetësin nr. 4, subjekti ka deklaruar se pagesa e qirasë është bërë nëpërmjet llogarive bankare në BKT dhe në vijim në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe se tatimi mbi qiranë është paguar nga subjekti qiramarrës.

**46.17.3.** Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në BKT<sup>85</sup> ka rezultuar se nga data 1.7.2014 deri më 8.1.2015, janë kryer transfertat bankare në shumën 395 euro/muaj nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “likuidim qira mujore” dhe se në total është kredituar shuma 2.736 euro.

**46.17.4.** Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>86</sup> ka rezultuar se nga data 9.2.2015 deri më 31.12.2016 janë kryer transfertat bankare në shumën 340 euro/muaj nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “likuidim qira mujore”. Nga shumatat e transferuara duket se pjesa e tatimit në burim prej 60 euro/muaj ose 15% mbi shumën e qirasë është mbajtur nga qiradhënësi, ndërkohë që subjekti ka përfituar vlerën *neto* të qirasë.

**46.17.5.** Për këtë kontratë, subjekti ka vënë në dispozicion një vërtetim të datës 24.10.2016 nga shoqëria “\*\*\*\*”<sup>87</sup>, e cila deklaron se ka marrë me qira ambientin me sip. 64 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, z. k. \*\*\*, për një afat 3-vjeçar nga data 2.7.2014 deri më 2.7.2017; vlera mujore e qirasë është 400 euro dhe tatimi në burim 60 euro/muaj. Bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhet urdhërpagesa e datës 19.10.2016, sipas të cilës është paguar tatimi në burim në shumën 180.563 lekë, me përshkrimin “periudha shtator 2016”.

**46.17.6.** Nisur nga shuma e paguar e tatimit, duket se ajo i takon qirasë për periudhën korrik 2014 – korrik 2016. Vlera e qirave, kredituar në bankë në llogarinë e subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”, është treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2014	2015	2016	Total
Qiraja (euro)	2 346	4 410	4 054	10 810
Tatimi për t’u paguar <sup>88</sup>	240	720	720	1 680

**46.17.7.** Në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, sikurse ato janë kredituar në bankë.

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, njësi, me adresë rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, janë administruar kontratat, si vijojnë:**

**46.18. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 14.11.1997<sup>89</sup>,** për ambient me qira me sip. 45 m<sup>2</sup>, me afat nga data 12.11.1997 deri më 12.11.1998. Vlera 30.000 lekë/muaj, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit, shoqëria “\*\*\*\*” e përfaqësuar nga z. L. L. Pagesa e tatimit nuk specifikohet në kontratë.

**46.18.1.** Vlera totale *bruto* e përfituar nga kjo kontratë është 360.000 lekë dhe tatimi në burim që i takon kësaj vlere të qirasë është 10% ose 36.000 lekë. Kështu, shuma *neto* prej 324.000 lekësh është përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitin 1999.

**46.19. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., datë 19.3.1999,** për ambient me qira me sip. 45m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, me afat nga data 1.1.1999 deri më 31.12.1999. Vlera 30.000 lekë/muaj, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit \*\*\*, i përfaqësuar nga z. L. L.

<sup>85</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020, nga BKT në dosjen e Komisionit.

<sup>86</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank” në dosjen e Komisionit.

<sup>87</sup>Shihni dokumentin në aneksin 4/42 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>88</sup>Për vitin 2014, tatimi në burim është në masën 10% mbi qiranë e përfituar dhe në vitin 2015 bëhet 15%.

<sup>89</sup>Kontratat e trajtuara në pikat 18 dhe 19 ndodhen në dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 3, f. 44-66, të paraqitura nga subjekti dhe të protokolluara nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022.

Pagesa e tatimit nuk specifikohet në kontratë. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi vlerën e qirasë.

**46.19.1.** Vlera totale *bruto* e përfituar nga kjo kontratë, është 360.000 lekë dhe tatimi në burim që i takon kësaj vlere të qirasë është 10% ose 36.000 lekë. Shuma *neto* prej 324.000 lekësh është përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitin 1999.

**46.19.2.** Sipas informacionit të përcjellë në shkresën e shoqërisë “\*\*\*\*”<sup>90</sup> marrëdhënia e qirasë me z. A. P. dhe në vazhdim me z. Arian Përmeti, ka filluar nga viti 1997 deri në vitin 2016. Sipas kësaj deklarate kuptohet se kjo qira ka vijuar edhe për vitet 2000 - 2004.

**46.19.3.** Për këtë arsye, vlera mujore e qirasë është zhveshur nga tatimi në burim në masën 10%<sup>91</sup> dhe është përfshirë në analizën financiare të secilit prej viteve 2000 - 2004, në një vlerë *neto* prej 324.000 lekësh/vit ose 1.620.000 lekë për periudhën 5-vjeçare.

**46.20. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., datë 15.2.2005**, për ambient me qira me sip. 45m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, me afat nga data 1.1.2005 deri më 1.1.2010. Vlera 30.000 lekë/muaj, e lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit \*\*\*. Pagesa e tatimit nuk specifikohet në kontratë. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi vlerën e qirasë.

**46.20.1.** Vlera *neto* e qirasë prej 1.620.000 lekësh e përfituar nga kjo kontratë është përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe është përlllogaritur në bazë të shumës *bruto* prej 1.800.000 lekësh, duke u zbritur tatimin në burim prej 10% ose 180.000 lekë.

**46.21. Kontratë qiraje nr. \*\*\* , datë 23.7.2010**, për objektin ambient me sip. 42 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me afat nga data 1.1.2010 deri më 1.1.2015. Vlera e qirasë 30.000 lekë/muaj, pagesa kryhet në formë paradhënieje çdo 3 muaj. Në kontratë nuk parashikohet pagesa e detyrimit tatimor. Nuk ka të dhëna për pagesën e tatimit në burim mbi vlerën e qirasë.

**46.21.1.** Vlera *neto* e qirasë prej 1.620.000 lekësh e përfituar nga kjo kontratë është përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe është përlllogaritur në bazë të shumës *bruto* prej 1.800.000 lekësh, duke u zbritur tatimi në burim prej 10% ose 180.000 lekë.

**46.22. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., datë 24.8.2015**, për ambient me sip. 42 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati \*\*\*, Durrës, lidhur mes qiradhënësit A. P. dhe qiramarrësit \*\*\*, me afat 5-vjeçar, duke nisur nga data 1.1.2015 deri më 1.1.2020, me vlerë qiraje 30.000 lekë/muaj. Në kontratë nuk përcaktohet se kujt i përket detyrimi për pagimin e detyrimeve tatimore. Bashkëngjitur kontratës gjenden fatura TVSH-je për pagesën e qirasë në shumën 30.000 lekë nga shoqëria “\*\*\*\*”, për periudhën prill – dhjetor 2016, por asnjë informacion për pagesën e tatimit në burim.

**46.22.1.** Vlera *neto* e qirasë prej 612.000 lekësh, e përfituar nga kjo kontratë për vitet 2015 dhe 2016, është përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitet përkatëse dhe është përlllogaritur në bazë të shumës *bruto* prej 720.000 lekësh, duke u zbritur tatimi në burim prej 15% ose 108.000 lekë.

**46.22.2.** Në lidhje me kontratat e lidhura me shoqërinë “\*\*\*\*”, të trajtuara në pikat 46.18 - 46.22 më sipër, subjekti ka paraqitur disa dokumente<sup>92</sup>, të cilat vërtetojnë se një nga pikat (dyqanet), ku shoqëria “\*\*\*\*” ka ushtruar aktivitet është pasuria e babait të subjektit, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës.

<sup>90</sup>Shihni deklaratën e firmosur nga drejtori i shitjeve në emër të shoqërisë “\*\*\*\*”, ndodhur në f. 49 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

<sup>91</sup>Vlerës së qirasë prej 30.000 lekësh do t’i zbritet tatimi në burim prej 3.000 lekësh dhe shuma prej 27.000 lekësh/muaj ose 324.000 lekë/vit është qiraja *neto* e përfituar nga subjekti.

<sup>92</sup>Ekstrakt historik i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; deklaratë në zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj, f. 48 dhe 63-66 të pyetësorit nr. 3.



**46.22.3. Në lidhje me pagesën e tatimit në burim mbi qiratë e përfituara nga shoqëria “\*\*\*\*”, në përgjigje të pyetësorëve nr. 3<sup>93</sup> dhe nr. 4<sup>94</sup>, subjekti ka paraqitur:**

i) Deklaratë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., firmosur nga drejtori i shitjeve<sup>95</sup>, sipas së cilës kjo shoqëri ka pasur me qira pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe adresë: rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, nga viti 1997 deri në vitin 2016. Pagesat e qirasë janë kryer *cash* dhe tatimi në burim për këtë dyqan është kryer rregullisht nga qiramarrësi për të gjithë periudhën.

ii) Deklaratë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. firmosur nga shefi i financës, sipas së cilës kjo shoqëri ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj qiradhënësit, për pasuritë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Durrës me sip. 39 m<sup>2</sup> dhe nr. \*\*\* me sip. 3 m<sup>2</sup>, për periudhën 1. 1.2012 – 31.12.2021 (afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit financiar për shoqëritë tregtare).

Sipas kësaj shkrese, pasqyrohet shuma *bruto* e qirasë vjetore, e cila është 360.000 lekë ose 30.000 lekë/muaj, tatimi në burim dhe qiraja *neto*, sikurse në tabelën më poshtë.

iii) Për pagesën e tatimit në burim mbi të ardhurat e përfituara nga kontratat e lidhura me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., të trajtuara në pikat 18 dhe 19, subjekti i është drejtuar DTM-së Tiranë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2021, ka informuar në lidhje me kontratat e lidhura të qirasë se *pagesa kryhet në total për të gjitha adresat për të cilat subjekti mund të ketë lidhur kontratë qiraje me qëllim ushtrimin e aktivitetit të tij dhe për këtë arsye konfirmimi për tatimin e paguar për një kontratë qiraje specifike i jepet subjektit deklarues pas detajimit të zërave (pagesat për qiratë dhe tatimi i mbajtur për pagesat për qiratë), për çdo periudhë të deklaruar në sistemin tatimor.*

**46.22.4.** Në përfundim të hetimit administrativ, meqenëse: (i) është vërtetuar marrëdhënia vijuese e qirasë midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit A. e më vonë shtetasit Arian Përmeti; (ii) pagesa e detyrimeve tatimore është kryer nga qiradhënësi, detyrim i parashikuar me ligj, qiraja prej 30.000 lekësh në vlerën *bruto* është zhveshur nga tatimi i përlllogaritur dhe mbajtur në burim nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe është përfshirë në analizën financiare të subjektit për të gjithë periudhën e përfitimit të qirasë, nga nëntori i vitit 1997 deri në datën 31.12.2016.

**Për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, njësi, me adresë rruga “\*\*\*\*”, Durrës, janë lidhur kontratat, si vijojnë:**

**46.23. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 9.10.2010<sup>96</sup>**, për objektin lokal, me sip. 96 m<sup>2</sup>, në Rrugën e Dëshmorëve, Kompleksi \*\*\*, Durrës, regjistruar me nr. \*\*\*, datë 15.7.2007, në ZVRPP-në Durrës, të lidhur midis M. P. si palë qiradhënëse dhe F. K. palë qiramarrëse. Kontrata fillon nga data 4.10.2010 deri më 4.10.2011. Vlera e qirasë: 30.000 lekë/muaj. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim.

**46.23.1.** Në pyetësorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë i takon pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe adresa e deklaruar është Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës ose Rruga e \*\*\*<sup>97</sup>. Subjekti pretendon se nëna e tij ka përfutur qira nga ky subjekt nga data 4.10.2010 deri në korrik 2014, por pa paraqitur ndonjë rinovim kontrate me këtë subjekt<sup>98</sup>. Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2022, nga DRT-ja Durrës<sup>99</sup> sipas së cilës kjo drejtori informon se për subjektin “F. K.” (klub + l. f.), me NIPT

<sup>93</sup>Shihni f. 44-66 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

<sup>94</sup>Shihni f. 34-36 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 4.

<sup>95</sup>Shihni f. 49 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

<sup>96</sup>Paraqitur nga subjekti me pyetësorin standard.

<sup>97</sup>Kjo rezultat nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2022, e DRT-së Durrës.

<sup>98</sup>Në nenin “Kushtet e kontratës” është përcaktuar afati prej 1 viti dhe është parashikuar se pas mbarimit të saj kjo kontratë mund të ripërsëritet me marrëveshje të dy palëve.

<sup>99</sup>Shihni f. 39 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 4.

\*\*\*, nuk figuron dokumentacion i ngarkuar (kontratë qiraje) apo pagesa të kryera për tatimin mbi qiranë nga ky subjekt<sup>100</sup>.

**46.23.2.** Vlera totale e përfituar nga kjo qira është 360.000 lekë dhe tatimi në burim që do duhej të ishte paguar është 10% ose 36.000 lekë.

**46.23.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) nuk është provuar pagesa e tatimit në burim; (ii) është e paqartë nëse vlera e përcaktuar në kontratë dhe ajo e marrë nga nëna e subjektit është *neto* apo *bruto*, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me PF “F. K.”, nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**46.23.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime të mëtejshme dhe të paraqesë dokumentacion në lidhje me këtë rezultat.

**46.23.5.** Në parashtrimet e tij, subjekti deklaron se në dijeninë e tij shtetasi F. K. ishte përfaqësues i një shoqërie lojërash fati, por nuk ka dijeni se kush është kjo shoqëri. Sipas tij, në kushtet kur kjo kontratë është lidhur me një subjekt tregtar tatim pagues, pavarësisht mospasjes informacion për pagesën e tatimit në burim nga ky subjekt, ai i kërkon Komisionit që në mbështetje të legjislacionit tatimor dhe jurisprudencës së Kolegjit të ardhurat e përfituara nga kontrata me shtetasin F. K., në vlerën *neto* 360.000 lekë, duhet të përfshihen në analizën financiare të të ardhurave për vitet 2010 dhe 2011.

**46.23.6.** Nga verifikimet e mëtejshme, pavarësisht se në kontratë nuk evidentohet qartësisht se cilës pasuri i përket kjo kontratë (nr. pasurie), nga dokumentet e pronësisë rezulton se subjekti është bashkëpronar në pasurinë e llojit “njësi”, me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”. Ndërkohë, nga verifikimi në *google map* vërehet se rruga “\*\*\*\*” dhe Rruga e \*\*\* nuk ndodhen pranë njëra-tjetrës, por rezulton se Rruga e \*\*\* ndodhet në z. k. \*\*\*.

**46.23.7.** Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, duke mbajtur në konsideratë faktin se marrëdhënia e qirasë ka qenë me një person fizik dhe, si e tillë, nuk ka qenë detyrim ligjor i babait të subjektit për të paguar detyrimet tatimore, Komisioni ka përlllogaritur vlerën *neto* të qirasë, duke zbritur nga vlera 30.000 lekë 10% të tatimit në burim dhe shumat e qirasë *neto* janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për periudhën tetor 2010 deri fund të shtatorit 2011.

**46.24. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 6.8.2014**, për objektin dyqan me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës, lidhur mes qiradhënësve A. P., Arian Përmeti, A. P. dhe palës qiramarrëse I. I. (përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*”), me afat 1.9.2014 – 1.9.2016. Vlera e qirasë: 30.000 lekë/muaj. Nga kjo kontratë subjekti dhe babai i tij (që jetojnë së bashku) përfitojnë 2/3 e vlerës së qirasë.

**46.24.1.** Në pyetësorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë është ndërprerë përpara afatit dhe kohëzgjatja e saj reale është nga data 1.9.2014 deri më 1.11.2015 ose 14 muaj. Subjekti ka paraqitur:

- vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.1.2010, që provon pronësinë 100% të shtetases M. P. mbi këtë njësi;
- shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022, nga A. M. L. F.<sup>101</sup>, sipas të cilës shtetasi I. I. figuron i regjistruar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., me NIPT \*\*\*, si dhe pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., me NIPT \*\*\*. Në këtë shkresë, për të dyja shoqëritë specifikohet se *sipas dokumentacionit të depozituar nga kjo shoqëri, shtetasi i mësipërm rezulton i punësuar në adresën sekondare Lagjja \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*-katësh, nr. \*\*\*, kati i \*\*\*-rë, shkalla e \*\*\*-rë.*

<sup>100</sup>Kjo shkresë referon dy subjekte tregtare në emrin F. K., me NIPT \*\*\* dhe NIPT \*\*\*.

<sup>101</sup>Shihni f. 40 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 4.

**46.24.2.** Në përgjigjet e datës 13.6.2022, subjekti ka përcjellë shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2022<sup>102</sup>, sipas së cilës DRT-ja Tiranë ka vërtetuar se subjekti “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, ka paguar tatim në burim për periudhën 1.9.2014 – 31.12.2014, si dhe për periudhën 1.1.2015 – 1.9.2016.

**46.24.3.** Vlera totale e përfituar nga subjekti dhe babai i tij për këtë kontratë është 280.000 lekë *bruto* (2/3 e vlerës totale prej 420.000 lekësh, nga të cilat 80.000 lekë *neto* në vitin 2014 dhe 200.000 lekë në vitin 2015) dhe tatimi në burim që është paguar për këto të ardhura është 57.000 lekë.

**46.24.4.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur: (i) është provuar pagesa e tatimit në burim; (ii) ky tatim është zbritur nga vlera *bruto* e qirasë prej 30.000 lekësh, pjesa 2/3 e qirasë *neto* e përfituar nga subjekti dhe babai i tij, nga kontrata e qirasë me I. I./\*\*\*, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitet 2014 dhe 2015.

**46.25. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 17.11.2015**, për objektin lokal me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës, lidhur midis palës qiradhënëse A. P., Arian Përmeti dhe A. P. dhe qiramarrës PF “I. I.”, për periudhën 15.9.2015 – 15.9.2019. Vlera e qirasë: 35.000 lekë/muaj. Në kontratë është parashikuar se tatimet do të paguhen nga qiradhënësi. Nga kjo kontratë subjekti dhe babai i tij (që jetojnë së bashku) përfitojnë 2/3 e vlerës së qirasë.

**46.25.1.** Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të QKB-së ka rezultuar se PF “I. I.” është regjistruar në datën 21.9.2015, me NIPT \*\*\*, me aktivitet “bar-kafe”.

**46.25.2.** Në pyetësin nr. 3, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje për pagesat e tatimit në burim mbi qiranë nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2021, nga DRT-ja Durrës, e cila informon se për kontratën në fjalë, PF “I. I.”, me NIPT \*\*\*, ka bërë pagesa për tatimin në burim mbi qiranë, për periudhat nëntor – dhjetor 2015 dhe janar – dhjetor 2016.

Vitet	Nëntor – dhjetor 2015	Janar – dhjetor 2016	Total
Qiraja në lekë	70 000	420 000	<b>490 000</b>
Tatimi për t’u paguar	10 500	63 000	<b>73 500</b>

**46.25.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, 2/3 e të ardhurave nga qiraja *neto*, ose në total 277.667 lekë, të përfituara nga kontrata me PF “I. I.”, për periudhën nëntor 2015 – 31.12.2016, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, derisa është provuar pagesa e tatimit në burim.

**Për pasurinë nr. \*\*\* , z. k. \*\*\*, njësi, me adresë Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës, janë lidhur kontratat, si vijojnë:**

**46.26. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 13.7.2009<sup>103</sup>**, për objektin lokal, me sip. 96 m<sup>2</sup> në Rrugën e D., kompleksi \*\*\*, Durrës, regjistruar me nr. \*\*\*, datë 15.7.2007, në ZVRPP-në Durrës, me afat nga data 1.7.2009 deri më 1.7.2011, vlera e qirasë 40.000 lekë/muaj, të lidhur mes qiradhënëses M. P., përfaqësuar me prokurë nga subjekti Arian Përmeti dhe qiramarrës “\*\*\*\*” sh.p.k. Nuk parashikohet pagesa e tatimit në burim.

**46.26.1.** Bashkëlidhur kësaj kontrate subjekti ka paraqitur: (i) ekstraktin e QKR-së së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku evidentohet se në datën 13.7.2009 kjo shoqëri ka shtuar/regjistruar adresën Lagjja Nr. \*\*\*, Rruga e D., dyqan pranë bar “\*\*\*\*”, adresë e cila është hequr nga QKR-ja në datën 1.1.2011, pra me mbarimin e kontratës së qirasë; (ii) vërtetim nga departamenti i financës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas të cilit shtetasja M. P. do të kryejë pagesën e tatimit mbi qiranë në shumën 84.000 lekë për periudhën 1.7.2009 – 31.3.2011; dhe

<sup>102</sup>Shihni f. 55-60 të përcjella nga subjekti me përgjigjet e datës 13.6.2022.

<sup>103</sup>Shihni dokumentet në f. 73-84, në pyetësin nr. 3, të paraqitura nga subjekti të protokolluara nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022.

(iii) mandatarkëtimi datë 6.4.2011, në shumën 84.000 lekë paguar tek dyqani në Durrës për \*\*\* Tiranë.

**46.26.2.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime se çfarë përfaqësojnë adresat në rrugën “\*\*\*\*” dhe në Rrugën e D., të dyja në Durrës.

**46.26.3.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se këto dy rrugë kryqëzohen me njëra-tjetrën. Sipas tij, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* është pallati në katin e parë të cilit ndodhen pasuritë njësi, ish-pronë e shtetasës M. P., më pas kaluar trashëgimtarëve të saj. Njësitë në katin e parë të këtij pallati njihen ndryshe dhe si Kompleksi \*\*\*, Durrës. Nga verifikimi në *Google Map*, në mungesë të emërimit të saktë të rrugës, nuk u arrit të provohet që këto rrugë kryqëzohen me njëra-tjetrën, megjithatë rezulton se Rruga e D. ndodhet në z. k. \*\*\*.

**46.26.4.** Nisur nga masa 10% e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja dhe vlera e paguar nga nëna e subjektit rezulton se shuma e përfituar nga qiratë është 840.000 lekë, që përfaqëson qiratë e 21 muajve<sup>104</sup>. Të ardhurat *neto* nga qiraja të përfituara nga kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., ose 756.000 lekë, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitet 2009, 2010 dhe 2011, derisa është provuar pagesa e tatimit në burim.

**46.27. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 18.6.2016**, për objektin apartament me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës, lidhur mes qiradhënësit Arian Përmeti dhe qiramarrësit PF “P. A.”, për periudhën 1.6.2016 – 1.6.2017. Vlera e qirasë: 32.000 lekë/muaj. Në kontratë është parashikuar se tatimi në burim do të kryhet nga qiramarrësi. Bashkëngjitur kësaj kontrate gjendet urdhërpagesa datë 14.10.2016, nga “Credins Bank”, e cila vërteton se PF “P. A.” ka paguar shumën 14.400 lekë tatim mbi qiranë.

**46.27.1.** Në pyetësorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se marrëdhënia e qirasë midis M. dhe A. P. me PF “P. A.” ka filluar në qershor të vitit 2011 dhe ka vazhduar deri më 1.6.2016, por dokumenti i vetëm që ka paraqitur për të provuar këtë marrëdhënie është një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, datë 4.2.2022<sup>105</sup>, nga shtetasja P. A., e cila deklaron se ka ushtruar aktivitetin “\*\*\*\*” në katin e parë të një pallati \*\*\*-katësh në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës nga viti 2011 deri në vitin 2019. Në këtë deklaratë thuhet se qiraja fillimisht ka qenë 20.000 lekë/muaj dhe në vijim 32.000 lekë/muaj. Kjo deklaratë noteriale nuk specifikon se në cilën pronë është ushtruar aktiviteti; se cili është pronari i ambientit; çmimin e caktuar të qirasë në një kohë specifike, e kështu nuk mund të përbëjë provë për të provuar marrëdhënien e qirasë midis PF “P. A.” dhe shtetasve M. e A. P.

**46.27.2.** Në pyetësorin nr. 3<sup>106</sup>, subjekti ka paraqitur dy shkresa kthim përgjigjeje nga DRT-ja Durrës, si vijon: shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2021, sipas së cilës personi fizik ka kryer pagesa për tatimin në burim në vitin 2013 në shumën 48.000 lekë, për periudhën 2011 – 2014, si dhe ka paguar tatim në shumën 45.600 lekë për periudhën qershor – dhjetor 2016; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2021, në vijim të shkresës së mësipërme, sipas të cilës PF “P. A.” ka kryer, përveç sa ka informuar në shkresën e parë, pagesën për tatimin në burim për periudhën korrik – dhjetor 2015 dhe janar – maj 2016.

**46.27.3.** Sipas këtyre dy shkresave, tatimi i paguar nga PF “P. A.” ndër vite është treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2011 – 2014	2015	2016	Total
Qiraja (lekë)	480 000	240 000	424 000	<b>1 144 000</b>
Tatimi i paguar <sup>107</sup>	48 000	36 000	63 600	<b>147 600</b>

<sup>104</sup>40.000 lekë/muaj x 21 muaj = 840.000 lekë, për periudhën korrik 2009 deri në fund të marsit 2011.

<sup>105</sup>Shihni f. 88 të pyetësorit nr. 3 të datës 14.2.2022.

<sup>106</sup>Shihni f. 85-90 në pyetësorin nr. 3.

<sup>107</sup>Deri në vitin 2014, tatimi në burim është në masën 10% mbi qiranë e përfituar dhe në vitin 2015 bëhet 15%.

**46.27.4.** Sidoqoftë, sipas DRT-së Durrës, PF “P. A.”, me NIPT \*\*\*, ka të ngarkuar në sistemin *e-filing* vetëm kontratën e datës 18.6.2016. Në këtë mënyrë mbetet e paqartë nëse pagesat e tatimit në burim për vitet 2011 - 2015 i takojnë marrëdhënies së qirasë për njësinë me nr. pasurie \*\*\* apo ndonjë njësie tjetër, e cila nuk është në pronësi të subjektit dhe familjes së tij.

**46.27.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga marrëdhënia me PF “P. A.” janë përfshirë në analizën financiare të subjektit vetëm për vitin 2016, marrëdhënie e cila është provuar me kontratë, si dhe është provuar pagesa e tatimit në burim për këtë kontratë.

**46.27.6.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua: të japë sqarime në lidhje me paqartësinë se kujt i përkasin pagesat e tatimit në burim për vitet 2011 - 2015, pra nëse i takojnë marrëdhënies së qirasë për njësinë me nr. pasurie \*\*\* apo ndonjë njësie tjetër e cila nuk është në pronësi të subjektit dhe familjes së tij; si dhe të japë sqarime të mëtejshme mbi të ardhurat nga qiraja për vitet e tjera, përveç vitit 2016.

**46.27.7.** Në parashtrimet e tij lidhur me paqartësitë e Komisionit, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, të shtetases P. A., në të cilën deklaroi se: ka ushtruar aktivitet si person fizik me NIPT \*\*\*\*, për vitet 2011 - 2019 në pasurinë me nr. \*\*\*, njësi bar-lokal \*\*\*\*, në rrugën \*\*\*\*, Durrës, ambient në të cilin para saj ka zhvilluar aktivitetin shoqëria \*\*\*\* sh.p.k., më tej deklaroi se marrëdhëniet kontraktore në këtë njësi i ka pasur fillimisht me znj. M. P., më pas me z. A. P. dhe me vdekjen e tyre me z. Arian Përmeti; vlera e qerasë së ambientit fillimisht në vitin 2011 ka qenë 20.000 lekë/muaj dhe në vijim 32.000 lekë/muaj, vlerë me të cilën është lidhur edhe kontrata me z. Arian Përmeti në vitin 2016; për periudhën 2011 – 2016 nuk i disponon kontratat e qerasë me shtetasit M. P. dhe A. P. dhe nuk i kujtohet sa ka qenë vlera e qirasë në këto vite, por ka lëvizur nga 20.000 lekë, duke u rritur në periudha pasardhëse.

Në parashtrimet e tij lidhur me këtë qiradhënie, për vitet 2011 - 2016, subjekti deklaroi se nuk disponon kontratë, por informoi se kjo marrëdhënie qiradhënieje ka filluar që në vitin 2011, pas përfundimit të kontratës së qiramarrjes me shoqërinë \*\*\*\* sh.p.k. në këtë ambient. Sipas tij, referuar shkresave të DRT-së Durrës, me nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2021, PF “P. A.” ka paguar tatimin në burim për vitet 2011 – 2016, në vlerën 147.600 lekë.

Në konkluzion të parashtrimeve të tij lidhur me këtë qiradhënie, subjekti i kërkoi Komisionit që të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie qiradhënieje në vlerën *neto* të saj, për vitet 2011 – 2015, në një shumë totale prej 711.000 lekësh, të përfshihen në analizën financiare të të ardhurave edhe për vitet 2011 – 2015.

**46.27.8.** Nga verifikimet e mëtejshme, referuar dokumenteve të pronësisë, rezultoi se pasuria me nr. \*\*\*, e llojit “njësi”, me sip. 97.33 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. Arian Përmeti, ndodhet në rrugën \*\*\*\*, Durrës. Kurse nga verifikimi i ekstraktit të QKB-së rezultoi e regjistruar PF “P. A.”, për aktivitet \*\*\*\*, me adresë: *Durrës, Lagja Nr. \*\*\*, Rruga e D., objekt me nr. pasurie \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\**. Përpara vitit 2019 kjo adresë ishte: *Lagja Nr. \*\*, rruga \*\*\*\*, pallat \*\*\*, kati i parë, ngjitur me depon farmaceutike \*\*\**. Pra, siç vërehet, nuk përputhet adresa e vendit të ushtrimit të aktivitetit në QKB-në e PF “P. A.”, me adresën në dokumentet e pronësisë, ndërkohë që në periudhën 2011 – 2019 nuk ka vend të ushtrimit të aktivitetit në QKB.

**46.27.9.** Në vlerësimin përfundimtar të çështjes nga ana e Komisionit, vlerësohet se subjekti nuk ka provuar marrëdhënien e qirasë për periudhën 2011 – 1.7.2016 dhe, si i tillë, pretendimi i tij nuk është marrë në konsideratë.

**46.28. Kontratë qiraje e thjeshtë, datë 4.4.1995**, e paraqitur nga subjekti për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 4<sup>108</sup>. Kontrata është lidhur midis shtetasës M. P., e përfaqësuar me prokurë nga z. A. P. dhe PF “Sh. S.” (avokate), për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 15.5.1995, me një çmim prej 17.000 lekësh/muaj. Kontrata nuk i referohet ndonjë objekti specifik, por në të përshkruhet se shtetasja M. P. është pronare e një pjese të dyqaneve në katin përdhe të pallatit nr. \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Durrës, pranë gjykatës. Në kontratë nuk është parashikuar pagesa e tatimit në burim.

**46.28.1.** Në këtë pyetësor, subjekti deklaron se kjo kontratë i takon pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, njësi, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, Lagjja Nr. \*\*\*, Durrës, duke bashkëlidhur certifikatën e pronësisë, lëshuar në datën 3.12.2016, të kësaj pasurie dyqan me sip. 18 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZVRPP-në Durrës në pronësi të motrës së tij A. P. në datën 16.4.2002.

**46.28.2.** Sipas subjektit vlera e përfituar nga kjo qira është në shumën 1.020.000 lekë (17.000 lekë/muaj x 12 muaj x 5 vjet), ndërkohë që sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2021, të DRT-së Durrës, të paraqitur nga subjekti, rezulton se nëna e tij ka paguar tatim në vlerën 8.360 lekë për qiratë e viteve 1995 - 1996. Nisur nga tatimi i paguar, i cili është 10% e vlerës së qirasë, rezulton se shuma e përfituar nga qiraja për vitet 1995 - 1996 është 83.600 lekë.

**46.28.3.** Në lidhje me këtë kontratë qiraje, mbetet e paqartë: (i) nëse kontrata e qirasë ka si objekt pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Durrës; (ii) në çfarë shume kanë qenë investimet e kryera nga qiramarrësja, të cilat do të mbaheshin nga qiraja në shumën 5.000 lekë/muaj, të përcaktuar në kushtet e kontratës; (iii) cila është kohëzgjatja faktike e kësaj kontrate; (iv) nëse është paguar tatimi në burim për shumën 1.020.000 lekë, sikurse është deklaruar nga subjekti.

**46.28.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente në lidhje me këto paqartësi. Në parashtrimet e tij, subjekti nuk ka dhënë sqarime lidhur me këto paqartësi.

**46.28.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga kontrata me PF “Sh. S.” janë përfshirë në analizën financiare të subjektit vetëm për vitet 1995 - 1996, derisa është provuar pagesa e tatimit në burim vetëm për këto dy vite.

**46.29. Kontratë nga viti 1997 deri në vitin 2002**<sup>109</sup>, e deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 4, midis shtetasit A. P. dhe një palë të “paidentifikuar”, me një çmim prej 30.000 lekësh/muaj, për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në Rrugën e D., Durrës.

**46.29.1.** Bashkëlidhur këtij pyetësori, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë, lëshuar në datën 3.12.2016, të kësaj pasurie dyqan me sip. 60 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZVRPP-në Durrës në datën 25.11.2012, në pronësi të motrës së tij A. P. Sipas subjektit vlera e përfituar nga kjo qira është në shumën 1.490.400 lekë dhe se sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2021, nga DRT-ja Durrës, vënë në dispozicion nga subjekti me pyetësorin 3 shtesë<sup>110</sup>, babai i tij ka paguar tatim në vlerën 165.600 lekë për periudhën 1997 – 2000.

**46.29.2.** Të njëjtin informacion Komisioni ka marrë nga DRT-ja Durrës për pagesën e tatimit nga babai i subjektit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2022. Nisur nga tatimi i paguar, i cili është 10% e vlerës së qirasë, rezulton se shuma *bruto* e përfituar nga qiraja është 1.656.000 lekë ose vlera *neto* 1.490.400 lekë, sikurse deklaruar nga subjekti.

Vitet	1997	1998	1999	2000	2001	2002	Total
Qiraja (lekë)	36 000	180 000	360 000	360 000	360 000	360 000	<b>1 656 000</b>
Tatimi i paguar <sup>111</sup>	3 600	18 000	36 000	36 000	36 000	36 000	<b>165 600</b>

<sup>108</sup>Shihni rreshtin nr. 25, tek tabela e kontratave dhe f. 48-49 të pyetësorit nr. 4.

<sup>109</sup>Shihni rreshtin nr. 26, në tabelën e pyetësorit nr. 4.

<sup>111</sup>Deri në vitin 2014, tatimi në burim është në masën 10% mbi qiranë e përfituar dhe në vitin 2015 bëhet 15%.

**46.29.3.** Mbetet e paqartë se cila është pala qiramarrëse dhe nëse bëhet fjalë për këtë pasuri apo jo, pasi nuk kemi një kontratë që të provojë marrëdhënien e qiramarrjes.

**46.29.4.** Në përfundim të hetimit administrativ, derisa: (i) është vërtetuar që këto pagesa përfaqësojnë tatim mbi qiranë dhe janë kryer nga babai i subjektit; (ii) pagesat e tatimeve janë kryer në kohë reale<sup>112</sup>; (iii) koha e vjeljes së qirave ka qenë shumë kohë përpara se subjekti të emërohej si prokuror (madje edhe OPGJ) dhe, për këto arsye, pavarësisht se subjekti nuk ka mundur të sigurojë kontratën apo kontratat e qirasë, vlerat *neto* të qirave për të cilat janë paguar tatime nga babai i tij janë përfshirë në analizën financiare për vitet 1997 – 2002.

**46.29.5.** Të ardhurat *neto* nga qiraja për vitet 1997 – 2002 janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, sipas viteve të treguara në tabelë, pasi është provuar pagesa e tatimit në burim.

**46.30. Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 14.3.2012<sup>113</sup>**, për objektin ambient shërbimi me sip. 95 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati i parë, Durrës. Regj. hipot. \*\*\*, datë 7.6.1995, nga data 1.4.2012 deri më 1.4.2013. Vlera e qirasë: 34.000 lekë/muaj. Pagesa kryhet në formë paradhënieje çdo 3 muaj, të lidhur mes palës qiradhënëse S. K. dhe palës qiramarrëse “\*\*\*\*” sh.a. Në kontratë është parashikuar që pagesa e tatimit të kryhet nga qiramarrësi.

**46.30.1.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 shtesë<sup>114</sup>, subjekti paraqiti: (i) një pjesë të ekstraktit historik nga QKR-ja për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., në të cilin evidentohet se në datën 30.4.2012 është deklaruar dhe në datën 2.5.2012 është shtuar në QKR si adresë e subjektit tregtar: Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati i \*\*\*-rë, Durrës; (ii) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, e DRT-së Tiranë, sipas së cilës shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. ka paguar tatim mbi qiranë për vitet 2012 - 2016, por nuk janë të specifikuara vlerat e paguara për secilën adresë që ka ushtruar aktivitet ky subjekt.

**46.30.2.** Nga verifikimi i faqes *online* të shoqërisë u evidentua se kjo adresë është hequr në datën 4.1.2019, gjë e cila vërteton se kjo shoqëri ka ushtruar aktivitetin e saj në këtë njësi maksimalisht deri në fund të dhjetorit të vitit 2018.

**46.30.3.** Në pyetësorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se kjo kontratë i takon pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe adresa e deklaruar është rruga “\*\*\*\*”, godina \*\*\*, Durrës. Subjekti ka paraqitur disa dokumente, që provojnë bashkëpronësinë e tij mbi pasurinë njësi me sip. 95.33 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZVRPP-në Durrës në datën 10.2.2016, ku ai zotëron 3/9 pjesë takuese.

**46.30.4.** Të ardhurat e përfituara nga kjo qira janë treguar në tabelën më poshtë dhe subjektit i takon 1/3 e tyre.

Vitet	2 012	2 013	2 014	2 015	2 016	Total
Qiraja në lekë	306 000	408 000	408 000	408 000	408 000	<b>1 938 000</b>
Tatimi për t’u paguar	30 600	40 800	40 800	61 200	61 200	<b>234 600</b>

**46.30.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur nuk është provuar: (i) cila është vlera *neto* e kontratës dhe e përfituar nga subjekti; (ii) nuk është provuar shuma specifike e tatimit në burim të paguar nga shoqëria, pjesa takuese e subjektit nga të ardhurat e përfituara nga kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., nuk është përfshirë në analizën financiare të tij.

**46.30.6.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe të provojë nëse bëhet fjalë për të njëjtën pronë për shkak të mospërputhjes së adresave në

<sup>111</sup>Deri në vitin 2014, tatimi në burim është në masën 10% mbi qiranë e përfituar dhe në vitin 2015 bëhet 15%.

<sup>112</sup>Këto pagesa i takojnë qirave të viteve 1997 - 2000 dhe nisur nga shumat e paguara të këtyre tatimeve, sikurse informohen nga shkresa e DRT-së Durrës, tatimet janë paguar të plota dhe pa gjoba, çka tregon se ato janë paguar në kohë reale.

<sup>113</sup>Shihni dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 3 shtesë.

<sup>114</sup>Shihni dokumentin në f. 67-72 të pyetësorit nr. 3, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022.

kontratën e qirasë dhe asaj të deklaruar në pyetësin nr. 4, si dhe sqarime të mëtejshme e dokumente në lidhje me konstatimin në pikën 30.4.

**46.30.7.** Në parashtrimet e tij lidhur me mospërputhjen e adresave, subjekti ka deklaruar se kjo njësi me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\* është pjesë e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, që përfshin dy godina, përkatësisht pallatin \*\*\* dhe \*\*\*, të cilat janë ngjitur dhe në vazhdim të njëra-tjetrës, të ndodhura në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati i \*\*\*, Durrës. Nga perëndimi kjo pasuri kufizohet nga rrugën “\*\*\*\*”, e cila më parë është quajtur rruga “\*\*\*\*”, që është në vijim të rrugës “\*\*\*\*”.

Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti ka informuar se në vitin 2012 bashkëpronarët, bazuar në mirëkuptimin e palëve, qiranë e ambientit njësi me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 95.33 m<sup>2</sup> (ish-lokal “\*\*\*\*”), ambient për të cilin është lidhur kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., kanë vendosur që qiranë e këtij lokali ta marrin të plotë trashëgimlënësit e tij dhe në vijim deri aktualisht vetë subjekti, duke mos marrë nga viti 2012 qira për ambientet e tjera të përbashkëta. Sipas tij, sipërfaqja e këtij ambienti njësi rreth 95 m<sup>2</sup> është gati sa 1/3 e sipërfaqes së ambienteve njësi të përbashkëta që kanë trashëgimtarët e M. K. të përfituara sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 10.3.1994, të KKP-së (dyqanet tek pallatet \*\*\* dhe \*\*\*), rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), si dhe ambient lokal ndodhur në pallatin \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ish-Zyra e \*\*\*. Sipas tij, marrja e plotë e vlerës së qirasë lidhur me këtë kontratë qiramarrjeje është deklaruar si në DPV-në 2016, kur ka ndërruar jetë babai i tij (pasi deri në atë moment e merrte ai), ashtu edhe në shpjegimet e tij pranë ILDKPKI-së në korrik të vitit 2016, ku citohet se: *“Po paraqes edhe një kontratë tjetër qiraje për dyqanin tek pallati i quajtur ‘\*\*\*’, datë 14.3.2012, ku qiradhënës figuron djali i dajës S. K., por unë përfitoj 100%, pasi pjesa ime takuese, zotëruese tek grupi i dyqaneve rreth 270 m<sup>2</sup>, është 1/3, pra rreth 95 m<sup>2</sup>. Paguesa mujore që përfitoj është 34.000 lekë”*. Njëkohësisht, së bashku me dokumentacionin tjetër është dorëzuar në këto shpjegime edhe foto të njësisë përkatëse ku zhvillonte aktivitetin subjekti “\*\*\*\*”.

Më tej, subjekti ka sqaruar se në po këtë ambient, pas largimit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., për shkak të mbylljes së lojërave të fatit, është lidhur kontratë me PF Th. K., me kontratë nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, mes Arian Përmeti dhe Th. K., kontratë e cila vazhdon akoma dhe derdhja e vlerës së kësaj qiraje bëhet në llogarinë e tij në lekë me nr. \*\*\*, në “Intesa Sanpaolo Bank”. Ndërsa shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. e derdhte qiranë në llogarinë bankare nr. \*\*\*, të shtetasit S. K., në “Raiffeisen Bank”. Bazuar në këtë kontratë qiradhënieje për periudhën 1.4.2012 – 31.12.2016 është përfituar në vlerë *neto* shuma 1.703.400lekë. Në konkluzion të parashtrimeve të tij, në kushtet kur provohet: (i) vlera *neto* e kontratës e përfituar nëpërmjet bankës dhe është provuar shuma e tatimit në burim e paguar nga shoqëria; si dhe (ii) nga prilli i vitit 2012 e në vijim e gjithë vlera e kësaj qiraje është përfituar nga familja e tij, subjekti i kërkon Komisionit përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të përfituara *neto* deri në vitin 2016 nga kjo qiradhënie në shumën totale 1.703.400 lekë.

Për të mbështetur pretendimet e tij sa më sipër, subjekti ka paraqitur: deklaratë noteriale nr.\*\*\*, datë 18.7.2022, në të cilën bashkëpronarët S. K., E. H. (K.) dhe O. N. (K.), si përfaqësuese e shtetasit A. K., në të cilën deklarojnë se nga viti 2012 ambienti në të cilin është lidhur kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., qiranë e ka marrë të plotë z. Arian Përmeti dhe trashëgimlënësit e tij; kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 14.3.2012, nxjerrë nga arkivi noterial + vërtetimi hipotekor, ku cilësohet se në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 7.6.1995, janë të regjistruara pronat në pronësi të shtetasit S. K., ku në disa prona është në bashkëpronësi; *statement* bankar të llogarisë nr. \*\*\*, në “Raiffeisen Bank” të shtetasit S. K., në të cilën pasqyrohet derdhja e vlerës *neto* të qirasë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën 6. 4.2012 – 31.12.2016, e në vijim.

**46.30.8.** Nga analiza e parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura konstatohet se si qiradhënës, në cilësinë e pronarit, shfaqet shtetasi S. K. Pavarësisht se subjekti ka paraqitur



një vërtetim nga dokumenti hipotekor dhe hartë treguese të pasurisë, nuk evidentohet qartë cila është pasuria objekt qiraje.

Nisur nga sa më sipër, subjekti ka provuar se në llogarinë bankare të shtetasit S. K. në “Raiffeisen Bank” është derdhur vlera *neto* e qirasë prej 30.600 lekësh/muaj, pasi është zhveshur nga tatimi. Ndërsa, sa i takon pretendimit se subjekti ka përfituar 100% të vlerës së qirasë, ajo nuk është provuar me dokument të kohës, por mbetet në nivel deklarativ dhe për këtë arsye pjesa takuese e qirasë prej 1/3 do të përfshihet në analizën financiare të rishikuar, sikurse treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2 012	2 013	2 014	2 015	2 016	Total
Qiraja në lekë	91 000	122 400	122 400	122 400	122 400	<b>580 600</b>

### Kontrata të tjera të deklaruara nga subjekti

47. Në përgjigje të pyetëorit nr. 4, subjekti ka deklaruar ekzistencën e kontratave të tjera për periudhën 1994 – 31.12.2011, që kanë të bëjnë me pasuritë nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, të gjitha njësi të ndodhura në z. k. \*\*\*, me adresë: rruga “\*\*\*\*” godina \*\*\*, Durrës; si dhe për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*\*, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës. Për të gjitha këto pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion kopje të certifikatave të pronësisë, nga të cilat rezulton se është bërë pronar i tyre me 3/9 pjesë takuese nga data 10.2.2016.

Në përgjigje të këtij pyetëtori, subjekti ka përshkruar palët në këto marrëdhënie qiraje dhe, konkretisht, në cilësinë e palës qiradhënëse S. K., A. K. dhe M. P.. Ndërsa, në cilësinë e palës qiramarrëse, subjekti ka listuar disa shtetas, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022<sup>115</sup>, sipas së cilës të DRT-ja Durrës e informon për tatimin mbi të ardhurat nga qiraja të paguar nga shtetasit qiramarrës për të cilët ka pyetur subjekti. Bazuar në këto të dhëna është përllogaritur edhe vlera e qirasë për çdo qiramarrës. Sipas subjektit shuma e qirasë e përfituar nga dhënia me qira e këtyre pronave, për të tre bashkëpronarët, ka qenë 12.214.377 lekë dhe pjesa takuese e shtetasit M. P. 1/3 ose 4.071.459 lekë. Konkretisht, referuar informacionit të DRT-së Durrës, rezulton si vijon:

47.1. Për palën qiradhënëse, shtetasit A. K. dhe S. K., janë kryer pagesat e tatimit mbi qiratë, pasqyruar në tabelën vijuese.

A. K.	Tatimi i paguar	Vlera e përllogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja <i>neto</i> e përllogaritur (lekë)
Prill – qershor 1996	20 000	200 000	180 000
1998	72 000	720 000	648 000
1999	45 000	450 000	405 000
2000	57 600	576 000	518 400
2001	51 600	516 000	464 400
2002	45 600	456 000	410 400
2009	108 000	1 080 000	972 000
2010	60 000	600 000	540 000
<b>Totali</b>	<b>459 800</b>	<b>4 598 000</b>	<b>4 138 200</b>

S. K.	Tatimi i paguar	Vlera e përllogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja <i>neto</i> e përllogaritur (lekë)
1999	65 000	650 000	585 000
2000	124 000	1 240 000	1 116 000

<sup>115</sup>Shihni f. 54-74 të dokumenteve bashkëlidhur pyetëorit nr. 4.

2001	138 000	1 380 000	1 242 000
2002	140 000	1 400 000	1 260 000
2005	12 000	120 000	108 000
2007	12 000	120 000	108 000
2008	12 000	120 000	108 000
2011	12 000	120 000	108 000
2012	12 000	120 000	108 000
<b>Totali</b>	<b>527 000</b>	<b>5 270 000</b>	<b>4 743 000</b>

**47.1.1.** Kjo shkresë sqaron se pagesat e bëra nga qiradhënësit A. dhe S. K., nuk përcaktojnë cilat janë palët qiramarrëse, për cilin nga ambientet/pasuritë dhe për cilën nga kontratat janë bërë këto pagesa. Sa i takon periudhave për të cilat është vjelë qiraja, kjo shkresë nuk jep informacion, por sqaron se data/viti të cilit i takon qiraja është konsideruar ai vit kur është bërë pagesa.

**47.1.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur nuk ka kontrata, por nuk ka as prova dhe të dhëna të tjera direkte dhe indirekte që të lidhin të ardhurat nga qiratë, për të cilat është paguar tatimi në burim, me pasuritë ku subjekti (më parë nëna e tij) ka qenë/është bashkëpronar, atëherë nuk mund të arrihet në konkluzionin që subjekti dhe/ose familja e tij kanë përfituar pjesë nga këto të ardhura. Për këtë arsye, në analizën financiare nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja për vitet kur janë përfituar vlerat e treguara në tabelat e mësipërme.

**47.1.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime të mëtejshme dhe dokumente në lidhje me këtë rezultat.

**47.1.4.** Në parashtrimet e tij, së pari, subjekti ka dhënë informacion mbi pronat e përbashkëta të trashëgimtarëve të shtetasve M. e H. K., kthyer me VKKP-në nr. \*\*\*, datë 10.3.1994<sup>116</sup>, të cilat janë pjesëtuar vullnetarisht mes tyre<sup>117</sup> dhe janë regjistruar në ZVRPP-në Durrës. Sipas subjektit, këto prona janë dhënë në vazhdimësi me qira dhe deri në vitin 2011 qiraja është

<sup>116</sup>Një godinë, me 9 dyqane dhe 12 apartamente, e ndodhur në Durrës, rr. “\*\*\*\*”, godina \*\*\*, kufizuar në lindje me Drejtorinë e H.; një ndërtesë ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, me kufi veri pallati i vëllezërve K., jug rrugë, perëndim rr. “\*\*\*\*”, lindje trualli i vet; një sipërfaqe 1.000 m<sup>2</sup>, mbi të cilin janë ndërtuar këto dy godina; një sipërfaqe 350 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është ndërtuar një shtëpi 3-katëshe (godina 60) me kufizime veri Rruga e \*\*\* (rrugica përballë gjykatës), jug T. T., perëndim rrugicë, lindje rr. “\*\*\*\*”, etj.

<sup>117</sup>Pjesëtimi vullnetar (midis trashëgimtarëve të M. K. e H. K.) vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*, datë 3.10.1994, regjistruar në hipotekë me nr. regjistrimi \*\*\*, datë 8.11.1994; pjesëtimi vullnetar (midis trashëgimtarëve të M.K.) vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*, datë 16.5.1995, regjistruar në hipotekë për shtetasen M. P., me nr. regjistrimi \*\*\*, datë 7.6.1995; vërtetim dokumenti hipotekor për regjistrimin hipotekor për shtetasin S. K., me nr. regjistrimi \*\*\*, datë 7.6.1995; vërtetim dokumenti hipotekor për regjistrimin hipotekor për shtetasen M. P., me nr. regjistrimi \*\*\*, datë 7.6.1995. Sipas këtyre akteve: në godinën \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ndërmjet të tjerash trashëgimtarët e shtetasit M. K. marrin edhe ½ e dyqanit në rrugicë (ish-zyrën e frontit); në godinat \*\*\* dhe \*\*\*, që janë në vazhdim të njëra-tjetrës, trashëgimtarët e M. K. marrin ½ e dyqaneve të katit të parë dhe ndërmjet tyre edhe dyqanin në anën e majtë të shkallës së rrugës kryesore (ish-klub \*\*\*); në pallatin nr. \*\*\* është lënë i përbashkët dyqani në rrugicën majtas (ish-zyra e \*\*\*, me sip. 18 m<sup>2</sup>); në pallatin nr. \*\*\* janë lënë të përbashkëta ambientet e katit përdhe (dyqanet gjithë pjesa takuese e trashëgimtarëve të M. K.), nga muri ndarës i djathtë deri tek shkalla para dyqanit që rregullon bobina plus dyqanin e bukës. Të dy dyqanet janë të përbashkëta (njësitë \*\*\* dhe \*\*\*); në pallatin nr. \*\*\* janë lënë të përbashkëta dyqanet: në anën e majtë të shkallës së rrugës kryesore (dyqani që ka pasur Drejtorinë e \*\*\*), ish-klubi \*\*\* që vazhdon deri në rrugicën që shkon për tek Drejtorinë e \*\*\*, në kufi me dyqanin me sip. 50 m<sup>2</sup> të trashëgimtarëve të shtetasit H. K. Të tria lokalet janë të përbashkëta (njësitë \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*).

Prona të ndodhura në pallatin \*\* dhe \*\*\* (pallati \*\*\*), në rrugën “\*\*\*\*” (aktualisht rruga “\*\*\*\*”), si vijon: njësi \*\*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 33.20 m<sup>2</sup>; njësi \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*, sip. 95.33 m<sup>2</sup>; njësi \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 44.68 m<sup>2</sup>; njësi \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 20.30 m<sup>2</sup>; njësi \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 66 m<sup>2</sup> (e ndarë në dy dyqane, përkatësisht rreth 39 m<sup>2</sup> dhe 27 m<sup>2</sup>).

Pronë e përbashkët e ndodhur në pallatin nr. \*\*\* (pallati në krah të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës), rruga “\*\*\*\*”, Durrës, është: njësi \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 18 m<sup>2</sup>.

ndarë në 3 pjesë të barabarta për shtetasit A. K., M. P. dhe trashëgimtarëve të shtetasit P. K. me nga 1/3. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: (i) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, ku deklaruesit sqarojnë se *pronat në bashkëpronësi janë dhënë në vazhdimësi me qira dhe deri në vitin 2011 qiraja është ndarë në 3 pjesë të barabarta për A.K. 1/3, për M. P. (nëna e subjektit) 1/3 dhe trashëgimtarëve të P. K. 1/3 (Sh. K., S. K., E. H.), emrat e qiramarrësve për secilën pronë në bashkëpronësi për periudhën e mësipërme; pagesën e tatimit mbi qiranë për secilën qiramarrje; (ii) foto aktuale të pronave të përbashkëta të përmendura më sipër, 7 fletë të printuara.*

Së dyti, në lidhje me të ardhurat nga qiraja dhe pagesën e detyrimit tatimor, subjekti ka informuar se këto prona gjatë kësaj periudhe janë dhënë me qira nga përfaqësuesit e bashkëpronarëve A. K. e S. K., të cilët qiranë e marrë e ndanin në mënyrë të barabartë për bashkëpronarët sipas pjesës takuese, duke bërë njëkohësisht edhe pagesat për tatimet në burim. Sipas tij, deri në vitin 2003 pagesa për tatimin në burim kur është bërë nga qiradhënësit, bashkëpronarët M. P., S. K., A. K. etj., është bërë duke shënuar emrin e aktivitetit që zhvillohej në këtë ambient dhe jo në emër të qiramarrësit. Ndërsa për pagesat nga viti 2003 e në vijim pagesa e tatimit në burim për njësitë e bëra nga qiradhënësit është bërë duke shënuar emrin e qiramarrësit dhe jo më aktivitetin e tij. Sipas tij, qiraja për këto ambiente është marrë nga nëna e tij si pjesëtare në pronësi, duke marrë njëkohësisht 1/3 e qirave deri në vitin 2011 (pasi pas vitit 2011 është marrë e plotë qiraja nga familjarët e tij për njësinë nr. \*\*\*, ku ka zhvilluar aktivitetin subjekti “\*\*\*\*”).

**47.1.5.** Nga analiza e parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura, konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumente të reja të cilat mund të krijojnë lidhjen midis marrëdhënies kontraktore – pronës objekt kontrate – dhe tatimeve të paguara nga shtetasit A. dhe S. K. dhe për këtë arsye mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të subjektit.

**47.2.** Për palën qiramarrëse, shtetasit S. R., M. R., S. K., A. H., I. H., K. B., Sh. T., I. T., A.D., O. V., R. L., A. L., B. M., M. K., L. V., H. D., X. B., A. Xh., E. X. etj., për të cilët subjekti ka kërkuar informacion mbi pagesat e tatimit mbi qiranë, DRT-ja Durrës ka përcjellë informacionin, si më poshtë vijon:

**47.2.1.** M. R., me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, me aktivitet “vetrata”.

M. R.	Tatimi i paguar	Vlera e përlllogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja neto e përlllogaritur (lekë)
2004	33 600	336 000	302 400
Qira 2004 dhe 2005	54 000	540 000	486 000
2006	18 000	180 000	162 000
2007	36 000	360 000	324 000
Qira 2007	36 000	360 000	324 000
Qira 2008	36 000	360 000	324 000
Qira 2009	36 000	360 000	324 000
Qira 2010	36 000	360 000	324 000
Qira 2011	36 000	360 000	324 000
<b>Total</b>	<b>321 600</b>	<b>3 216 000</b>	<b>2 894 400</b>

**47.2.2.** Në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, mbetet e paqartë se për cilën pronë/a është paguar qiraja dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë.

**47.2.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare të subjektit nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti “M. R.” ka paguar tatim në burim ndër vite.

**47.2.4.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se PF “M. R.” ka qenë qiramarrëse për pronën njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 44.68 m<sup>2</sup>, në periudhën 1998 – 2012, biznes familjar “prodhim vetratash”. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 14.7.2022, të deklaruës M. R., në të cilën deklaroi se: *“Është e regjistruar pranë zyrës së tatimeve Durrës si PF, objekt veprimtarie prodhim vetrata duralumin, nga viti 1998 e në vijim, së bashku me familjarët e saj, bashkëshortin S. R. dhe djali K. R., ka zhvilluar aktivitetet në pasurinë njësi nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, pronë e ndodhur në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, godina \*\*\*+\*\*\*, në të njëjtën godinë dhe ngjitur me lokal \*\*\* (para Institutit të \*\*\*) Durrës. Ambienti pronë e familjes K.: A. K., M. P., S. K. etj. Në këtë ambient aktualisht zhvillon aktivitetin ‘\*\*\*’ sh.p.k. Pagesa e qirasë për periudhën 1998 – 1999, 10.000 lekë/muaj; për periudhën 2000 – 2003 ka qenë në vlerën 28.000 lekë/muaj; për periudhën 2004 – 2012 ka qenë në vlerën 30.000 lekë/muaj. Pagesa e qirasë është bërë në total përfaqësuesit të familjes K., z. S. K. ose A. K. Pagesa e tatimit në burim është bërë nga qiradhënësit. Në ambientin ku kam zhvilluar aktivitetin për periudhën e mësipërme kisha të lidhur në emrin tim (M. R.) kontratën e energjisë elektrike me nr. \*\*\*, ndërsa kontrata e ujës-jellësit me nr. \*\*\*, ishte në emër të bashkëshortit tim S. R.”;*
- librezë e pagesës së energjisë nr. \*\*\*, në emër të shtetas M. R., në Lagjen Nr. \*\*\*;
- librezë uji nr. \*\*\*, në emër të shtetasit S. R.;
- kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 11.11.2021, ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasve Arian Përmeti, A. K., S. K. dhe E. H. (K.), për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol.\*\*\*, f. \*\*\*, në pronësi të bashkëpronarëve Arian Përmeti me 3/9 pjesë, A. K. me 3/9 pjesë dhe S.K., Sh. K. dhe E. H. (K.) me 1/9 pjesë;
- shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2022, nga OSHEE-ja + procesverbal i verifikimit në terren, datë 16.7.2022.

**47.2.5.** Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultojnë faktet, si vijojnë: (i) nga dokumentet e pronësisë është vërtetuar që subjekti është bashkëpronar me 3/9 ose 1/3 pjesë takuese në pasurinë e llojit “njësi”, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Durrës, Rr./L. \*\*\*, (aktualisht \*\*\*). Ndërkohë vërehet që në kartelat e pasurisë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* si adresë paraqitet Rr./L. \*\*\*; (ii) nga verifikimi i ekstraktit të PF M. R. në QKB, rezulton e regjistruar në vitin 2003, me aktivitet floktore. Vendi i aktivitetit: Lagjja Nr. \*\*\* Durrës, rr. “\*\*\*\*”, godinë private, kati i parë, përballë Parkut Sportiv. Nga ekstrakti historik evidentohet se kjo adresë aktuale është vendosur pasi më 17.5.2010 është hequr adresa Durrës, \*\*\*, L. \*\*\*; (iii) në procesverbalin e verifikimit në terren nga OSHEE-ja, që mban datën 16.7.2022, evidentohet fakti se kontrata e energjisë nr. \*\*\* e lidhur në adresën Lagjja Nr. \*\*\*, \*\*\*, figuron në emër të subjektit M. R. Aktualisht, kjo kontratë furnizon subjektin “\*\*\*\*”.

Nga sa më sipër, qoftë nga adresa në QKR, qoftë nga numri i kontratës i furnizimit të energjisë, duket se subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasja M. R. e kanë ushtruar aktivitetin e tyre respektiv në dyqanin me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Durrës, në bashkëpronësi të nënës së subjektit, me 3/9 pjesë.

Sa i takon kohës gjatë së cilës shtetasja M. R. ka ushtruar aktivitetet në këtë dyqan, janë këto *indicie*: (i) deklaratë noteriale korrik 2022, ku shtetasja M. R. deklaroi se ka pasur me qira këtë dyqan në vitet 1998 - 2012; (ii) nga ekstrakti historik i QKB-së, PF “M. R.” është regjistruar në vitin 2003; (iii) adresa e dyqanit në bashkëpronësi të nënës së subjektit ka qenë e regjistruar deri më 17.5.2010; (iv) pagesat e tatimeve për periudhën 2004 – 2011; është vlerësuar si e ardhur e ligjshme ato që nëna e subjektit ka përfituar qira për periudhën 2004 – fundprilli 2010, sikurse treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	Total
Pjesa e nënës në lekë	100 800	162 000	54 000	108 000	108 000	108 000	36 000	676 800

**47.3. L. Xh., me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, me aktivitet “përkthime”**

L. Xh.	Tatimi i paguar	Vlera e përlllogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja neto e përlllogaritur (lekë)
2003	11 000	110 000	99 000
2005	6 000	60 000	54 000
2007	12 000	120 000	108 000
Për qira 2007	12 000	120 000	108 000
Për qira 2008	12 000	120 000	108 000
Për qira 2009	12 000	120 000	108 000
<b>Total</b>	<b>65 000</b>	<b>650 000</b>	<b>585 000</b>

**47.3.1.** Në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, mbetet e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja, në cilën periudhë janë vjelë qiratë për të cilat janë paguar tatime në vitet 2003, 2005 dhe 2007, si dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë.

**47.3.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare të subjektit nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti “L. Xh.” ka paguar tatim në burim ndër vite.

**47.3.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë rezultat.

**47.3.4.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se PF “L. Xh.” i është dhënë me qira mujore 10.000 lekë/muaj prona e ndodhur në godinën 60, rruga “\*\*\*\*” (ish-Zyra e \*\*\*), njësi \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 18 m<sup>2</sup>, për periudhën mars 2000 e në vijim, me aktivitet “zyrë përkthimi”.

**47.3.5.** Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, për këtë qiradhënie nga viti 2000 e në vijim nga bashkëpronarët, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 13.7.2022, e deklaruës L. Xh., ku shprehet se *zhvillon aktivitetin si përkthyes me NIPT \*\*\*, nga marsi i vitit 2000 e në vijim, në pasurinë njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, pronë e ndodhur në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, që aktualisht ju përket bashkëpronarëve A. K., Arian Përmeti, S. K. e E. H. (K.). Për gjithë periudhën e qiramarrjes për ambientin e mësipërm ka paguar vlerën e qirasë prej 10.000 lekësh/muaj;*

- licencë nr. \*\*\*, datë 23.3.2000, për taksat në emër të L. Xh.;

- ekstrakt historik i datës 14.7.2022, në emër të L. Xh.;

- kontratë qiraje nr. \*\*\* datë 15.2.2001, lidhur mes z. S. K. dhe PF L. Xh., për lokal me sip. 18.5 m<sup>2</sup> në Lagjen Nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”. Tatimet i takojnë qiradhënësit;

- kontratë qiraje nr. \*\*\* datë 5.2.2003, lidhur mes S. K. dhe L. Xh., me objekt lokal me sip. 18.5 m<sup>2</sup>, në Lagjen Nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”. Tatimet i takojnë qiradhënësit;

- kontratë qiraje e thjeshtë datë 5.1.2005, mes S. K. dhe L. Xh., lokal me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”;

- kontratë e thjeshta qiraje e datave 10.1.2009, 15.2.2013, 5.1.2017 dhe 8.1.202 mes qiradhënësit S. K. dhe L. Xh., me objekt lokal me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;

- mandatpagesë tatim mbi qiranë, 9 copë, nga të cilat 2 mandatpagesa janë kryer nga shtetasi S. K. për dy 6-mujorët e vitit 2001, me përshkrimin “tatim mbi qira, 6M (i parë dhe dytë)

lokali zyrë përkthimi”, në shumën 6.000 lekë secilin mandat<sup>118</sup>. Kjo shumë përfaqëson tatimin për një vlerë qiraje prej 120.000 lekësh, nga të cilat nëna e subjektit përfiton 1/3 ose 40.000 lekë *bruto*;

- shkresa nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2022, e DRT-së Durrës;
- shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2022, e DRT-së Durrës;
- shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, e DRT-së Durrës, ku jepet informacion i pjesshëm për pagesat e znj. L. Xh.;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022.

**47.3.6.** Nga analiza përfundimtare e çështjes rezulton se subjekti ka provuar marrëdhënien e qirasë për vitet 2001 - 2020 (vetëm dy nga kontratat janë noteriale, të tjerat janë të thjeshta), mes qiradhënësit S. K. dhe L. Xh. për pasurinë objekt qiraje e llojit “njësi”, me nr. \*\*\*, ku subjekti është bashkëpronar me 3/9, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës. Nga verifikimi në ekstraktin e QKB-së L. Xh. rezulton PF, me status “aktiv”, që ushtron aktivitet si përkthyes, me adresë aktiviteti Durrës, rr. “\*\*\*\*”, L. \*\*\*, që përputhet me adresën e pasurisë objekt qiraje. Ka *indicie* që J. X. ushtron aktivitet në objektin në bashkëpronësi të subjektit.

Sa më sipër, është provuar: (i) ushtrimi i aktivitetit të personit fizik nga viti 2001 dhe në objektin në bashkëpronësi të nënës/më pas subjektit me 3/9 pjesë; (ii) pagesa e tatimeve për vitet 2001 – 2009, sikurse është treguar në tabelën më poshtë dhe për këtë arsye vlerat e qirasë të tatuara janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, sikurse treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2001	2003	2005	2007	2008	2009	Total
Pjesa e nënës 3/9 (lekë)	36 000	33 000	18 000	72 000	36 000	36 000	231 000

**47.4.** K. B., me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, ka paguar tatim në burim mbi qira në vitin 2004, në shumën 12.000 lekë. Nisur nga kjo shumë, vlera *bruto* e qirasë së përfituar është 120.000 lekë dhe vlera *neto* e saj 108.000 lekë.

**47.4.1.** Në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, mbetet e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë.

**47.4.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare të subjektit shuma 108.000 lekë nuk është përfshirë si e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti “K. B.” ka paguar tatim në burim në vitin 2004.

**47.4.3.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se për periudhën 2000 – 2002 shtetasi K.B. ka qenë qiramarrës për pronën njësi, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 33 m<sup>2</sup>, me aktivitet “shitje detergjentesh”. Ndërsa në periudhën 2003 – 2007, prona njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 20.30 m<sup>2</sup>, i është dhënë me qira 10.000 lekë/muaj, PF “K. B.” për shitje detergjentesh.

**47.4.4.** Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentet: mandatpagesë e tatimit mbi qiranë, 1 copë<sup>119</sup>, paguar nga S. K. në janar të vitit 2004, në shumën 12.000 lekë, me përshkrimin “tatim qiraje për vitin 2003 K. B.”, për K. B.; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2022, e DRT-së Durrës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, e DRT-së Durrës.

**47.4.5.** Nga parashtrimet dhe dokumentet e paraqitura rezulton se nuk është provuar marrëdhënia e qirasë dhe se nuk ka *indicie* të mjaftueshme që PF K. B. ka ushtruar aktivitet me qira në objektin njësi si më sipër në bashkëpronësi të subjektit. Në përfundim të procesit, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

<sup>118</sup>Shihni f. 213-214 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.

<sup>119</sup>Shihni f. 360 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.

**47.5.** I. T., me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, ka paguar tatim në burim mbi qira në vitin 2008, në shumën 7.553 lekë. Nisur nga kjo shumë, vlera *bruto* e qirasë së përfituar është 75.530 lekë dhe vlera *neto* e saj 67.977 lekë.

**47.5.1.** Në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, mbetet e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja, periudhën kur është përfituar kjo qira dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë.

**47.5.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare të subjektit shuma 67.977 lekë nuk është përfshirë si e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti “I. T.” ka paguar tatim në burim në vitin 2008.

**47.5.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë rezultat.

**47.5.4.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se për periudhën 2013 – 2016 prona njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 33.20 m<sup>2</sup>, i është dhënë me qira A. T. (Sh. T.) për aktivitet “fruta-perime”. Po kështu, ai ka informuar se për qiradhëniet pas vitit 2011 nuk kanë qenë objekt përfitimi qiraje nga ana e tij apo trashëgimlënësit e tij, kjo për arsye se është marrë e plotë vetëm për pasurinë nr. \*\*\*, me qiradhënës subjektin “\*\*\*\*”.

**47.5.5.** Ky pretendim i subjektit mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar me asnjë akt shkresor të kohës dhe, si i tillë, nuk është konsideruar nga Komisioni. Ndërkohë që çdo marrëdhënie e provuar qiraje, përfshirë edhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., është konsideruar në analizën financiare sipas pjesës takuese të subjektit dhe/ose prindërve të tij dhe jo sipas deklaramit të mësipërme të subjektit.

Ndërsa, sa i takon PF “I. T.”, nga verifikimi i ekstraktit të QKB-së rezulton i regjistruar me vit regjistrimi 2006, për ushtrim të aktivitetit “tregtim mobilie dhe artikuj industrialë”, në adresën Lagjja Nr. \*\*, rr. “\*\*\*\*”, objekt me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, pasuri e cila nuk rezulton në pronësi/bashkëpronësi të subjektit.

**47.5.6.** Në kushtet kur nuk u gjetën *indicie* të mjaftueshme që PF “I. T.” ka ushtruar aktivitet me qira në vitin 2008 në objektin në bashkëpronësi të subjektit, të ardhurat nga qiraja nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

**47.6.** E. X., me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, me objekt “pastrim kimik”

<b>E. X.</b>	<b>Tatimi i paguar</b>	<b>Vlera e përlogaritur e qirasë (lekë)</b>	<b>Qiraja neto e përlogaritur (lekë)</b>
2003	17 100	171 000	153 900
2004	9 600	96 000	86 400
2007	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2013 <sup>120</sup>	24 000	240 000	216 000
<b>Total</b>	<b>62 700</b>	<b>627 000</b>	<b>564 300</b>

**47.6.1.** Në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, mbetet e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja, në cilën periudhë janë vjelë qiratë për të cilat janë paguar tatime në vitet 2003, 2005 dhe 2007, si dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë.

<sup>120</sup>Tatimi mbi qiranë është paguar në vitin 2014.

**47.6.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare të subjektit nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti “E. X.” ka paguar tatim në burim ndër vite.

**47.6.3.** Në parashtrimet e tij<sup>121</sup> subjekti ka informuar se pasuria nr. \*\*\*, e llojit “njësi”, me sip. 66 m<sup>2</sup> është e ndarë në dy dyqane, 27 m<sup>2</sup> dhe 39 m<sup>2</sup>. Në dyqanin me sip. 39 m<sup>2</sup> kanë ushtruar aktivitet pastrimi kimik shtetasi B. Xh. dhe E. X., nga viti 1998 deri në vitin 1999. Pas vitit 1999 shtetasi E. X. ka marrë aktivitetin dhe në vitin 2000 është regjistruar si person fizik më vete, i cili e vazhdon këtë aktivitet edhe aktualisht.

**47.6.4.** Subjekti ka paraqitur, së bashku me parashtrimet e tij, dokumentet si vijojnë:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.7.2022, e deklaruesit E. X., ku shprehet se: “*Është regjistruar pranë zyrës së tatimeve Durrës PF me NIPT \*\*\*, objekt veprimtarie pastrim kimik dhe lavanderi. Ka zhvilluar aktivitet nga viti 1998 e në vijim pa ndërprerje në një ambient 39 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë nr. \*\*\*, volumi \*\*\*, faqe \*\*\*, z. k. \*\*\*, pronë e ndodhur në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*\*’, godina \*\*\*\*+\*\*\*\* (pallati që njihet me emrin lokal \*\*\*) Durrës. Ambienti pronë e familjes K.: A. K., M. P., S. K. etj.*”;
- pagesë e qirasë për periudhën deri në vitin 2009, në vlerën 10.000 lekë/muaj, për periudhën 2010 e në vijim në vlerën 20 000 lekë/muaj;
- certifikatë pronësie nr. \*\*\*;
- mandatpagesë e tatimit mbi qiranë, 4 copë, nga të cilët 2 janë të dhëna të reja dhe konkretisht: (i) mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 20.4.2001, i BKT-së, është arkëtim i kryer nga shtetasi S. K. në vlerën 6.000 lekë, me përshkrimin “tatim mbi qiranë 6M 1-rë V.2001, lokali për pastrim kimik”; (ii) mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 18.10.2001, i BKT-së, është arkëtim i kryer nga shtetasi S. K. në vlerën 6.000 lekë, me përshkrimin “tatim mbi qiranë 6M 1-2të V.2001, lokali për pastrim kimik”;
- vërtetim i tatim-taksave;
- certifikatë regjistrimi në organin tatimor, me datë regjistrimi 29.2.2000;
- ekstrakt historik sipas QKR-së;
- vendim nr. \*\*\* i vitit 2000, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për regjistrimin si person fizik;
- kontratë qiraje e viteve: 2000, me afat 3-vjeçar, me vlerë 10.000 lekë/muaj; 2010 me afat 3-vjeçar, me vlerë 20.000 lekë/muaj (të dyja kontrata të thjeshta, jo noteriale); 2017, 2018, 2020 me vërtetim njësimi me origjinalin;
- shkresë nr. \*\*\*prot., datë 9.3.2022, e DRT-së Durrës (dorëzuar në përgjigje të pyetësorit 4, datë 23.3.2022, faqe 54-56);
- shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2022, e DRT-së Durrës (dorëzuar bashkëlidhur në dokumentacionin për qiradhëniet e mësipërme);
- shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2022, e DRT-së Durrës;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022 (dorëzuar bashkëlidhur në dokumentacionin për qiradhëniet e mësipërme).

**47.6.5.** Nga dokumentacioni i ASHK-së është vërtetuar pronësia e subjektit me pjesë takuese 3/9, në pasurinë nr. \*\*\*, e llojit “njësi” me sip. 66 m<sup>2</sup>, me adresë Durrës, rruga “\*\*\*\*”, ndërtesa \*\*\*, por nuk provohet marrëdhënia e qirasë me objekt këtë pasuri.

Nga verifikimi i ekstraktit të QKB-së rezulton i regjistruar PF “E. X.”, për ushtrim aktiviteti “pastrim kimik dhe lavanderi”, ku vendi i ushtrimit të aktivitetit është *Durrës, L. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, ndërtesë \*\*\*-katëshe, 100 m larg tatim-taksave*, adresë e cila është ndryshuar dy herë brenda marsit të vitit 2010, duke u bërë përsëri siç ka qenë *Durrës, L. \*\*\* rr. “\*\*\*\*”, ndërtesë \*\*\*-katëshe, 100 m larg tatim-taksave*. Sipas këtyre informacioneve duket se ka një përafërsi

<sup>121</sup>Për këtë marrëdhënie, shihni f. 381-388 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.



midis adresës së pronës dhe adresës së deklaruar në QKB, por megjithatë nuk mund të thuhet me siguri që ky aktivitet është ushtruar në pronën në bashkëpronësi të subjektit.

Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë: (i) ushtrimin e aktivitetit të PF nga viti 2000 dhe në një objekt me adresë të përafërt me atë të objektit në bashkëpronësi të nënës e pastaj subjektit me 3/9 pjesë takuese; si dhe (ii) pagesën e tatimeve për disa vite, është vlerësuar që vlerat e qirasë sipas pjesës takuese për të cilat është paguar tatim, të përfshihen në analizën financiare të subjektit, sikurse është treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2001	2003	2004	2007	2013	Total
Qiraja në lekë sipas pjesës së nënës 3/9	36 000	51 300	28 800	36 000	72 000	<b>224 100</b>

#### 47.7. B. M., me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, me aktivitet “floklore”

B. M. <sup>122</sup>	Tatimi i paguar	Vlera e përlllogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja <i>neto</i> e përlllogaritur (lekë)
Paguar për qira 2007	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2008	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2009	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2010	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2011	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2012	12 000	120 000	108 000
<b>Total</b>	<b>72 000</b>	<b>720 000</b>	<b>648 000</b>

**47.7.1.** Në përfundim të hetimit administrativ, në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, duke qenë e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë, në analizën financiare të subjektit nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti B. M. ka paguar tatim në burim ndër vite.

**47.7.2.** Në parashtrimet e tij<sup>123</sup>, subjekti ka informuar se prona njësi me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 20.30 m<sup>2</sup>, i është dhënë me qira në periudhën 2007 – 2012, për aktivitet floklore, shtetases B. M., me vlerë qiraje 10.000 lekë/muaj. Vlera e qerasë *neto*, e përfituar nga kjo qiradhënie për të gjithë bashkëpronarët për këtë mandatpagesë, është 540.000 lekë se dhe nëna e tij nga kjo qiradhënie ka përfituar 1/3 e kësaj vlere qiraje *neto* prej 180.000 lekësh. Për këtë arsye, subjekti i kërkon Komisionit përfshirjen në analizën financiare të këtyre të ardhurave të përfituara *neto*.

**47.7.3.** Për të mbështetur pretendimet e tij, së bashku me parashtrimet, subjekti ka paraqitur: dy kontrata qiraje të datave 1.1.2010, 1.1.2011 dhe 1.1.2012; mandatpagesën e tatimit mbi qiranë, \*\*\* copë; shkresën nr. \*\*\*, të DRT-së Durrës (dorëzuar bashkëlidhur në dokumentacionin për qiradhëniet e mësipërme) dhe nr. \*\*\*, datë 8.8.2022, e cila tregon të njëjtat të dhëna si në tabelën më sipër, të pagesave të tatimit mbi qiranë nga B. M.; shkresën nr. \*\*\*, datë 9.3.2022, të DRT-së Durrës (dorëzuar në përgjigje të pyetësorit nr. 4, datë 23.3.2022).

**47.7.4.** Nga verifikimi i kontratave të qirasë të paraqitura nga subjekti vërehet se ato nuk janë noteriale (pra nuk vërtetohet që i përkasin periudhës së caktuar në to) dhe janë të pashoqëruara me vërtetimin e pronësisë së pronës objekt qiraje. Megjithatë, adresa e pasurisë objekt qiraje

<sup>122</sup>Tatimi në burim mbi qiranë, për të gjitha vitet, është paguar në vitin pasardhës.

<sup>123</sup>Për këtë marrëdhënie, shihni f. 361-369 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.

është “L. \*\*\*\*”, rr. ‘\*\*\*\*’, p. nr. \*\*\*\*”, duket e përafërt me adresën e pasurisë nr. \*\*\*\*, që është “Durrës, rr. ‘\*\*\*\*’, Nd. \*\*\*\*”.

Nga verifikimi ekstraktit të QKB-së rezulton e regjistruar në vitin 2006 PF B. M., aktualisht me status të çregjistruar. Në vitin 2015 ka ndryshuar adresa e ushtrimit të aktivitetit “Durrës, \*\*\*\*, L. \*\*\*\*, P. \*\*\*\*” dhe është vendosur një tjetër.

Në konkluzion, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë: (i) ekzistencën e disa *indicieve* mbi përputhshmërinë e adresës së pronës në bashkëpronësi të subjektit dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit të PF B. M.; (ii) ekzistencën e disa pagesa tatimesh në BKT nga S. K. për B. M., të cilat përputhen me informacionin nga tatimet, ka vlerësuar që vlerat e qirasë sipas pjesës takuese për të cilat është paguar tatim, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total
Pjesa e nënës 3/9 (lekë)	36 000	36 000	36 000	36 000	36 000	36 000	216 000

**47.8.** M. K., me NIPT \*\*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*\*, ka paguar tatim në burim mbi qiranë e periudhës shkurt – shtator 2014<sup>124</sup>, në shumën 4.000 lekë. Nisur nga kjo shumë, vlera *bruto* e qirasë së përfituar është 40.000 lekë dhe vlera *neto* e saj 36.000 lekë.

**47.8.1.** Në përfundim të hetimit administrativ, në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, duke qenë e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja, dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë /bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë, në analizën financiare të subjektit shuma 36.000 lekë nuk është përfshirë si e ardhur nga qiraja për vitin 2014, për të cilën subjekti “M. K.” ka paguar tatim në burim në vitin 2014.

**47.8.2.** Në parashtrimet e tij, subjekti informon se prona njësi me nr. pasurie \*\*\*\*, z. k. \*\*\*\*, me sip. 20.30 m<sup>2</sup>, i është dhënë me qira për vitin 2014 e në vijim shtetasit M. K., për agjenci imobiliare.

**47.8.3.** Nga verifikimi i QKB-së u evidentua se PF “M. K.” është regjistruar më 1.1.2003, për ushtrimin e aktivitetit “agjent, komisioner i pasurive të paluajtshme”, në adresën: Lagjia Nr. \*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ndërtesë dykatëshe, kati i \*\*\*\*, përballë \*\*\*\*. Kjo adresë është regjistruar në datën 13.3.2014 dhe vazhdon të jetë edhe sot. Në konkluzion, Komisioni vlerësoi të përfshijë në analizën financiare 1/3 e pjesës takuese të qirasë, për të cilën është paguar detyrimi tatimor ose vlera 12.000 lekë për vitin 2014.

**47.9.** F. Gj., me NIPT \*\*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*\*, ka paguar tatim në burim mbi qiranë për vitin 2006<sup>125</sup>, në shumën 60.000 lekë. Nisur nga kjo shumë, vlera *bruto* e qirasë së përfituar është 600.000 lekë dhe vlera *neto* e saj 540.000 lekë.

**47.9.1.** Në përfundim të hetimit administrativ, në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, duke qenë e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë /bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë, në analizën financiare të subjektit shuma 540.000 lekë nuk është përfshirë si e ardhur nga qiraja për vitin 2006, për të cilën subjekti “F. Gj.” ka paguar tatim në burim në vitin 2007.

**47.9.2.** Ky rezultat nuk ka ndryshuar as në analizën financiare përfundimtare.

**47.10.** A. D., me NIPT \*\*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*\*, me objekt “farmaci”

<sup>124</sup>Tatimi mbi qiranë është paguar në vitin 2014.

<sup>125</sup>Tatimi mbi qiranë është paguar në vitin 2007.

A. D. <sup>126</sup>	Tatimi i paguar	Vlera e përllogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja <i>neto</i> e përllogaritur (lekë)
2006	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2007	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2008	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2009	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2010	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2011	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2012	12 000	120 000	108 000
Paguar për qira 2013	48 000	480 000	432 000
Paguar për qira 2014	48 000	480 000	432 000
<b>Total</b>	<b>180 000</b>	<b>1 800 000</b>	<b>1 620 000</b>

**47.10.1.** Në përfundim të hetimit administrativ, në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, duke qenë e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë, në analizën financiare të subjektit nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti PF “A. D.” ka paguar tatim në burim ndër vite.

**47.10.2.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se prona njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 33.20 m<sup>2</sup> (e quajtur aneks \*\*\*), në periudhën 2016 – 2012 i është dhënë me qira PF “A. D.” për farmaci, vlera e qirasë 10.000 lekë/muaj. Sipas tij, vlera e qirasë *neto*, e përfituar nga kjo qiradhënie për të gjithë bashkëpronarët për periudhën 2006 – 31.12.2011 është 648.000 lekë dhe se nëna e tij nga kjo qiradhënie ka përfituar 1/3 e kësaj vlere *neto* prej 216.000 lekësh. Sa më sipër, subjekti i kërkoi Komisionit përfshirjen në analizën financiare të këtyre të ardhurave të përfituara *neto*.

**47.10.3.** Subjekti ka paraqitur dokumentet: deklaratë e deklarueses A. D., ku shprehet se: “Është e regjistruar pranë zyrës së tatimeve Durrës PF me NIPT \*\*\*, objekt veprimtarie farmaci, nga viti 2006 deri në 2012, ka zhvilluar aktivitet në pasurinë njësi nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, pronë e ndodhur në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*\*’, godina \*\*\* (në pallatin ku ndodhet dhe lokal \*\*\*) Durrës, që aktualisht ju përket bashkëpronarëve A. K., Arian Përmeti, S. K. e E. H. (K.). Për gjithë periudhën e qiramarrjes për ambientin e mësipërm kam paguar vlerën e qirasë prej 10.000 lekësh/muaj”; ekstrakt historik në emër të subjektit “A. D.”; vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 7.3.2006, për regjistrimin e personit fizik; certifikatë pronësie nr. \*\*\*; kërkesë për transaksion pranë BKT-së, datë 6.12.2011; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2022, e DRT-së Durrës.

**47.10.4.** Nga verifikimi në QKB është evidentuar se më 26.3.2013 është hequr adresa “Durrës, \*\*\* L. \*\*\*\*” dhe është vendosur “Lagjja Nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*\*’, kati i parë, pranë qendrës ‘\*\*’, çka tregon se deri në fund të vitit 2012 farmacia ka qenë në një adresë të përafërt me atë të njësisë në bashkëpronësi të subjektit, Lagjja Nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*\*’, godina \*\*\*. Në përfundim, Komisioni vlerëson që 1/3 e pjesës takuese të qirasë *neto*, për të cilën është paguar detyrimi tatimor, të përfshihet si e ardhur e ligjshme, sikurse treguar në tabelën vijuese.

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total
Pjesa e nënës (lekë)	36 000	36 000	36 000	36 000	36 000	36 000	36 000	<b>252 000</b>

<sup>126</sup>Tatimi mbi qiranë për vitet 2007 - 2014 është paguar brenda të njëjtit vit.

**47.11.** I. H. (mund të jetë i regjistruar me I. H.), me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*.

I. H. <sup>127</sup>	Tatimi i paguar	Vlera e përlogaritur e qirasë (lekë)	Qiraja <i>neto</i> e përlogaritur (lekë)
2004	49 000	490 000	441 000
2008	12 000	120 000	108 000

**47.11.1.** Në përfundim të hetimit administrativ, në mungesë të një kontrate qiraje, të provave ose të të dhënave të tjera direkte dhe indirekte, duke qenë e paqartë se për cilën pronë është paguar qiraja dhe nëse subjekti (ose nëna e tij) janë pronarë/bashkëpronarë dhe përfitues të vlerave të caktuara të qirasë, në analizën financiare të subjektit nuk është përfshirë asnjë e ardhur nga qiraja, për të cilën subjekti “I. H.” ka paguar tatim në burim ndër vite.

**47.11.2.** Ky rezultat nuk ka ndryshuar as në analizën financiare përfundimtare.

**47.12.** A. Xh. me kod fiskal \*\*\* dhe R. L. me NIPT \*\*\* dhe kod fiskal \*\*\*, nuk kanë pagesa tatimi për qira.

**47.12.1.** Në parashtrimet e tij subjekti nuk ka dhënë sqarime për qiramarrës me emrin A.Xh. Ndërsa në lidhje me shtetasin R. L., subjekti deklaroi se ka ndërruar jetë dhe informon se ky shtetas ka qenë qiramarrës për pronën njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 66 m<sup>2</sup> (e ndarë sipas tij në dy dyqane, përkatësisht 39 m<sup>2</sup> dhe 27 m<sup>2</sup>), konkretisht dyqanin 27 m<sup>2</sup>, për periudhën 1999 – 2002, për aktivitet pjesë këmbimi, për vitet 1999 - 2000 me 20.000 lekë/muaj dhe për vitet 2000 – 2002 me 10.000 lekë/muaj. Sipas tij, vlera e qirasë *neto*, e përfituar nga kjo qiradhënie për gjithë bashkëpronarët për periudhën 1999 – 2002, është 594.000 lekë dhe se nëna e tij nga kjo qiradhënie ka përfituar 1/3 e kësaj vlere qiraje *neto* prej 198.000 lekësh. Sa më sipër kërkon nga Komisioni përfshirjen në analizën financiare të këtyre të ardhurave të përfituara *neto*.

**47.12.2.** Për këtë qiradhënie subjekti ka paraqitur dokumentet, si vijojnë: mandatpagesë e tatimit mbi qiranë, 2 copë; certifikatë pronësie nr. \*\*\*; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.8.202, e DRT-së Durrës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, e DRT-së Durrës.

**47.12.3.** Nga verifikimi në faqen e QKB-së nuk u sigurua informacion. Nuk provohet që ky qiramarrës të ketë ushtruar aktivitet në objektin e marrë me qira në bashkëpronësi të subjektit.

**47.13.** S. R., K. R., S. ose S. K., D. Gj., A. H., I. H., E. B., Sh. T., A. T., E. V., A. L., I. B., loto sport L. V., K. H. dhe firma “\*\*\*\*”, nuk rezultojnë të regjistruar për aktivitete ekonomike.

**47.13.1.** Sa i takon marrëdhënies së qirave të pretenduara nga subjekti dhe të përshkruara në pikën 47 dhe gjithë nënçështjet e saj më sipër, në përgjigjen e datës 13.6.2022, subjekti ka përcjellë shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2022<sup>128</sup>, nga DRT-ja Durrës, e cila, në vijim të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, të përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 4, jep sqarime të mëtejshme në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pagesën e tatimit në burim, të paguar nga disa prej subjekteve tregtare, të cilat janë analizuar hollësisht në pikat më sipër. Sidoqoftë, përgjigjja e kësaj shkresë nuk sjell ndonjë provë apo të dhënë të re në lidhje me marrëdhëniet e qirave të pretenduara nga subjekti.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, subjekti ka bashkëlidhur edhe katër mandatpagesa bankare<sup>129</sup>, të cilat vërtetojnë pagesa të tatimit mbi qiranë, që janë kryer nga shtetasi S. K., për qira të

<sup>127</sup>Tatimi mbi qiranë për vitet 2004 dhe 2008 është paguar brenda të njëjtit vit.

<sup>128</sup>Shihni f. 65-66 të dokumenteve bashkëlidhur përgjigjes së datës 13.6.2022.

<sup>129</sup>Mandatarkëtimi datë 27.6.2007, nga “Raiffeisen Bank”, ku evidentohet se S. K. ka paguar tatim mbi të ardhurat nga qiraja për vitin 2006 në shumën 24.000 lekë për qiranë nga A. H.; mandatarkëtimi datë 21.10.2008, nga BKT-ja, ku evidentohet se S. K. derdh tatim mbi qiranë për vitet 2006 dhe 2007, në total në shumën 30.000 lekë, për qiranë nga M. Xh.; mandatarkëtimi datë 5.7.2011, nga BKT-ja, ku evidentohet se S. K. derdh tatim mbi

përfituara nga 3 subjekte tregtare gjatë viteve 2006, 2007, 2010 dhe 2011. Nga analiza e këtyre dokumenteve nuk mund të evidentohet se për pagesën e kujt qiraje bëhet fjalë dhe nëse subjekti i rivlerësimit është pronar ose bashkëpronar në objektin që është dhënë me qira.

**47.13.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, sa i takon marrëdhënies së qiradhënies dhe pagesave për tatimin në burim të informuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022<sup>130</sup> dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2022, nga DRT-ja Durrës, trajtuar hollësisht në çështjen 47 dhe nënçështjet e saj të këtij vendimi, subjekti nuk ka provuar marrëdhënien e qirasë, pasi nuk ka paraqitur kontratat përkatëse dhe as të dhëna të tjera që vërtetojnë objektin e kontratës (pra cilës pasuri i takon), palët në kontratë, periudhën kur është përfituar qiraja e marrë, nuk ka vërtetuar faktin që është pronar apo bashkëpronar i pasurisë e cila është dhënë me qira. Për rrjedhojë, në analizën financiare nuk janë konsideruar të ardhura të ligjshme nga qiratë e përfituara, sipas pretendimeve të subjektit.

**47.13.3.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se prona njësi me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 66 m<sup>2</sup> (e ndarë në dy dyqane 39 m<sup>2</sup> dhe 27 m<sup>2</sup>), njësia me sip. 27 m<sup>2</sup> iu është dhënë qiramarrësve, si vijojnë:

- PF “R. L.”<sup>131</sup> (ka ndërruar jetë) me NIPT \*\*\*, për periudhën 1999 – 2002 me 20.000 lekë/muaj dhe për periudhën 2001 – 2002 me 10.000 lekë/muaj për aktivitet pjesë këmbimi. Ai pretendon se për këtë qiradhënie nga viti 1999 e deri në vitin 2002 janë paguar tatimet në burim nga bashkëpronarët. Subjekti ka paraqitur dokumentet: mandatpagesë e tatimit mbi qiranë, 2 copë; certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*; deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2022, të DRT-së Durrës; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, të DRT-së Durrës.

**47.13.4.** Nga verifikimet në QKB evidentohet se ky person fizik ka qenë i regjistruar, por nuk mund të merren të dhëna të tjera, pasi paraqitet ky mesazh: “*Ju lutem paraqituni pranë zyrave të QKB-së për të plotësuar të dhënat e subjektit*”. Pavarësisht tatimit të paguar mbi qiranë për vitin 2001, vërtetuar me mandatpagesat e sjella nga subjekti, mbetet e paprovuar: (i) marrëdhënia e qirasë; (ii) lidhja midis person fizik dhe objektit në bashkëpronësi të subjektit dhe për këtë arsye pretendimet e subjektit nuk u morën në konsideratë.

- PF “L. V.” (përfaqësues i një kompanie loto sporti), për periudhën 2003 – 2007, vlera e qirasë 10.000 lekë/muaj, për aktivitet loto sporti. Ai informon se disponon vetëm një mandatpagesë të tatimit në burim të dokumentuar. Subjekti ka paraqitur dokumentet: mandatpagesë në arkën e “Raiffeisen Bank” në shumën 12.000 lekë, derdhur nga shtetasi S.K., me përshkrimin “L. V. tatim mbi të ardhurat nga qiraja për vitin 2006<sup>132</sup>”; shkresë nr.\*\*\* prot., datë 8.8.2022, e DRT-së Durrës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022, e DRT-së Durrës.

**47.13.5.** Pavarësisht tatimit të paguar mbi qiranë për vitin 2001, vërtetuar me mandatpagesën e sjellë nga subjekti, mbetet e paprovuar: (i) marrëdhënia e qirasë; (ii) nuk bëhet lidhja midis shtetasit L. V. dhe shoqërisë që ai përfaqëson; (iii) nuk bëhet lidhja midis personit fizik dhe objektit në bashkëpronësi të subjektit, dhe për këtë arsye pretendimet e subjektit nuk u morën në konsideratë.

- Për qiramarrësit H. D., për periudhën deri në vitin 2010, aktiviteti dyqan veshjesh dhe M.B., për periudhën deri në vitin 2013, aktiviteti dyqan veshjesh, subjekti informon se nuk disponon mandatpagesa të tatimit në burim të dokumentuar për këto periudha. Subjekti ka paraqitur: kontratë datë 1.1.2010, lidhur mes shtetasve S. K. dhe H. D., vlera e qerasë 10.000 lekë/muaj; kontratë datë 5.1.2013 lidhur mes shtetasve S. K. dhe M. B., vlera e qerasë 10.000 lekë/muaj.

---

qiranë për vitin 2010 shumën 12.000 lekë, për qiranë nga L. Xh.; mandatarkëtimi datë 3.7.2012, nga BKT-ja, ku evidentohet se S. K. derdh tatim mbi qiranë për vitin 2011 shumën 12.000 lekë për qiranë nga L. Xh.

<sup>130</sup>Shihni f. 54 të dokumenteve bashkëlidhur pyetësorit nr. 4.

<sup>131</sup>Për këtë marrëdhënie, shihni f. 370-374 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.

<sup>132</sup>Shihni f. 378 të dokumenteve bashkëlidhur parashtrimeve të datës 5.9.2022.

**47.13.6.** Në lidhje me burimin të ardhura nga qiratë, në analizën financiare në përfundim të hetimit administrativ, janë përfshirë ato të ardhura, për të cilat:

- i) është provuar me kontratë marrëdhënia e qirasë me qiradhënësit dhe pagesa e tatimit në burim për të ardhurat nga këto qira;
- ii) është evidentuar pagesa e qirave në rrugë bankare;
- iii) kur qiramarrës ka qenë një shoqëri tregtare, person fizik apo juridik dhe është provuar që subjekti ka përfituar vlerën *neto* të qirasë, ndërkohë që detyrimi për pagesën e tatimit në burim ka qenë i qiramarrësit.

Nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme ato për të cilat nuk është provuar marrëdhënia e qirasë me qiradhënësin, pagesa e tatimit në burim dhe përfitimi i vlerave *neto* të qirasë.

**47.13.7.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente në rastet e qirave që nuk janë paguar. Parashtrimet e dhëna janë paraqitur në secilën prej këtyre kontratave.

**48.** Për qiramarrësit individë apo subjekte, me të cilët subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontrata qiraje ose i ka ripërtërirë ato, u kryen verifikime mbi ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nga ku rezultoi se<sup>133</sup> subjekti gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës në këtë prokurori 2013 – 2022, nuk ka trajtuar çështje ku pjesëmarrës të kenë qenë këta shtetas.

#### **Deklarimi i bashkëshortes së subjektit, znj. A. P., në deklaratën *Vetting***

**49.** Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar *depozitë bankare në euro nr. \*\*\* në BKT. Burimi i krijimit: (i) kursime familjare; (ii) trashëgimi të lëna nga trashëgimlënësit e bashkëshortit; (iii) qira ambientesh. Shuma: 50.000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

**49.1.** Gjatë hetimit administrativ, BKT-ja<sup>134</sup> ka konfirmuar llogarinë në euro të shtetases A.A.P., e cila është çelur në datën 20.1.2017 dhe në të njëjtën datë është depozituar në *cash* shuma 50.000 euro.

**49.2.** Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i deklarimeve konstatohet se në DPV/2017 bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar këtë llogari me burimin nga gjendja *cash* familjare. Në të njëjtën rubrikë ajo ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vlerën 50.000 euro, me përshkrimin “nga gjendja *cash* familjare”. Gjithashtu, nga verifikimi i të gjitha deklaratave periodike vjetore të subjektit në lidhje me gjendjen *cash*, ka rezultuar se në fund të vitit 2016 subjekti ka pasur gjendje *cash* shumën 114.000 euro<sup>135</sup>, e cila është mbartur që nga periudha para fillimit të detyrës dhe e deklaruar në DPDF.

**49.3.** Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklarimi i bashkëshortes së subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të përcjellë nga BKT-ja, të administruar nga Komisioni.

**50.** Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Apartament banimi me sip. 94 m<sup>2</sup>, rr. ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*. Privatizuar nga E. K. B. Zotëroj 1/5*”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

**50.1.** Gjatë hetimit administrativ në lidhje me gjendjen juridike dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së<sup>136</sup> rezultoi se apartamenti me sip. 94.76 m<sup>2</sup> është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetases A. L. dhe familjarëve të saj, A., Sh., A., M. dhe D. L. Kjo pasuri është blerë prej tyre nga EKB Tiranë me kontratën e shitblerjes nr.\*\*\*, datë 28.5.1999, në çmimin 1.700.000 lekë dhe pas zbritjes vlere përfundimtare është 929.177

<sup>133</sup>Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në dosjen e Komisionit.

<sup>134</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., dhe nr. \*\*\* prot., të datës 8.11.2021, të BKT-së në dosjen e Komisionit.

<sup>135</sup>Shihni trajtimin e gjendjes *cash* tek pasuria nr. 47 e këtij relacioni.

<sup>136</sup>Shihni aktet në aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

lekë. Nga verifikimi i deklaramëve konstatohet se kjo pasuri është deklaruar saktësisht nga bashkëshortja e subjektit edhe në DPFDF-në e vitit 2013.

**50.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

**51.** Në informacionin e marrë nga FSHU-ja<sup>137</sup> referohet se me gjeneralitetet A. A. P. nuk rezultojnë të ketë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me OSHEE-në. Ndërsa me gjeneralitetet A. P. identifikohet një abonente me kontratën e furnizimit me Nr.\*\*\* në Tiranë, e cila nga detajet e klientit rezultojnë të jetë e lidhur në nënstacionin Kashar.

**51.1.** Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimet e kryera në sistemin e gjendjes civile rezultojnë shtetaset A. A. P., bashkëshorte e subjektit, dhe A. M. P. Nga verifikimi në sistemin e ASHK-së, shtetasja A. M. P. ka në pronësi një apartament në \*\*\*. Në këto kushte, nuk ka dyshime që kontrata e mësipërme të jetë në emër të bashkëshortes së subjektit.

### **Analizë financiare**

**52.** Në përfundim të hetimit administrativ, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare bazuar në provat e administruara.

**53.** Meqenëse subjekti ka deklaruar të njëjtat burime për të gjitha pasuritë e tij, analiza mbi mundësinë financiare të subjektit për krijimin e tyre është kryer sipas periudhës kur secila prej pasurive është krijuar, duke u bazuar në deklaratat periodike vjetore të subjektit. Analiza financiare e subjektit është ndarë në dy periudha: (i) para fillimit të detyrës, e cila shtrihet nga viti 1994 deri në datën 28.5.2013, kur subjekti është emëruar prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) periudha gjatë detyrës, e cila fillon në vitin 2013 me emërimin e subjektit si prokuror, deri në fund të vitit 2016.

### **Analizë financiare për periudhën para fillimit të detyrës**

**54.** Në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar këto pasuri: (i) Në datën 10.8.2008 është blerë me marrëveshje verbale automjet tip “Audi” në Itali, në vlerën 2.700 euro dhe në datën 28.9.2008 është kryer zhdoganimi në vlerën 309.221 lekë (kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting*); (ii) Llogari bankare në “Raiffeisen Bank”, çelur më 7.5.2008, gjendja 4.950 euro, burimi i krijimit kursime familjare; (iii) Llogari bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të babait A. P., shtuar në vitin 2013 Arian Përmeti si firmë e autorizuar. Gjendja: 100.000 lekë; (iv) Bono thesari në vlerën 9.500.000 lekë, me burim kursime familjare dhe lekë *cash* trashëguar nga nëna M. P.; (v) Gjendje *cash* në vlerat 2.700.000 lekë dhe 88.500 euro, burimi i krijimit kursime familjare dhe lekë *cash* trashëguar nga nëna M. P.

**55.** Meqenëse likuiditetet *cash* dhe në bankë krijuar para fillimit të detyrës, vijnë deri në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka kryer analizën financiare deri në datën 28.5.2013, për të verifikuar burimet e ligjshme të krijimit të tyre.

**56.** Në datën 28.5.2013, subjekti dhe familja e tij, përveç pasurive të paluajtshme të përfituara me trashëgimi ose nga kthimi i pronave të gjyshërve të subjektit, ka pasur likuiditete *cash* dhe në bankë, në vlerën 25.018.975 lekë. Kjo vlerë është mbartur, shtuar nga subjekti pas emërimit të detyrës dhe është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe për këtë arsye analiza mbi mundësinë e krijimit të tyre është e nevojshme.

**57.** Sipas kësaj analize, të kryer duke përdorur metodologjinë kumulative dhe të treguar në tabelën më poshtë, duket se subjekti dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë shumë likuiditetesh dhe për të kryer çdo shpenzim tjetër.

---

<sup>137</sup>Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

<i>Përshkrimi</i>	<i>1994 deri 28.05.2013</i>
<b>Pasuritë</b>	<b>26 060 789</b>
Autoveture Benz ***, *** blere 15.05.1999, c'regjistruar 7.3.2012	400 000
Autoveture Audi *** blere verbalsht 10.08.2008	332 593
Shpenzime doganore	309 221
Gjendja e likuiditeteve ne banka	25 018 975
<b>Të ardhurat</b>	<b>39 827 714</b>
Të ardhura nga paga subjekti nga 994	7 091 072
Takse solidariteti Subjekti	274 259
Nga Vendimi Gjyqesor Subjekti	362 620
Të ardhura nga paga b/shortja nga data e martësës 04.10.2001	6 993 145
Takse solidariteti B/shortja	28 625
Leje barrelindje B/shortja	281 652
Pensioni i babait	2 078 690
Pensioni i nënës	1 473 580
Perfituar nga kompensimi i pronave	1 466 417
Te ardhura nga Interesa bankare	466 824
Te ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan	200 000
Babai si i perndjekur politik per vitet 2010 dhe 2013	205 000
Te ardhura nga qirate e prindërve	18 905 830
<b>Shpenzimet</b>	<b>10 898 026</b>
Shpenzime jetike sipas perberjes familjare	9 385 981
Shpenzime mobilimi per ap.ku banon vete subjekti	600 000
Shpenzime mobilimi per ap.me qira P. C.	250 000
Shpenzime mobilimi	150 000
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	512 045
<b>Mundësia për Kursime</b>	<b>2 868 900</b>

58. Në këtë periudhë subjekti është analizuar bashkë me familjen e tij të origjinës, pasi megjithëse në gjendjen civile rezulton të jetë shkëputur prej tyre në vitin 2005, realisht ai ka banuar së bashku me prindërit e tij, deri në vdekjen e tyre. Në këtë analizë janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga viti 1994, të ardhurat e bashkëshortes pas datës së martësës së tyre 4.10.2001;
- pensioni i dy prindërve të tij nga 1 janari i vitit 1994;
- të ardhurat nga qiratë e përfituara prej tyre<sup>138</sup>, për të cilat: (i) është provuar pagesa e tatimit në burim; ose (ii) në mungesë të kësaj pagese dhe në rastet kur qiramarrës ka qenë subjekt tregtar, ka mjaftuar që subjekti/familjarët e tij të ketë provuar se e ka marrë qiranë në vlerën *neto* të saj;
- çdo e ardhur tjetër e prindërve, e përfitur nga shitja, kompensimi i pronave të prindërve etj., sikurse e përfshirë në tabelën e mësipërme;
- shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur si vijon: nga viti 1995 deri në fund të vitit 1999 janë përlllogaritur si 66% e të ardhurave familjare nga puna (pagat dhe pensionet); nga viti 2000 deri më 4.10.2001 janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së për 3 persona; nga data e martësës së subjektit për 4 persona; nga gushti i vitit 2002, kur lind vajza, për 5 persona; nga shkurti i vitit 2005 për 6 persona;
- janë përfshirë shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard dhe shpenzimet e udhëtimeve sipas sistemit *TIMS*.

<sup>138</sup>Bazuar në kontratat e administruara në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe ato të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ.



Mundësia për kursime, e cila ka rezultuar nga analiza financiare për periudhën para detyrës, është përfshirë si e ardhur e kursyer nga prindërit e tij në analizën financiare të subjektit për vitin 2013, pas emërimit në detyrë në datën 23.5.2013.

**59.** Në parashtrimet e tij, subjekti pretendon se balanca pozitive për periudhën para fillimit të detyrës është shumë më e madhe dhe se në analizën e tij Komisioni nuk ka përfshirë: vlerat e disa kontratave të qirasë; vlerën e kompensimit të plotë të nënës së tij, në bazë të vendimit nr.\*\*\*, datë 15.8.2011, të AKKP-së; të ardhurat bashkëshortes së tij gjatë periudhës së bashkëjetesës.

Pas analizimit të të gjitha pretendimeve dhe pas marrjes në konsideratë si të ardhura të ligjshme të disa prej qirave të përfituara nga prindërit e subjektit, sikurse trajtuar në mënyrë të hollësishme në këtë vendim, rezultati financiar për periudhën para detyrës u bë nga + 2.868.900 lekë në + 8.128.775 lekë.

### **Analiza specifike e viteve për periudhën gjatë detyrës**

**60. Viti 2013:** Në deklarinimin për vitin 2013 subjekti ka deklaruar: (i) shtim në bono thesari në shumën 2.500.000 lekë dhe pakësim të gjendjes *cash* me të njëjtën vlerë; (ii) shtim gjendje *cash* 900.000 lekë dhe 1.500 euro, me burim kursime nga pagat, interesat e bonove të thesarit dhe të ardhura nga dhënia e ambienteve me qira në emër të prindërve; (iii) depozitë bankare në BKT në emër të babait në shumën 21.894 euro.

**61.** Për këto pasuri nuk janë konstatuar pasaktësi në deklarime.

**62.** Komisioni ka kryer analizën financiare për këtë vit, nga e cila duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shtesën e likuiditeteve nga periudha e kaluar, për shkak të një balance negative prej -150.957 lekësh.

Përshkrimi	Nga data 28.5.2013 deri më 31.12.2013
<b>Pasuritë</b>	<b>4 672 460</b>
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve nga periudha para detyrës</i>	4 672 460
Gjendja e likuiditeteve <sup>139</sup>	29 691 434
<b>Të ardhurat</b>	<b>5 524 112</b>
Të ardhura nga paga subjekti	785 175
Të ardhura nga paga bashkëshortja	951 742
Të ardhura nga pensioni babai	115 221
Të ardhura nga qiratë	189 000
Të ardhura nga interesa bankare	409 075
Babai si i përndjekur politik për vitet 2010 dhe 2013	205 000
Të ardhura të kursyera dhe të mbartura nga periudha para detyrës	2 868 900
<b>Shpenzimet</b>	<b>1 002 610</b>
Shpenzime jetese	411 320
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	245 350
Shpenzime mobilimi	37 500
Shpenzime shkollimi për vajzën B.	308 440
Balanca e mbartur/pamundësia e krijimit të likuiditeteve para detyrës	1 921 100
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-150 957</b>

**63. Viti 2014:** Në deklarinimin për vitin 2014 subjekti ka deklaruar: shtim gjendje *cash* 1.000.000 lekë dhe 4.000 euro, me burim kursime nga pagat; interesat e bonove të thesarit; dhe të ardhura nga dhënia me qira e ambienteve.

<sup>139</sup>Si pjesë e likuiditeteve është përfshirë edhe shuma 3.500.000 lekë, e cila është investuar në bono thesari në datën 20.6.2013, por që subjekti e kishte deklaruar në DPFID.

64. Komisioni ka kryer analizën financiare për këtë vit, nga e cila ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shtesën e likuiditeteve gjatë vitit 2014, për shkak të një balance negative prej -729.969 lekësh.

<i>Përshkrimi</i>	<i>Viti 2014</i>
<b>Pasuritë</b>	<b>1 929 588</b>
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	1 929 588
Gjendja e likuiditeteve	31 621 023
<b>Të ardhurat</b>	<b>3 536 261</b>
Të ardhura nga paga subjekti	1 065 421
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 064 489
Të ardhura nga pensioni babai	203 308
Të ardhura nga qiratë	864 808
Të ardhura nga interesa bankare	410 235
<b>Shpenzimet</b>	<b>2 408 642</b>
Shpenzime jetese	1 099 990
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	238 238
Shpenzime mobilimi	75 000
Shpenzime spitalore	431 350
Shpenzime shkollimi për djalin Xh.	564 064
Shpenzime shkollimi për vajzën B.	304 805
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-729 969</b>

65. **Viti 2015:** Në deklaratën për vitin 2015 subjekti ka deklaruar: (i) shtim gjendje *cash* 10.000 euro, me burim kursime nga pagat, interesat e bonove të thesarit dhe të ardhura nga dhënia me qira e ambienteve; (ii) shtesë në bono thesari në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 580.000 lekë; (iii) hapur llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, shuma 100.000 lekë, me burim interesa nga bono thesari; (iv) hapur llogari në euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, shuma 2.880 euro, me burim kontrata e qirasë \*\*\*; (v) hapur llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, shuma 890 USD, me burim pagesë projekti \*\*\*; (vi) mbyllur llogaria në BKT, tërhequr shuma 2.700 euro; (vii) shtuar gjendja në “Raiffeisen Bank”, shuma 597 euro, me burim nga interesat; 8. shtim në llogarinë në BKT me 419 euro.

66. Për këto likuiditete nuk janë konstatuar pasaktësi në deklaramë.

67. Komisioni ka kryer analizën financiare për këtë vit, duke përfshirë të gjitha shtesat dhe pakësimet e gjendjes së likuiditeteve të deklaruara nga subjekti, nga e cila ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shtesën e likuiditeteve gjatë vitit 2015, për shkak të një balance pozitive.

<i>Përshkrimi</i>	<i>Viti 2015</i>
<b>Pasuritë</b>	<b>2 517 157</b>
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	2 517 157
Gjendja e likuiditeteve	34 138 179
<b>Të ardhurat</b>	<b>5 390 540</b>
Të ardhura nga paga subjekti	1 061 015
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 104 661
Të ardhura nga pensioni babai	207 957
Të ardhura nga qiratë	1 535 653
Të ardhura nga interesa bankare	167 288
Bashkëshortja paguar nga ***	113 966
Nga kompensimi i pronave në llogarinë e babait	1 200 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>1 901 395</b>

Shpenzime jetese	1 121 380
Shpenzime mobilimi	75 000
Shpenzime spitalore (vërtetim Spitali ***, 20.1.2020 )	152 463
Shpenzime shkollimi për djalën Xh.	552 552
Shpenzime shkollimi për vajzën B.	298 584
Shpenzime bankare	11 650
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>971 988</b>

**68. Viti 2016:** Në deklaratën për vitin 2016 subjekti ka deklaruar: (i) shtim i gjendjes së llogarisë në “Intesa Sanpaolo Bank”, shuma 4.055 euro, nga qira dyqani “\*\*\*\*” sh.p.k., kontrata e qirasë nr. \*\*\*, datë 1.7.2014; (ii) shtim llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, shuma 3.693.572 lekë, me burim krijimi 500.000 lekë nga llogaria e z. A. P., 2.500.000 lekë nga kursimet dhe gjendja *cash*, 693.000 lekë interesa nga bono thesari; (iii) pakësim i gjendjes *cash* në shumën 2.500.000 lekë, kaluar në “Intesa Sanpaolo Bank”; (iv) shtim gjendje *cash* në shumën 1.700.000 lekë dhe 10.000 USD nga të ardhurat vjetore.

**69.** Për këto likuiditete nuk janë konstatuar pasaktësi në deklarime.

**70.** Komisioni ka kryer analizën financiare për këtë vit, duke përfshirë të gjitha shtesat dhe pakësimet e gjendjes së likuiditeteve të deklaruara nga subjekti, *cash* dhe bankë, nga e cila ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shtesën e likuiditeteve gjatë vitit 2016 dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet e tjera për shkak të një balance negative prej -1.613.450 lekësh.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2016</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>3 826 861</b>
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	3 826 861
Gjendja e likuiditeteve	37 965 040
<b>Të ardhurat</b>	<b>4 526 650</b>
Të ardhura nga paga subjekti	1 051 725
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 056 878
Të ardhura nga qiratë	1 722 195
Të ardhura nga interesa bankare	695 852
<b>Shpenzimet</b>	<b>2 313 239</b>
Shpenzime jetese	940 368
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	243 414
Shpenzime mobilimi	75 000
shpenzime spitalore (vërtetim Spitali ***, 20.1.2020 )	166 900
Shpenzime shkollimi për djalën Xh.	442 878
Shpenzime shkollimi për vajzën B.	442 878
Shpenzime bankare	1 800
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1 613 450</b>

**71.** Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza financiare<sup>140</sup> duket se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar likuiditetet e deklaruara, si dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera, për periudhën gjatë detyrës, për shkak të një balance negative totale në shumën -2.494.376 lekë.

**72.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit të mësipërm.

<sup>140</sup>E cila mund të ndryshonte pas ushtrimit të barrës së provës nga subjekti.

**73.** Në parashtrimet e veta subjekti kundërshtoi balancën negative, duke pretenduar se:

(i) analiza financiare e vitit 2014 duhet të korrigojohet pasi ka një gabim në përlllogaritjen e likuiditetit, sepse shuma totale e kursyer në këtë vit është më e madhe, si dhe duhet të përfshihen të ardhura nga qiraja;

(ii) në analizën financiare të vitit 2015 duhet të përfshihen të ardhurat nga qiraja;

(iii) në analizën financiare të vitit 2016 nuk janë përfshirë të ardhurat nga trashëgimia, si dhe të ardhura nga qiraja e \*\*\*. Për vitin 2016 subjekti pretendon se: *“Nga këto të dhëna qartësisht rezulton se babai im ka pasur mundësi të më linte trashëgimi shumën 1.981.700 lekë (700.000 lekë dhe 10.000 USD) të cilat i kam deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2016 (shumë që është në afërsi të shtesës së likuiditetit të pambuluar). Gjithashtu, shpjegime rreth kësaj shume të trashëguar kam dhënë edhe gjatë hetimit administrativ, por edhe në ILDKPKI përpara se të përpilohej deklarata Vetting. Duhet të theksoj se pavarësisht se kemi jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare, babai nuk ka qenë subjekt deklarues gjatë viteve 2013 - 2015 dhe për këtë arsye nuk është deklaruar gjendja cash që ai ka disponuar më vete jashtë sistemit bankar”.*

Në analizë të çdo pretendimi, në përfundim të procesit, Komisioni pasi konsideroi si të ardhura të ligjshme disa prej qirave të përfituara nga babai i subjektit trajtuar në mënyrë të hollësishme në këtë vendim, rishikoi analizën financiare të çdo viti, si vijon:

**74.** Për vitin 2013, rezultati financiar u bë nga -150.957 lekë në + 5.818.843 lekë.

**75.** Për vitin 2014, rezultati financiar u bë nga -729.969 lekë në -2,907 lekë

**76.** Për vitin 2015, rezultati financiar u bë nga + 971.988 lekë në +1.081.795 lekë.

**77.** Për vitin 2016, përveç konsiderimit të disa qirave, u vlerësuan edhe faktet e mëposhtme (i) nga verifikimi i DPV/2016 ka rezultuar se subjekti i ka deklaruar shumat e lëna trashëgimi nga babai i tij, sikurse pretendon; (ii) subjekti dhe familja kanë pasur mundësi për kursime deri më 28.5.2013 shumën 8.128.775 lekë, e cila ka qenë mëse e mjaftueshme që babai i tij t'i kishte kursyer shumat 700.000 lekë dhe 10.000 USD, përveç shumave të dhëna subjektit dhe të deklaruara prej tij nga DPDF-ja e në vijim, deri/edhe në Deklaratën Vetting; (iii) babai i subjektit nuk ka qenë subjekt deklarues dhe nuk ka pasur detyrim t'i deklarojë kursimet e mbajtura personalisht prej tij. Për këto arsye, shumat 700.000 lekë dhe 10.000 USD, të lëna trashëgimi prej babait dhe deklaruar në vitin 2016, u konsideruan të ardhura të ligjshme dhe u përfshinë si të tilla në analizën financiare të vitit 2016. Pas rishikimit të kësaj analize në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, balanca bëhet nga -1.613.450 lekë në +444.645 lekë.

**78.** Në konkluzion, pas marrjes në konsideratë të disa prej parashtrimeve të subjektit në lidhje me të ardhura të ligjshme si: (i) të ardhurat nga qiratë të trajtuara hollësisht më sipër në këtë vendim; (ii) shumat e lëna trashëgimi nga babai 700.000 lekë dhe 10.000 USD, analiza financiare e rishikuar, për periudhën në detyrë, ka ndryshuar si në tabelën vijuese.

Vitet	Pasuria	Të ardhura	Shpenzimet	Mundësia për kursime
Nga data 28.5.2013	4 672 460	11 493 913	1 002 610	5 818 843
2014	1 599 629	4 005 364	2 408 642	-2 907
2015	2 522 950	5 506 140	1 901 395	1 081 795
2016	3 832 466	6 590 350	2 313 239	444 645

#### **Konstatime të tjera**

**79.** Nga verifikimi i hyrje-daljeve në sistemin TIMS, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë udhëtuar me automjetet me targa, si vijojnë: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi pronarët e këtyre automjeteve, marrëdhënien me ta dhe

qëllimin e udhëtimit, subjekti sqaroi se: (i) Automjetet me targat \*\*\*, \*\*\* (lapsus, pasi targa e saktë është \*\*\*), \*\*\* dhe \*\*\*, janë automjete në pronësi të Policisë së Shtetit, të cilat janë përdorur nga bashkëshortja e tij A. P., si punonjëse e këtij institucioni dhe se vetëm në udhëtimin me automjetin me targa \*\*\* për në M. Z. është shoqëruar prej tij. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur<sup>141</sup>: urdhër të MB-së, nr. \*\*\*, datë 13.7.2007; urdhër të MB-së, nr. \*\*\*, datë 17.9.2008; urdhër të MB-së nr. \*\*\*, datë 2.10.2008; urdhër nr. \*\*\*, datë 19.11.2008, në të cilat përcaktohet se shërbimet sipas këtyre udhëtimeve do të kryhen në rrugë tokësore me automjetet me këto targat; (ii) Automjetet me targa \*\*\* dhe \*\*\* janë autobusë që kanë shërbyer për udhëtime të organizuara nga shkolla e vajzës dhe se nuk ka dijeni mbi pronarët e tyre.

Nga verifikimi në sistemin e AMF-së, përputhen të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultuan problematika nga të dhënat e marra nga sistemi *TIMS*.

**80.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Arian Përmeti, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklaratime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a” e pikës 5); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b” e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (germa “c” e pikës 5); si dhe (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d” e pikës 5).

## KONTROLLI I FIGURËS

**81.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Arian Përmeti, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2022, të KDZH-së, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2022, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Arian A. Përmeti. Pas kërkesës së Komisionit, nuk ka pasur të dhëna të përditësuara nga institucionet ligjzbatuese. Për rrjedhojë, subjekti është vlerësuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

Në përfundim, nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në këto kushte, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti është i përshtatshëm për vijimin e

---

<sup>141</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2022, në dosjen e Komisionit.

ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**82.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Arian Përmeti, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**83.** Raporti për analizimin e aftësive profesionale i kryer nga Këshilli i Lartë Prokurorisë është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

**84.** Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, KLP-ja ka evidentuar: (i) saktësinë e formularit të vetëdeklarimit; (ii) përvojën profesionale; (iii) detyrat e kryera për periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016; (iv) trajnimet në 3 vitet e fundit, si dhe ka analizuar tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short, nga ku nuk janë evidentuar problematika.

**85.** Nga të dhënat e burimoreve arkivore ka rezultuar se: (i) ndaj subjektit të rivlerësimit Arian Përmeti rezulton se nuk ka masa disiplinore; (ii) ka pasur dy ankesa të vitit 2015, të cilat pasi janë trajtuar nga drejtoria përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, në një rast vendimmarrja e prokurorit ka rezultuar e bazuar në prova dhe ligj dhe në rastin tjetër është orientuar ankuesi që për pretendimet e tij mund të ushtrojë të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë; (iii) nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës, që ai të jetë përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike; (iv) për vitet 2014, 2015, dhe 2016 është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

**86.** Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Arian Përmeti, si vijon:

### **Aftësitë profesionale**

#### *Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Arian Përmeti, shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit të saj në rastin konkret.

#### *Arsyetimi ligjor*

Subjekti në përgjithësi shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërtimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese, është e qartë dhe e kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore.

## **Aftësitë organizative**

### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës ku ka kryer hetimet, si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

### *Aftësia për të kryer procedurat hetimore*

Subjekti ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga ana e tij është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit.

### *Aftësia për të administruar dosjet*

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

## **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### *Etika në punë*

Nga ana e prokurorit rezulton se janë përmbushur me korrektësi kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie në administrimin e duhur të akteve ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

### *Integriteti*

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### *Paanësia*

Nuk kanë rezultuar raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jetë diskutuar cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerabël.

## **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

### *Aftësitë e komunikimit*

Subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur një sjellje shumë të mirë, i komunikueshëm dhe duke shfaqur aftësi profesionale në diskutime teknike për çështje të ndryshme. Ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

### *Aftësia për të bashkëpunuar*

Ka cilësi të mira bashkëpunuese dhe tregohet i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Ka shfaqur aftësi dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

Subjekti Arian Përmeti rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitetesh profesionale.

### **Informacioni i marrë nga burime të ligjshme**

Si informacion i marrë nga burime të ligjshme janë konsideruar informacionet e marra nga:

**87.** Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

**88.** Gjashtë denoncime<sup>142</sup> nga publiku të administruara për subjektin e rivlerësimit dhe një informacion i referuar në media. Për katër nga denoncimet e paraqitura, Komisioni vendosi të kryejë verifikime të mëtejshme, si vijojnë:

**89.** Denoncim nga shtetasi V. J. – në denoncimin e tij, ky shtetas, dekan i F. Gj. M., ngre pretendime për vendimmarrje të parregullt, joprofesionale dhe të dyshimtë të prokurorit Arian Përmeti, lidhur me pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, i cili ishte regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të pedagogëve të F. ndaj kryesekretares së tij, znj. R. M., dhe mosmarrjen parasysh edhe të vetë denoncimit të një studenteje.

**89.1.** Gjatë hetimit administrativ, me qëllim vlerësimin e pretendimeve të denoncuesit apo problematika të tjera procedurale, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>143</sup> dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, nga aktet e së cilës rezultoi se: (i) me urdhrin e datës 10.12.2018, prokurori E. I. ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal nr. \*\*\* të vitit 2018, të paraqitur nga kallëzuesja R. M. (kryesekretare e F. Gj. M.); (ii) me vendimin e datës 19.12.2018, Drejtuesja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit E. I. me prokurorin Arian Përmeti në drejtimin e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale në procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2018, për shkak se prokurori E. I. ka hequr dorë nga hetimi i çështjes, me arsyetimin se procedimi është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe me hetimin e këtyre veprave merret seksioni për krimin ekonomiko-financiar; (iii) me kërkesën e datës 17.7.2020 prokurori Arian Përmeti ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2018, në ngarkim të të pandehurve A. Y., i akuzuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve shkollore” dhe B. Sh., e akuzuar për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”; (iv) me vendimin e datës 15.9.2020 prokurori Arian Përmeti ka vendosur informimin e kërkuarit lidhur me ecurinë e procedimit penal nr. \*\*\*.

**89.2.** Nga analiza e akteve të mësipërme rezulton se prokurori Arian Përmeti ka nxjerrë tri urdhra për kryerjen përgjithësisht të të njëjtave veprimeve hetimore, pa argumentuar se përse kryerja e tyre nuk është realizuar brenda afatit të përcaktuar prej tij.

**89.3.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim dhe informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me kërkesën e tij për gjykimin e të pandehurve, duke paraqitur vendimet përkatëse.

**89.4.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se kryerja e veprimeve hetimore i është deleguar fillimisht OPGJ-së R. K. në datën 28.1.2019, dhe në vijim i është kërkuar të kryejë

<sup>142</sup>Shihni denoncimin nga shtetasi F. K. M., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2017; denoncimin nga shtetasi Ll. J., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2018; denoncimin nga shtetasi V. J., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2012; denoncimin nga shtetasja M. M. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2017; denoncimin nga shtetasi J. K., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 23.8.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2019; denoncimin nga shtetasi M. Z., depozituar pranë Komisionit në datën 14.7.2022, në dosjen e Komisionit.

<sup>143</sup>Shihni dosjen bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.



veprime të tjera hetimore, si dhe plotësimin e veprimeve hetimore të pakryera më parë, por në këtë periudhë ky OPGJ është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për këtë arsye, për plotësimin e veprimeve hetimore është nxjerrë një urdher tjetër që iu ngarkua një tjetër OPGJ-je, I. R. Sipas tij, gjykata e ka konsideruar hetimin të plotë dhe pa mangësi, duke vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 9.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i formës së prerë, e cila ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurve.

**89.5.** Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, sa i takon konstatimit mbi moskryerjen e veprimeve hetimore brenda afatit të caktuar në urdhrat përkatës, për sa pretendohet prej subjektit, që kjo lidhet me largimin e OPGJ-së në një prokurori tjetër, vlerësohet se nuk qëndron, pasi është detyra e prokurorit drejtimi dhe ndjekja penale dhe, në këto kushte, ai duhet të kishte marrë masa për verifikimin e përmbushjes së tyre në respektim të afatit të caktuar prej tij.

Ndërsa, sa i takon pretendimeve të denoncuesve mbi vendimmarrje të dyshimtë dhe të parregullt të subjektit të rivlerësimit, përpos faktit se një vlerësim i tillë del jashtë tagrit të Komisionit, pasi të tilla pretendime zgjidhen nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor, referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 9.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes nuk janë gjetur mangësi dhe se gjykata ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurve, sipas kërkesës për dërgimin në gjyq të çështjes së prokurorit, vendim i cili është i formës së prerë.

Në konkluzion, Komisioni vlerëson se problematika e evidentuar si më sipër në këtë rast nuk përbën shkak për penalizim të subjektit, pasi nga analiza në tërësi e akteve të dosjes penale nuk konstatohen mangësi në drejtim të hetimit të çështjes.

**90.** Dy denoncime nga shtetasja J. K. – në denoncimet e saj kjo shtetase ngre pretendime për hetime të përcipta dhe të njëanshme të kryera nga prokurori Arian Përmeti, e duke favorizuar palën e inkriminuar A. D.

**90.1.** Nga aktet bashkëngjitur denoncimet konstatohet se: (i) në datën 21.5.2018 shtetasja Jallidiz Kastrati ka bërë kallëzim për vjedhjen e disa materialeve të ndërtimit, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*\* i vitit 2018, për veprën penale “vjedhje”, pa autor; (ii) me vendimin e datës 11.3.2019 prokurori Arian Përmeti ka vendosur pezullimin e hetimeve paraprake të procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “vjedhje”, pa autor dhe dërgimin e akteve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për hetime të mëtejshme me qëllim zbulimin e autorit ose autorëve; (iii) në datën 4.5.2019 prokurori Arian Përmeti ka informuar kallëzuesen J. K. se pas hetimeve të kryera nuk ishin zbuluar autorët e vjedhjes dhe për këtë arsye çështja ishte pezulluar, ndërsa për sa i përket punimeve ndërtimore të kryera nga shtetasi A. D., ai ishte i pajisur me deklaratë paraprake. Në po këtë vendim prokurori ka vlerësuar mosdhënien e akteve të veçanta pasi prej kallëzueses nuk janë specifikuar aktet që kërkohen.

**90.2.** Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit, u administrua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>144</sup> dosja e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2018, nga analiza e akteve të së cilës rezultoi se: (i) në datën 21.5.2018 shtetasja J. K. ka bërë kallëzim për vjedhjen e disa materialeve të ndërtimit, mbi bazën e të cilit në datën 21.6.2018 prokurori Arian Përmeti ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “vjedhje”, pa autor; (ii) në datën 4.6.2018 prokurori Arian Përmeti ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore si: *të merret deklarami i shtetases J. K., duke përcaktuar konkretisht çështjet që do të duhet të sqarohen; të merret deklarami i shtetasis A. D., duke i kërkuar sqarime mbi dokumentacionin që disponon, veprime që rezultojnë të kryera prej tij;*

<sup>144</sup>Shihni dosjen bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

(iii) në datën 4.7.2018 ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore, si vijojnë: *të administrohet tabela fotografike; të bëhet këqyrje e vendngjarjes nëse ka ambient të mbuluara me kamera...; të kryhet çdo veprim hetimor për zbulimin e autorit të ngjarjes, veprime që rezultojnë të kryera prej tij*; (iv) në datën 15.8.2018 shtetasja J. K. i është drejtuar Prokurorisë me kërkesë për informacion dhe dorëzim provash shtesë, duke kërkuar njohjen me dosjen e procedimit penal; *nuk evidentohet vendim i organit procedues lidhur me kërkesën e saj*; (v) në datën 21.12.2018 shtetasja J. K. i është lëshuar urdhër për paraqitje; (vi) me vendimin e datës 11.3.2019 prokurori Arian Përmeti ka vendosur pezullimin e hetimeve paraprake të procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “vjedhje”, pa autor, dhe dërgimin e akteve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë për hetime të mëtejshme, me qëllim zbulimin e autorit ose autorëve; (vii) në datën 4.5.2019 prokurori Arian Përmeti ka informuar kallëzuesen J. K. se pas hetimeve të kryera nuk ishin zbuluar autorët e vjedhjes dhe për këtë arsye çështja ishte pezulluar, ndërsa për sa i përket punimeve ndërtimore të kryera nga shtetasi A. D., ai ishte i pajisur me deklaratë paraprake. Në po këtë vendim prokurori ka vlerësuar mosdhënien e akteve të veçanta, pasi prej kallëzueses nuk janë specifikuar aktet që kërkohen.

**90.3.** Në konkluzion të akteve të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk është shprehur me vendim në lidhje me kërkesën e shtetasjes J. K., sipas parashikimeve të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale.

**90.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

**90.5.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar Komisionin se pas njohjes së tij me këtë konstatim, i ka drejtuar një kërkesë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i kërkuar vënien në dispozicion të dosjes së procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2018. Në përgjigjen e saj, kjo fundit ka informuar subjektin se duke qenë e pezulluar dosja i ishte nisur për veprime të mëtejshme Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, duke i kërkuar administrimin e saj, e cila ende nuk është administruar nga subjekti. Sipas subjektit, referuar librit të dorëzimit nr. \*\*\*, të vënë në dispozicion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesa e shtetasjes J. K. është regjistruar pranë kësaj Prokurorie me nr. \*\*\*, viti 2018, dhe i është dhënë në datën 3.9.2018 prokurorit J. Xh. Subjekti deklaroi se nuk i kujtohet nëse është njohur me këtë kërkesë të shtetasjes J. K., por procedimi penal është pezulluar më pas dhe kjo shtetase është njohur me këtë pezullim dhe nuk i është drejtuar gjykatës për veprime të mëtejshme.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentet si vijojnë: korrespondencën e tij me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresën kthim përgjigje datë 15.7.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë drejtuar subjektit; kërkesën për dokumentacion datë 14.7.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë drejtuar Drejtorisë së Policisë Tiranë; faqen nr. \*\*\* të librit të dorëzimit 2017 – 2018.

**90.6.** Nga analiza në tërësi e akteve të dosjes penale, nuk konstatohen mangësi në drejtim të hetimit të çështjes dhe veprimeve hetimore të kryera. Sa i takon konstatimit të mësipërm të Komisionit, për sa pretendohet nga subjekti se kërkesa e shtetasjes J. K. është marrë nga një tjetër prokuror i kësaj prokurorie (fakt i vërtetuar prej tij) dhe se nuk i kujtohet nëse është njohur ose jo me këtë kërkesë, duke mos e përjashtuar plotësisht marrjen dijeni të tij, nuk e shkarkon subjektin si prokuror i çështjes për ndjekjen dhe njohjen me të gjitha aktet procedurale të dosjes dhe detyrimin ligjor për t’iu përgjigjur kërkesave të palës, sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale<sup>145</sup>. Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo nuk është një shkelje e përsëritur nga subjekti, Komisioni vlerësoi që problematika e kësaj çështjeje është e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me mangësi profesionale, sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>145</sup>Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim; organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

**91.** Denoncim nga shtetasi M. Z. – në këtë denoncim ngrihen pretendime se prokurori ka kryer shkelje, duke vendosur në mënyrë të gabuar mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, në lidhje me kallëzimin e paraqitur nga denoncuesi ndaj shtetasit N.H., për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal.

**91.1.** Pas kërkesës së Komisionit për sqarime, në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se shtetasi M. Z. ka bërë kallëzim pranë Komisarariatit të Policisë nr. \*\*\* lidhur me një konflikt që ka pasur me shtetasin N. O. Materialet procedurale i janë referuar nga OPGJ-ja në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”. Pas administrimit të aktekspertimit mjeko-ligjor nr. \*\*\*, ku ka rezultuar se *në trupin e shtetasit M. Z. nuk konstatohen dëmtime të jashtme trupore*, nga prokurori është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi në bazë të ligjit vepra penale e parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal futet në grupin e veprave të cilat viktimat duhet të paraqesë drejtpërdrejt kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën. Vendimi i prokurorisë i është dërguar kallëzuesit M. Z. Shtetasi M. Z. i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit të mosfillimit, ndërsa në seancë gjyqësore nga prokurori i është kërkuar gjykatës rrëzimi i kërkesës së kërkuarit për shkak të kalimit të afateve kohore. Me vendim nr. \*\*\* akti, datë 6.5.2022, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit M. Z., me objekt “rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2021”. Kërkuari M. Z. nuk ka ushtruar ankim në lidhje me këtë vendim dhe në datën 1.7.2022 vendimi ka marrë formë të prerë.

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: fashikullin e kallëzimit penal nr.\*\*\* të vitit 2021; vendimin e gjykatës nr. \*\*\* akti, datë 6.5.2022.

**91.2.** Komisioni vlerëson se sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në raport me aktet e dosjes së procedimit penal janë të bazuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Sipas nenit 59<sup>146</sup> të Kodit të Procedurës Penale, vepra penale e parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal futet në grupin e veprave për të cilat viktimat duhet të paraqesë drejtpërdrejt kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën.

**92.** Në informacionin e publikuar në media në [link-un https://shqiptarja.com/lajm/i-la-babai-32-shtepi-dyqane-e-troje-prokurori-arian-permeti-shpetoi-\\*\\*\\*-\\*\\*\\*-per-pallatin-pa-lejet-qe-u-sekuestrua-policia-denoncoi-biznesmenin?r=pop5s](https://shqiptarja.com/lajm/i-la-babai-32-shtepi-dyqane-e-troje-prokurori-arian-permeti-shpetoi-***-***-per-pallatin-pa-lejet-qe-u-sekuestrua-policia-denoncoi-biznesmenin?r=pop5s), që lidhet me procedimin penal nr. \*\*\*, regjistruar mbi bazën e një kallëzim penal për ndërtim pa leje nga ana e biznesmenit J. M., ngrihen pretendime për pengim/bllokim të dosjes nga subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti, duke mos kërkuar ndalimin e biznesmenit.

**92.1.** Subjektit iu kërkuar që të japë sqarime në lidhje me këto pretendime, duke paraqitur dokumente nga dosja penale.

**92.2.** Në parashtrimet shtesë të paraqitura në seancë dëgjimore, subjekti ka deklaruar se çështja në fjalë nuk është nën hetim prej tij. Sipas tij, ai nuk ka marrë ndonjë vendim mosfillimi dhe as ka paraqitur ndonjë kërkesë në gjykatë për pushim procedimi penal lidhur me ndonjë çështje për ndërtim pa leje. Më tej, ai ka informuar se ka në hetim një çështje tjetër penale të regjistruar mbi bazën e kallëzimit nr.\*\*\*, e cila, pas shortimit të datës 17.5.2021, i ka kaluar atij si prokuror. Sipas tij, ky kallëzim është regjistruar si procedim me vendimin e datës 9.6.2021 dhe ka marrë numër procedimi \*\*\*. Ai ka deklaruar se ky procedim nuk i përket fakteve të pasqyruara në media dhe në [link-un](#) e dërguar, por ajo që është më e rëndësishme është se për këtë çështje vazhdojnë hetimet. Ai shprehet se pavarësisht se çështja është nën hetim, dhe si e tillë nuk mund t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, është i hapur për të paraqitur çdo të dhënë që mund t'i kërkohe.

---

<sup>146</sup> “1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 43 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit”

Në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me trajtimin e çështjes objekt verifikimi prej tij, subjekti ka paraqitur: shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimin për regjistrimin e procedimit penal të datës 9.6.2021; fletën e shortit elektronik.

**92.3.** Nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se: (i) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 9.6.2021, prokurori Arian Përmeti ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2021, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; (ii) ky procedim lidhet me faktin se në datën 10.5.2021, në Rrugën e \*\*\*, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, është konstatuar kryerja e punimeve ndërtimore shtesë në një objekt me subjekt ndërtues shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., objekt për të cilin Bashkia Tiranë, me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. \*\*\*, datë 25.7.2019, ka miratuar lejen e ndërtimit nr. \*\*\*; (iii) kjo çështje është ende në fazën e hetimeve paraprake; (iv) nga verifikimi i ekstraktit të regjistrimit tregtar të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., konstatohet se administratori i kësaj shoqërie është shtetasi J. M., i cili referohet në *link*-un e dërguar subjektit.

Në konkluzion të sa më sipër, duke qenë se procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” është në fazë hetimi, në konsideratë të vendimit nr. 33/2021 të Kolegjit<sup>147</sup>, sipas të cilit vlerësimi i aftësisë nuk mund të shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, me qëllim për të shmangur paragjykimet në lidhje me zgjidhjen e çështjes, Komisioni vlerëson se ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit në këtë rast, sipas pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës.

**93.** Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**93.1.** Në zbatim të pikës 1 të nenit 42, nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

- i) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr.96/2016;
- ii) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr.96/2016;
- iii) subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- iv) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

---

<sup>147</sup>Në këtë vendim, Kolegji arsyeton se: “Në këto kushte, rezultojnë se kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} e vitit 2017, ka qenë në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, për pasojë ky i fundit ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor vlerëson se kontrolli i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje është kryer nga Komisioni në tejkallim të kompetencës kushtetuese dhe ligjore, duke e bërë pretendimin e subjektit të rivlerësimit të drejtë e të bazuar në ligj. Ndalimi i vlerësimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, ka synuar shmangien e paragjykit të organeve të rivlerësimit ndaj zgjidhjes së një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit e njëkohësisht dhe shmangien e paragjykit të çështjes e dhënies së zgjidhjeve të gabuara nga subjekti i rivlerësimit nën “presionin” apo ndikimin e procesit të rivlerësimit. Në rastin konkret, Komisioni, në konstatimin në vendim se subjekti kishte bërë zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore vetëm pasi ishte njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka dëshmuar pikërisht veprimin e subjektit të rivlerësimit në çështjen që kishte në shqyrtim, nën ndikimin e vlerësimit për shkak të procesit të rivlerësimit”.

**93.2.** Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

#### **IV. SEANCA DËGJIMORE**

**94.** Në datën 15.9.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arian Përmeti, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arian Përmeti dhe shpalli vendimin në seancën e datës 18.7.2022, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

#### **V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**95.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues i subjektit gjatë gjithë procesit të rivlerësimit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

#### **VI. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

**96.** Komisioni, në një rast atipik si ky, për sa i takon volumit të madh të qiradhënieve dhe specifikave të çdo marrëdhënieje qiraje, konsultoi veçanërisht jurisprudencën e Kolegjit në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë, duke analizuar rast pas rasti secilën prej këtyre marrëdhënieve. Në këtë analizë Komisioni nuk u ndal thjesht dhe vetëm në orientimet e Kolegjit, të cilat nuk e mbulojnë diversitetin e rasteve përpara të cilave ndodhemi, por vlerësoi me objektivitet çdo të dhënë që i krijoi bindjen mbi përfitimin e të ardhurave nga qiraja. Konkretisht, për çdo marrëdhënie qiraje të identifikuar, është verifikuar ekzistenca ose jo e aktit shkresor që provon këtë marrëdhënie, derdhja e të ardhurës së përfituar dhe lloji i saj (*neto* apo *bruto*), mënyra e kalimit të saj, pronësia e pasurisë objekt qiraje, lloji i palës qiramarrëse (individ, PF apo PJ), aktivitetit tregtar i ushtruar nga pala qiramarrëse, vendi i ushtrimit të aktivitetit dhe lidhja e tij me objektin në pronësi /bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit.

**97.** Gjatë procesit të vendimmarrjes, në respektim të plotë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, ashtu sikurse edhe Kolegji orienton Komisionin në disa prej vendimeve të tij, trupi gjykues është bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të procedurave/rrethanave për të tria kriteret, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, referuar edhe fakteve si vijojnë:

- Pasuritë e paluajtshme në pronësi apo bashkëpronësi të subjektit janë përfituar prej tij si trashëgimtar ligjor i dy prindërve të tij A. P. dhe M. P., të cilët i kishin përfituar sipas legjislacionit të kthimit e kompensimit të pronave. Në asnjë rast nuk u evidentuan pasuri të paluajtshme të krijuara nga subjekti i rivlerësimit apo kontrata/marrëdhënie juridiko-civile të çfarëdolloji të parashikuar në dispozitat përkatëse për pasuri të tjera, përveç atyre të përfituara me trashëgimi ligjore gjatë periudhës së rivlerësimit, dhe jo vetëm.

- Pasuritë e paluajtshme janë dhënë me qira në mënyre të vijueshme, duke nisur që herët, nga babai apo nëna e subjektit. Të ardhurat e përfituara janë administruar nga babai i subjektit deri në vitin 2016 kur ai ka ndërruar jetë, i cili nuk ka qenë subjekt deklarues.

- Nuk u evidentuan deklarime të ndryshme apo kontradiktore të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Përkundrazi, deklarimet e tij kanë qenë në përputhje dhe koherencë të plotë me deklarimet ndër vite dhe me dokumentet shkresore të administruara, pavarësisht volumit të madh të tyre.

- Nuk u vërtetua asnjë lidhje e subjektit apo rast të konfliktit të interesit me qiramarrësit e pasurive të paluajtshme.

- U evidentuan shpenzime modeste të subjektit dhe familjes së tij, në raport me të ardhurat e përfituara/deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

- Ndaj subjektit ka pasur një numër relativisht të vogël denoncimesh, problematikat e të cilave nuk mund të përbënin shkak për penalizim të tij.

- Nuk ka pasur asnjë të dhënë qoftë nga organet ligjzbatuese, apo të çdo lloji, në lidhje me veprimtari korruptive të subjektit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **VII. KONKLuzion Përfundimtar**

**98.** Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Arian Përmeti ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arian Përmeti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.9.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*